



## Treguesit Kryesorë

	EUR '000		LEK '000	
	2018	2017	2018	2017
<b>Pasqyra e Bilancit</b>				
Asete Totale	258,996	256,968	31,965,256	34,163,812
Portofoli Bruto i Kredisë	194,795	181,535	24,041,608	24,135,031
Portofoli i Kredisë të Klientëve të Biznesit	178,770	164,352	22,063,827	21,850,542
Portofoli i Kredisë të Klientëve Privat	16,025	17,183	1,977,781	2,284,489
Provizionet për Kreditë e Humbura (LLP)	(13,888)	(10,199)	(1,714,047)	(1,356,000)
Portofoli Neto i Kredisë	180,907	171,335	22,327,561	22,779,031
Depozita të Klientëve	167,487	180,867	20,671,213	24,046,245
Detyrime në Banka dhe Institucione të tjera (duke përfshiruar PCH)	4,912	4,137	606,204	549,965
Kapitali Total	25,388	32,261	3,133,343	4,289,114
<b>Pasqyra e të ardhurave</b>				
Të Ardhura Operative	5,541	6,578	706,939	882,356
Shpenzime Operative	9,878	9,901	1,260,186	1,327,960
Fitimi Operativ Para Tatimit	(5,670)	(4,338)	(723,394)	(581,834)
Fitimi Neto	(6,141)	(3,998)	(783,528)	(536,204)
<b>Raporte Kryesore</b>				
Raporti të Ardhura/Kosto	178.26%	150.50%		
Kthimi i Kapitalit	-21.31%	-11.75%		
Raporti i Kapitalit	13.75%	13.42%		
<b>Statistika Operacionale</b>				
Numri i klientëve	21,002	41,441		
<i>Prej të cilëve janë Klientë Biznesi</i>	3,857	7,953		
Numri i Kredive Aktive	3,494	6,181		
Numri i llogarive	40,244	75,520		
Numri i Punonjësve	143	177		
Numri i degëve dhe Njësive të Biznesit	6	7		

Monedha vendase kundrejt Euros 31 Dhjetor:

2018: 1 EUR = 123.42 ALL

2017: 1 EUR = 132.95 ALL

Kursi mesatar i këmbimit kundrejt Euros:

2018: 1 EUR = 127.58 ALL

2017: 1 EUR = 134.13 ALL

Treguesit Kryesorë	2
Misioni i Bankës	4
Deklarata Gjithëpërfshirëse	6
Toleranca ndaj riskut e Bankës ProCredit, Shqipëri	8
Pasqyra e Gjendjes Financiare	10
Adresat dhe Kontaktet	66



## Misioni i Bankës

*ProCredit Bank është një bankë tregtare e orientuar drejt zhvillimit. Ne ofrojmë shërbim cilësor për bizneset e vogla dhe te mesme si dhe për ata individë që kanë kapacitetin për të kursyer dhe që preferojnë të shërbehen përmes kanaleve elektronike bankare. Në veprimet tona, ne i përmbahemi një numri të caktuar parimesh bazë: ne vlerësojmë transparencën në komunikimin me klientët, nuk promovojmë kredinë konsumatore, përpiqemi të minimizojmë ndikimin tonë negativ në mjedis dhe ofrojmë shërbime financiare të përshtatshme me situatën e klientëve tanë si dhe të bazuara në një analizë të përgjegjshme financiare.*

*Fokusi ynë është ofrimi i shërbimit cilësor për sipërmarrjet e vogla dhe të mesme, sepse jemi të bindur që këto biznese krijojnë numrin më të madh të vendeve të punës dhe u japin një kontribut thelbësor ekonomive në të cilat operojnë. Ne promovojmë kulturën e kursimit dhe përgjegjësinë financiare, duke ofruar shërbime të thjeshta depozituese për klientët tanë, shërbime online dhe duke investuar burime të konsiderueshme në edukimin financiar, si për klientë biznesi ashtu edhe individë privatë.*

*Aksionaret tanë presin një fitim të qëndrueshëm nga investimi, por nuk janë të interesuar vetëm për maksimizimin afatshkurtër të fitimit. Ne investojmë në mënyrë të vazhdueshme në trajnimin e punonjësve tanë, për të krijuar një mjedis pune të kënaqshëm dhe efikas, si edhe për të siguruar shërbim profesional dhe të përshtatshëm për klientët tanë.*



**Anëtarët e Drejtorisë Ekzekutive në 31 dhjetor 2018:**

- **Adela Leka – Drejtuese e Drejtorisë Ekzekutive**
- **Ardiola Hristiç – Anëtare e Drejtorisë Ekzekutive**
- **Agan Azemi – Anëtar i Drejtorisë Ekzekutive**
- **Mirsad Haliti – Anëtar i Drejtorisë Ekzekutive**

**Këshilli Drejtues në 31 dhjetor 2018:**

- **Borislav Kostadinov, Kryetar i Këshillit**
- **Wolfgang Bertelsmeier**
- **Jordan Damcevski**
- **Robert Scott Richards**
- **Jovanka Joleska Poposka**

## Deklarata Gjithëpërfshirëse

Në kuadër të përcaktimeve dhe parimeve të vendosura në Rregulloren e Bankës së Shqipërisë “Mbi parimet bazë të drejtimit të bankave dhe degëve të bankave të huaja dhe kriteret e miratimit të administratorëve të tyre” Banka ProCredit sh.a. deklaron se:

### Politikat e Shpërblimit

Në bazë të Statutit në fuqi të datës 15.7.2010 të Bankës ProCredit, Anetarët e Këshillit Drejtues, si dhe Anetarët e Komitetit të Kontrollit të Bankës, nuk paguhen për kryerjen e detyrave të tyre por marrin një dietë të përshtatshme për shpenzimet, e cila përcaktohet herë pas here nga Asambleja e Aksionerëve.

Anëtarët e Drejtorisë Ekzekutive të Bankës ProCredit, si drejtuesit më të lartë ekzekutiv dhe në përputhje me profilin e riskut të bankës paguhen në bazë të një pagë mujore fikse shuma bruto e agreguar vjetore e së cilës është 18 306 000. lekë. Politikat e shpërblimit të bankës konsistojnë në shpërndarjen e pagës fikse mujore për punën në raport me pozicionin, eksperiencën, përgjegjësitë dhe detyrat që ka çdo punonjës, si dhe në mosdhënien e bonuseve shtesë.

Mënyra të tjera të shpërblimit për punonjësit jepen në formën e:

- Kontroll mjekësor falas një herë në vit
- Shpërblimi për lindjen e fëmijës
- Shpërblim për përkujdesjen e fëmijes (për kthimin nga leja e lindjes deri në 1 vjeç)
- Paketa udhëtimi dhe qiraje
- Paketa telefonie
- Dieta në udhëtim

Në zbatim të drejtimit të përgjegjshëm dhe efektiv përgjatë veprimtarisë së saj, Banka ProCredit harton dhe zbaton aktet e brëndshme si më poshtë:

- Politika dhe procedura të administrimit të riskut
- Procedura për kriteret e emërimit dhe dokumentacionin për miratimin nga Banka e Shqipërisë të administratorëve të bankës
- Procedura e Përputhshmërisë Ligjore me Rregulloret e Jashtme

Politika e Pagave është në linjë me politikën e pagave të grupit të bankave ProCredit, si dhe përcakton rolin që ProCredit Holding luan në lidhje me politikën e brëndshme. Qëllimi i kësaj politike është të përcaktojë bazat mbi të cilat është ngritur struktura e pagave gjithashtu i është bërë referencë ndryshimeve në pozicione, strukturës organizative të institucionit dhe kërkesave të trajnimeve për çdo grup pagash.

Struktura e pagave të bankës është një komponent thelbësor i politikës së Burimeve Njerëzore. Ajo synon të ofrojë një kornizë të thjeshtë dhe koherente të niveleve të pagave për të gjitha pozicionet në ProCredit gjithashtu edhe rrugët e qarta për zhvillimin e karrierës.

Çdo pozicion në bankë shfaqet në strukturën e pagave me një rang page që përbëhet nga një numër i caktuar i hapave të pagave që mund të përdoren në varësi të performancës së çdo punonjësi.

Parimi i një page fikse (jo të ndryshueshme) riafirmohet me forcë si një element kyç i politikës së pagave të institucionit. Jo vetëm që bonuset e bazuara në performancë janë shfuqizuar, por edhe përfitimet financiare shtesë, të tilla si paga mujore e trembëdhjetë apo e katërbëdhjetë, pagesat e çdo lloji, kuona, shpenzime pushimesh, etj.gjithashtu nuk praktikohen. Kjo bëhet për të siguruar një formë të qëndrueshme të shpërblimit për punonjësit tanë për një afat të gjatë, më tepër se një paketë e paparashikueshme që mund të ndryshohet.

Rritjet vjetore të pagave janë subjekt analize performance individuale të punonjësit, zhvillimi profesional dhe vendimmarrje në Komitetin e Burimeve Njerëzore.

Komiteti i Burimeve Njerëzore orienton zhvillimin e Burimeve Njerëzore në institucion nëpërmjet diskutimit dhe vendimmarrjes së çështjeve strategjike që zakonisht propozohen nga Njësia i Burimeve Njerëzore, Anëtarë të Drejtorise Ekzekutive, anëtarë të Komitetit të Burimeve Njerëzore, si edhe propozime të cilat mund të vijnë nga drejtuesit e Njësive të Biznesit ose Departamenteve/Njësive pranë Zyrave Qendrore. Komiteti i Burimeve Njerëzore zhvillohet 1 herë në muaj.

## Toleranca ndaj riskut e Bankës ProCredit, Shqipëri

Banka ProCredit Shqipëri ofron shërbime financiare për bizneset SME si edhe për individët privatë, duke kontribuar në këtë mënyrë në zhvillimin ekonomik të klientëve të saj. Strategjia e biznesit të bankës është e drejtpërdrejt: të vetmet shërbime që ofrohen janë ato të cilat sigurojnë përfitime për bizneset, si edhe shërbimet e kursimeve të dizenuara në përputhje me nevojat e bizneseve, gjithashtu edhe të klientët privatë.

Banka distancohet në mënyrë kategorike nga përfshirja në linjat spekulative të biznesit. Sipas parimeve të saj, banka nuk përfshihet në tregtinë e aksioneve dhe nuk hyn në pozicione spekulative me qëllimin për të gjeneruar të ardhura të tjera të mundshme. Për këtë arsye, banka, në mënyrë të prerë, është një institucion i cili nuk tregton asete. Orientimi i përgjithshëm është drejt stabilitetit, veçanërisht në lidhje me situatën e fitimeve dhe me profilin e riskut të bankës.

Rreziku i ndërmarrë nga banka tregohet, midis të tjerash, në parimet e mëposhtme:

- Përqendrimi tek bizneset e qëndrueshme: fokusimi dhe ofrimi i shërbimeve financiare për bizneset SME
- Ofrimi i produkteve të thjeshtë, transparentë financiare për klientët e synuar
- Mospromovimi i kredive konsumatore
- Shmangia e përqendrimeve të riskut
- Përzgjedhja e kujdesshme e klientëve me synimin për bashkëpunim afatgjatë
- Një proces i strukturuar, me shumë faza për rekrutimin e stafit dhe vëmendje e veçantë ndaj zhvillimit të gjithë stafit me anë të trajnimeve të vazhdueshme, gjatë së cilave i kushtohet rëndësi aspekteve etike dhe sociale
- Një kulturë e fortë risku, e cila nënvizon përgjegjësinë e secilit punonjësi në kontekstin e ndërmarrjes së rreziqeve dhe e vë theksin tek komunikimi i hapur dhe hierarkitë e sheshta.

Ndërgjegjësimi ndaj rrezikut midis të gjithë menaxherëve dhe punonjësve, një qasje në thelb konservatore ndaj menaxhimit të riskut, si edhe zbatimi i vazhdueshëm i parimit të zgjerimit janë pjesë integrale e strategjisë së biznesit të bankës.

Menaxhimi i riskut në bankë përfiton ndjeshëm nga eksperiencia e grupit, e cila është fituar gjatë 20 viteve të fundit në tregjet ku ajo operon. ProCredit Bank Shqipëri, si pjesë e grupit ProCredit, aderon në praktikat më të mira ndërkombëtare në fushën e menaxhimit të riskut.

Çdo vit, banka realizon një proces për inventarizimin e riskut. Inventarizimi i riskut është instrumenti që ne përdorim për të identifikuar risqet materiale ndaj të cilave ekspozohet banka, duke treguar në këtë mënyrë profilin e përgjithshëm të riskut. Kjo gjë krijon bazën e sistemit për menaxhimin e riskut të Bankës ProCredit. Ky inventar dhe risqet materiale të identifikuara i nënshtrohen shqyrtimit dhe miratimit nga Komiteti i Menaxhimit të Riskut të bankës; gjithashtu, ai i dërgohet edhe strukturave përgjegjëse në ProCredit Holding. Të gjithë risqet materiale të identifikuar përfshihen në kuadrin e menaxhimit të riskut të bankës si edhe në Procesin e Vlerësimit të Mjaftueshmërisë së Kapitalit të Brendshëm.

Në linjë me strategjinë e biznesit dhe të riskut, banka i pranon risqet materiale të mëposhtme dhe ia kalon këto përqindje risqesh burimeve të disponueshme për të mbuluar riskun (BDMR). Potenciali i ndërmarrjes së riskut nuk ndahet sipas formulave matematikore, por reflekton modelin tonë të biznesit dhe bazohet në kuptueshmërinë tonë të zhvillimeve të tregut gjatë viteve.

**Risku nga kreditë:** Ne jemi “Hausbank” për bizneset SME dhe përqendrohemi në ofrimin e shërbimeve financiare. Risku nga kreditë përfaqëson kategorinë më të rëndësishme të riskut për bankën. Risku nga kreditë i referohet rrezikut që krijohet kur pala në një transaksion nuk do të mund të përmbushë detyrimet e saj kontraktuale plotësisht ose në kohë, dhe për këtë arsye përfshin kategoritë e riskut nga kreditë e konsumatorëve, riskun nga pala tjetër dhe nga lëshuesi. Sipas rastit, riskut i përcaktohet pjesa më e lartë (38% = 33% për riskun e kredive + 5% për riskun nga pala tjetër) e BDMR-së së bankës.

Fal stafit të kualifikuar si edhe një sistemi të fuqishëm kontrolli të brendshëm dhe instrumenteve të ndryshëm të përdorur posaçërisht për menaxhimin e **riskut operacional** (të tillë si baza e të dhënave për rastet e riskut), historikisht, banka ka pasur një nivel të qëndrueshëm dhe të ulët humbjesh nga rreziqet operacionale (duke përfshirë rreziqet nga mashtrimet). Për këtë arsye, këtij risku i përcaktohet një normë prej 10% e BDMR.

Edhe pse banka ndjek një strategji konservatore në lidhje me **riskun nga monedha e huaj**, dhe ajo është e detyruar të mbajë pozicione të mbyllura ndaj monedhës, është e pamundur të shmangen risqet e monedhave në rrethana specifike. Në këtë mënyrë, këtij risku i përcaktohet një normë prej 2% të BDMR.

Gjithashtu, një normë zbutëse prej 40% të BDMR përcaktohet për të mbuluar risqe të tjerë, të tillë si: risku i financimit, biznesit dhe i të ardhurave.

## Pasqyra e Gjendjes Financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018.

Përgatitur në përputhje me Standardin e Raportimit Financiar Ndërkombëtar



### Raporti i Audituesve të Pavarur

Për aksionerët dhe Këshillin Drejtues të ProCredit Bank Sh.A

#### Opinion

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare japin, në të gjitha aspektet materiale, një pamje të vërtetë dhe të drejtë për gjendjen financiare të ProCredit Bank Sh.A ("Banka") më datë 31 Dhjetor 2018, dhe për ecurinë financiare të saj, dhe flukset e parasë për ushtrimin e mbyllur, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

#### Ne kemi audituar

Pasqyrat financiare të Bankës përfshijnë:

- Pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe pasqyrën e të ardhurave të tjera përmbledhëse për vitin ushtrimor të mbyllur më 31 dhjetor 2018;
- Pasqyrën e pozicionit financiar për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018;
- Pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin ushtrimor të mbyllur;
- Pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare për vitin ushtrimor të mbyllur;
- Shënimet shoqëruese të pasqyrave financiare, të cilat përfshijnë përmbledhjen e politikave kontabël dhe informacione dhe të dhëna të tjera shpjeguese.

#### Bazat për Opinionin tonë

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve përshkruhen më tej në seksionin Përgjegjësitë e Audituesve për Auditimin e Pasqyrave Financiare të raportit tonë.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar jep një bazë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për opinionin tonë.

#### Pavarësia

Ne veprojmë në mënyrë të pavarur nga Banka në përputhje me Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionistë ("Kodi IESBA"). Ne kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me Kodin IESBA.

#### Përgjegjësitë e Drejtimit dhe atyre të ngarkuar me Drejtimin për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe për ato kontrole të brendshme, të cilat Drejtimi i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi ose gabimi.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së bankës për të vazhduar në vijimësi, zbulimin, sipas rastit, të çështjeve që lidhen me vijimësinë dhe përdorimin e bazës kontabël të vijimësisë derisa drejtimi të synojë ose të likujdijë bankën ose të pushojë veprimtarinë e saj, ose të mos ketë asnjë alternativë realiste tjetër përveç kësaj.

Të ngarkuarit me drejtimin janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bankës.

PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k., Rr. Ibrahim Rugova, Sky Tower, Kati 9, Tiranë, Shqipëri  
T: +355 (4) 2242 254, F: +355 (4) 2242 639, www.pwc.com/al

Regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit më 15 Korrik 2009 dhe me numër identifikimi NIPT K91915023A



## Raporti i Audituesve të Pavarur (vazhdimi)

### *Përgjegjësitë e Audituesve për Auditimin e Pasqyrave Financiare*

Objektivat tona janë sigurimi i një besueshmërie të arsyeshme që pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe nxjerrja e raportit të audituesve që përfshin opinionin tonë. Besueshmëria e arsyeshme nënkupton një nivel më të lartë sigurimi, por nuk përbën garanci për zbulimin e ndonjë anomalie materiale nga një auditim i kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Anomalitë mund të lindin nga mashtrimi apo gabimi dhe konsiderohen si materiale nëse, individualisht ose së bashku, ato në mënyrë të arsyeshme mund të priten të ndikojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, ne japim gjykimin tonë në mënyrë profesionale dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë riskun e gabimeve materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit të përgjegjshme për këto rreziqe dhe marrim dëshmi të auditimit të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë bazat e opinionit tonë. Rreziku i mos-zbulimit të ndonjë gabimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë se një që rrjedh nga gabimi, duke qenë se mashtrimi mund të përfshijë të fshehta, falsifikim, mosveprime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkeljen e kontrollit të brendshëm.
- Të kuptuarit e kontrollit të brendshëm të përshtatshëm për auditimin me qëllim hartimin e procedurave të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të bankës.
- Vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe dhënien e informacioneve të ngjashme shpjeguese të bëra nga drejtimi.
- Konstatimet mbi përshtatshmërinë e përdorimit nga Drejtimi të bazës kontabël të vijimësisë dhe, në bazë të dëshmive të marra të auditimit, konstatimin nëse ekziston ndonjë pasiguri materialë në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime të konsiderueshme në aftësinë e bankës për të vazhduar në vijimësi. Nëse ne konkludojmë se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të audituesve për dhënien e informacioneve shpjeguese të lidhura me pasqyrat financiare, ose, në qoftë se zbulimet të tilla janë të papërshtatshme, të ndryshojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në dëshmitë e marra të auditimit deri në datën e raportit të audituesve tanë. Megjithatë ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të bëjnë që Banka të ndalojë vazhdimin e aktiviteteve të saj.
- Vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme, strukturës dhe përmbajtjes së pasqyrave financiare, duke përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me drejtimin, midis të tjerave në lidhje me qëllimin e planifikuar, kohën e auditimit dhe konstatimet e rëndësishme të auditimit, duke përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

*PricewaterhouseCoopers Audit Sh. p. h.*

PricewaterhouseCoopers Audit Sh.p.k  
3 korrik 2019  
Tiranë, Shqipëri

Auditues statutor  
Jonid Lamllari



## PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor

Aktivet	Shënime	Në LEK '000		Në EUR '000	
		2018	2017	2018	2017
Mjete monetare dhe llogari me Bankën Qendrore	16	5,951,907	6,710,872	48,225	50,477
Hua dhe paradhënie institucioneve financiare	17	19,020	119,326	154	898
Hua dhe paradhënie klientëve	18	22,327,562	22,779,031	180,907	171,335
Instrumente financiare të vendosjes	19	-	1,831,349	-	13,775
Letra me vlerë të borxhit me vlerë të drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse	19	1,632,790	-	13,230	-
Të drejta tatimore të shtyra	15	4,575	64,980	37	489
Tatimi mbi fitimin e arkëtuar të Korporatës		84,260	55,154	683	415
Mjete të tjera	20	849,595	1,287,503	6,884	9,684
Investime në prona	21	34,982	92,057	283	692
Ndërtesa dhe pajisje	22	1,006,496	1,121,939	8,155	8,439
Aktive afatgjata jo-materiale	23	54,068	101,601	438	764
<b>Aktive gjithsej</b>		<b>31,965,255</b>	<b>34,163,812</b>	<b>258,996</b>	<b>256,968</b>
<b>Detyrimet</b>					
Detyrime ndaj bankave	24	3,821,376	2,879,406	30,962	21,658
Detyrime ndaj klientëve	25	20,671,213	24,046,245	167,487	180,867
Fonde të tjera të marra hua		3,474,113	1,860,486	28,149	13,994
Detyrime të tjera	27	179,158	364,592	1,452	2,954
Provizione të tjera	27	49,315	38,064	400	75
Borxhi i varur	26	636,738	685,905	5,159	5,159
<b>Detyrime gjithsej</b>		<b>28,831,913</b>	<b>29,874,698</b>	<b>233,608</b>	<b>224,707</b>
<b>Kapitali aksionar</b>					
Fitimi i pashpërndarë	28	3,763,884	3,387,148	30,497	25,477
(Deficiti i akumuluar)/ Fitimi i pashpërndarë	28	(1,315,585)	221,320	(10,639)	1,706
Rezerva ligjore	28	708,110	708,110	5,737	5,326
Rezerva e rivlerësimit nga kurset e këmbimit		-	-	(20)	(43)
Rezerva e rivlerësimit për letrat me vlerë të vendosjes	19	-	(27,464)	-	(205)
Rezerva e rivlerësimit për letrat me vlerë të borxhit me vlerë të drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse	19	(23,067)	-	(187)	-
<b>Totali i Kapitalit Aksionar</b>		<b>3,133,342</b>	<b>4,289,114</b>	<b>25,388</b>	<b>32,261</b>
<b>Totali i Detyrimeve dhe Kapitalit Aksionar</b>		<b>31,965,255</b>	<b>34,163,812</b>	<b>258,996</b>	<b>256,968</b>

Shifrat ekuivalente në Euro paraqiten vetëm për qëllime informimi dhe nuk janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të audituara (referoju shënimin 2).

Këto pasqyra financiare u miratuan nga Drejtimi i Bankës në datën 28 qershor 2019 dhe janë nënshkruar nga:

  
 Mirsad Haliti  
 Anëtar i Këshillit Administrativ

  
 Agan Azemi  
 Anëtar i Këshillit Administrativ



The statement of financial position is to be read in conjunction with the notes to and forming part of the financial statements set out on pages 16 to 65.



## PASQYRA E FITIM HUMBJEVE DHE TË ARDHURAVE PËRMBLEDHËSE

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor

Shënime	Në LEK '000		Në EUR '000		
	2018	2017	2018	2017	
Të ardhura nga interesat	10	1,444,349	1,340,420	11,321	9,993
Shpenzime për interesat	10	(250,711)	(200,764)	(1,965)	(1,497)
<b>Të ardhura nga interesi, neto</b>		<b>1,193,638</b>	<b>1,139,656</b>	<b>9,356</b>	<b>8,496</b>
Provizionet për humbjet nga kreditë	18	(379,777)	(162,203)	(2,977)	(1,209)
<b>Të ardhura nga interesi neto pas provizioneve për zhvlerësimin e kredive</b>		<b>813,861</b>	<b>977,453</b>	<b>6,379</b>	<b>7,287</b>
Të ardhura nga komisionet	11	320,924	268,909	2,515	2,005
Shpenzime për komisionet	11	(112,610)	(122,934)	(883)	(917)
Të ardhura të tjera operative, neto	12	162,493	92,888	1,274	693
Të ardhura nga këmbimet valutore duke zbritur humbjet		(83,530)	(30,855)	(653)	(230)
Shpenzime për personelin	14	(366,220)	(424,834)	(2,871)	(3,167)
Shpenzime të tjera operacionale	13	(1,458,312)	(1,342,461)	(11,431)	(10,009)
<b>Humbja përpara tatimit mbi fitimin</b>		<b>(723,394)</b>	<b>(581,834)</b>	<b>(5,670)</b>	<b>(4,338)</b>
Shpenzime për tatimin mbi fitimin /(kredit)	15	(60,134)	45,630	(471)	340
<b>Humbja për periudhën</b>		<b>(783,528)</b>	<b>(536,204)</b>	<b>(6,141)</b>	<b>(3,998)</b>
<b>Të ardhura të tjera (humbje) përmbledhëse për periudhën</b>					
Zëra që mund të riklasifikohen në vijim në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve:					
Rezerva e rivlerësimit për letrat me vlerë të vendosjes	19	-	(13,283)	-	(100)
Letra me vlerë të borxhit me FVOCI		1,814	-	14	-
Të drejta tatimore të shtyra	15	(272)	1,992	(2)	15
<b>Totali i humbjeve të tjera përmbledhëse për periudhën, neto</b>		<b>(781,986)</b>	<b>(547,495)</b>	<b>(6,129)</b>	<b>(4,083)</b>

Shifrat ekuivalente në Euro paraqiten vetëm për qëllime informimi dhe nuk janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të audituara (referoju shënimit 2).

Pasqyra e Pozicionit Financiar duhet të lexohet në lidhje me shënimet të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare që paraqiten nga faqa 16 der 65.

## Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor

<i>Në LEK '000</i>	Kapitali Aksionar	Rezervat Ligjore	Rezerva Rivlerësimi (Defiçit)	Fitim i Pashpërndarë	Totali
<b>Gjendja më 1 Janar 2017</b>	<b>3,387,148</b>	<b>707,672</b>	<b>(16,173)</b>	<b>757,962</b>	<b>4,836,609</b>
<i>Totali i humbjeve të tjera përmbledhëse për periudhën</i>					
Humbja për periudhën	-	-	-	(536,204)	(536,204)
Letrat me vlerë të vendosjes	-	-	(13,283)	-	(13,283)
Të drejta tatimore të shtyra	-	-	1,992	-	1,992
<b>Totali humbjeve të tjera përmbledhëse</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>(11,291)</b>	<b>(536,204)</b>	<b>(547,495)</b>
Përvetësimi i fitimit të mbartur	-	438	-	(438)	-
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2017 raportuar më parë</b>	<b>3,387,148</b>	<b>708,110</b>	<b>(27,464)</b>	<b>221,320</b>	<b>4,289,114</b>
<i>Ndikimi i standardeve kontabël të reja ose të rishikuara</i>					
<b>Gjendja e rregulluar më 1 Janar 2018</b>	<b>3,387,148</b>	<b>708,110</b>	<b>(27,464)</b>	<b>(532,056)</b>	<b>3,535,738</b>
<i>Totali i humbjeve të tjera përmbledhëse për periudhën</i>					
Humbja për periudhën	-	-	-	(783,528)	(783,528)
Letra me vlerë të borxhit me vlerë të drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse	-	-	4,669	-	4,669
Të drejta tatimore të shtyra	-	-	(272)	-	(272)
<b>Totali humbjeve të tjera përmbledhëse</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>4,397</b>	<b>(783,528)</b>	<b>(779,131)</b>
<i>Transaksionet me aksionarët të regjistruara direkt në kapitalin aksionar</i>					
Zmadhimi i Kapitalit të Paguar	376,736	-	-	-	376,736
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2018</b>	<b>3,763,884</b>	<b>708,110</b>	<b>(23,067)</b>	<b>(1,315,585)</b>	<b>3,133,342</b>

Shifrat ekuivalente në Euro paraqiten vetëm për qëllime informimi dhe nuk janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të audituara (referoju shënimin 2 (e)).

## Pasqyra e Fluksit të Parasë

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor

Shënime	Në LEK '000		Në EUR '000	
	2018	2017	2018	2017
<b>Fluksi i parasë nga aktivitetet operative</b>				
Fitimi i periudhës para tatimit	(723,394)	(581,834)	(5,670)	(4,338)
Regullime për të rakorduar fitimin përpara tatimit me me fluksin neto të parasë nga aktivitetet operationale				
Zhvlërimi dhe amortizimi i ndërtesave dhe pajisjeve dhe investimeve në ndërtesa	21,22	110,538	896	1,144
Zhvlërimi dhe amortizimi i aktiveve jo-materiale	23	27,352	222	238
Provizione për humbjet nga kredia	18	379,777	3,077	1,220
Të ardhura nga interesat	10	(1,444,349)	(11,703)	(10,082)
Shpenzime për interesat	10	250,711	2,031	1,510
Të ardhura nga shitja e aktiveve		(8,913)	(70)	(6)
Kthime nga provizione të tjera		136,972	1,110	568
Tatimi mbi fitimin i kredituar		(29,106)	(236)	-
		<b>(1,300,412)</b>	<b>(10,343)</b>	<b>(9,746)</b>
<b>Ndryshime në aktive dhe detyrime operative:</b>				
Rezerva e detyrueshme		351,178	2,845	2,425
Hua dhe paradhënie bankave dhe institucioneve të tjera financiare		100,306	813	4,090
Hua dhe paradhënie klientëve		(712,970)	(5,777)	(23,066)
Mjete të tjera		106,216	861	918
Prona të rimarra në pronësi		230,345	1,866	2,531
Detyrime ndaj bankave		938,901	7,607	20,572
Detyrime ndaj klientëve		(3,344,056)	(27,095)	(24,304)
Detyrime të tjera		(181,952)	(1,474)	882
		<b>(3,812,444)</b>	<b>(30,697)</b>	<b>(25,698)</b>
Interesa të arkëtuara		1,481,092	12,000	10,232
Interesa të paguara		(259,088)	(2,099)	(1,669)
Tatimi mbi fitimin i paguar		-	-	248
		33,037		
<b>Fluksi i parasë neto nga aktivitetet operative</b>		<b>(2,590,440)</b>	<b>(20,795)</b>	<b>(16,887)</b>
<b>Fluksi i parasë neto nga aktivitetet operative</b>				
Blerja e letrave me vlerë të borxhit me vlerë të drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse		(1,632,790)	(13,230)	-
Blerja e letrave me vlerë të vendosjes		-	-	(10,715)
Të ardhura nga letrat me vlerë të vendosjes të maturuara		1,830,941	14,835	18,447
Të ardhura nga shitja e ndërtesave dhe pajisjeve		95,740	776	444
Blerja/shitja e aktiveve jo-materiale		-	-	(10)
Blerja/shitja e ndërtesave dhe pajisjeve		(46,862)	(380)	(510)
<b>Fluksi i parasë neto përdorur në aktivitetet investuese</b>		<b>247,029</b>	<b>2,002</b>	<b>7,656</b>
<b>Fluksi i parasë nga aktivitetet financuese</b>				
Ripagimi i borxhit të varur		(47,650)	(386)	(86)
Zmadhimi i kapitalit		376,737	-	-
Dividendi i paguar		-	-	-
Fonde të tjera të marra hua		1,592,581	12,904	13,986
<b>Fluksi neto i parasë (përdorur në) aktivitetet financuese</b>		<b>1,921,668</b>	<b>12,518</b>	<b>13,900</b>
Diferenca nga ndryshimi i kursit të këmbimit		-	5,536	462
<b>Rënia e mjeteve monetare dhe të ngjashme</b>		<b>(421,743)</b>	<b>(740)</b>	<b>5,131</b>
<b>Mjete monetare dhe të ngjashme në fillim të periudhës</b>		<b>4,600,949</b>	<b>34,602</b>	<b>29,471</b>
<b>Mjete monetare dhe të ngjashme në fund të periudhës</b>	<b>16</b>	<b>4,179,206</b>	<b>33,862</b>	<b>34,602</b>

Shifrat ekuivalente në Euro paraqiten vetëm për qëllime informimi dhe nuk janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të audituara (referoju shënimin 2 (e)).

## Shënime Shoqëruese mbi Pasqyrat Financiare

Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018

*(Të gjitha shumat shprehen në LEK'000, përveçse kur është shprehur ndryshe)*

### 1. Hyrje

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2018 për ProCredit Bank Sh.a. ("Banka").

ProCredit Bank Sh.a ("Banka"), e njohur fillimisht si FEFAD Bank Sh.a., u themelua me seli në Shqipëri në muajin shkurt të vitit 1999. Banka u licencua për të ushtruar aktivitetin e saj si një bankë në të gjitha fushat e aktivitetit bankar për individë në Shqipëri në përputhje me Ligjin nr. 9662 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Banka është një shoqëri aksionere e themeluar në përputhje me ligjin 9901, date 14 prill 2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Më 31 Dhjetor 2018 dhe 2017, aksionari i Bankës është shoqëria ProCredit Holding AG & Co. KGaA e cila zotëron 100% të aksioneve.

**Aktiviteti kryesor.** Aktiviteti kryesor i biznesit të Bankës përfshin ofrimin dhe realizimin e operacioneve bankare për bizneset dhe individët në Republikën e Shqipërisë. Banka ushtron aktivitetin e saj në bazë të licencës së plotë për ushtrimin e veprimtarisë bankare të lëshuar nga Banka Qendrore e Shqipërisë. Banka merr pjesë në skemën shtetërore të sigurimit të depozitave, e cila menaxhohet nga Agjencia Shqiptare e Sigurimit të Depozitave

Më 31 Dhjetor 2018, Banka ushtronte aktivitetin e saj nëpërmjet Drejtorisë Qendrore në Tiranë me 1 degë, 4 pika shërbimi, 5 qendra vetë-shërbimi (Zona shërbimi 24 orë në ditë, 7 ditë në javë) të cilat ndodhen në Tiranë, Durrës, Korçë dhe Shkodër.

**Adresa e selisë dhe vendi i aktivitetit të biznesit.** Adresa zyrtare e Bankës është Rruga "Dritan Hoxha", 92, P.O. Box 2395, Tiranë, Shqipëri.

### Këshilli Drejtues

Anëtarët e Këshillit Drejtues në Dhjetor 2018 janë si më poshtë:

- Borislav Kostadinov, Kryetar i Këshillit Drejtues
- Robert Scott Richards
- Wolfgang Bertelsmeier
- Jovanka Joleska Popovska
- Jordan Damcevski

**Monedha funksionale dhe raportuese.** Pasqyrat financiare janë të raportuara në Lek ("Lek"), e cila është monedha funksionale e Bankës, monedha e mjedisit ekonomik kryesor ku Banka ushtron aktivitetin e saj. Me përjashtim të rasteve kur shprehet në mënyrë të veçantë, informacioni financiar i shprehur në Lek është rumbullakosur në të njëjtën më të afërt.

### 2. Përmbledhje e politikave kontabël

#### Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF") sipas konventës të kostos historike, e ndryshuar nga njohja fillestare e instrumenteve financiare në bazë të vlerës së drejtë, dhe nga rivlerësimi i instrumenteve financiare të kategorizuara me vlerë të drejtë nëpërmjet pasqyrës së fitim humbjeve ("FVTPL") dhe me vlerë të drejtë nëpërmjet pasqyrës së të ardhurave të tjera përmbledhëse ("FVOCI"). Parimi i kontabilitetit që është zbatuar për përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare përcaktohet më poshtë. Krahas ndryshimeve të politikave kontabël të cilat rezultuan nga miratimi dhe adoptimi i standardit SNRF9 dhe SNRF 15 në fuqi nga data 1 janar 2018, këto politika janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme për të gjitha periudhat e prezantuara, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe.

**Përpjekje të vazhdueshme** Drejtimi i Bankës përgatit pasqyrat financiare mbi baza të vazhdueshme. Në funksion të realizimit të saj, drejtimi në gjykimin e tij merr në konsideratë dhe vlerëson pozicionin financiar të Bankës, synimet aktuale, rentabilitetin e operacioneve dhe qasjen në burimet financiare, si dhe analizon ndikimin e situatës në tregun financiar në veprimtarinë dhe operacionet e Bankës.

Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit të Bankës (RMK) në 31 dhjetor 2018 rezultoi 13.75%, ndërsa niveli minimal i raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit të parashikuar për bankat në Shqipëri është 12%. Gjatë vitit të mbyllur më 31 Dhjetor 2018, Banka ka realizuar humbje prej 724,475 mijë LEK. Drejtimi i Bankës parashikon që Banka do të gjenerojë fitime duke filluar nga viti që përfundon më 31 dhjetor 2020 dhe do të vazhdojë të përmbushë kërkesat minimale të raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit dhe do të vazhdojë në vijimësi për të ardhmen e parashikueshme. Mbështetja nga Grupi është gjithashtu e disponueshme sipas nevojave. Në gusht 2019, Grupi parashikon të rrisë më tej borxhin e varur me një shumë shtesë prej 2,000 mijë Euro për të garantuar përputhshmërinë e Bankës me kërkesat për kapital.

#### Të ardhura nga interesat dhe shpenzimet

Të ardhurat dhe shpenzimet e interesit njihen në pasqyrën e të ardhurave me anë të metodës së normës efektive të interesit. Norma efektive e interesit është norma e cila bën aktualizimin e flukseve të pagesave dhe arkëtimeve të pritshme në të ardhmen gjatë jetëgjatësisë së pritshme të aktivitetit ose detyrimit financiar deri në shumën e mbartur të aktivitetit ose detyrimit financiar. Për përcaktimin e normës efektive të interesit, Banka vlerëson fluksin e parasë në të ardhmen, duke marrë në konsideratë kushtet kontraktore të instrumentit financiar, por jo humbjet e kredisë në të ardhmen.

Llogaritja e normës efektive të interesit përfshin të gjitha komisionet e paguara ose të arkëtuara, shpenzimet për transaksionet që janë pjesë e normës efektive të interesit. Shpenzimet e transaksionit përfshijnë shpenzime shtesë që i atribuohen në mënyrë të drejtpërdrejtë blerjes ose emetimit të një aktivi ose detyrimi financiar.

Të ardhurat nga interesi llogariten duke zbatuar normën efektive të interesit në vlerën kontabël bruto të aktiveve financiare, me përjashtim të aktiveve financiare që zhvlerësohen (faza 3), për të cilat të ardhurat nga interesi llogariten duke zbatuar normën efektive të interesit në koston e amortizuar (KC), pa përfshirë provizionin për humbjet e pritshme nga kredia.

Komisionet që janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit përfshijnë komisionet e krijimit që janë arkëtuar ose paguar nga subjekti në lidhje me krijimin ose blerjen e një aktivi financiar ose lëshimin e një detyrimi financiar, për shembull tarifat dhe komisionet për vlerësimin e aftësisë paguese, besueshmërisë, vlerësimin dhe regjistrimin e garancive ose kolateralit, negocimi i kushteve të instrumentit dhe për përpunimin e dokumenteve të transaksionit. Komisionet e angazhimit të arkëtuara nga Banka për të dhënë hua me normat e interesit të tregut janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit nëse është e mundur që Banka do të hyjë në një marrëveshje specifike kredie dhe nuk pret të shesë kredinë që rezulton menjëherë pas dhënies së saj.

#### Të ardhurat dhe shpenzimet nga komisionet

Të ardhurat nga komisionet njihen me kalimin e kohës në mënyrë lëna në momentin e ofrimit të shërbimeve, kur klienti njëkohësisht merr dhe konsumon përfitimet e siguruar nga performanca e Bankës. Këto të ardhura përfshijnë komisionet sistematike për mirëmbajtjen e llogarisë, komisionin për shërbimet e llogarisë. Komisionet e ndryshueshme njihen vetëm deri në atë masë që drejtimi i bankës vendos se është shumë e mundshme që nuk do të ndodhë ndonjë rimarrje e rëndësishme. Të ardhura të tjera nga komisioni, të cilat njihen në një moment kur Banka përmbush detyrimin e saj të performancës, zakonisht pas kryerjes së

transaksionit bazë. Shuma e komisionit të arkëtuar ose të arkëtueshëm përfaqëson çmimin e transaksionit për shërbimet e identifikuar si detyrime të veçanta të performancës. Këto të ardhura përfshijnë komisionet për përpunimin e transaksioneve të pagesave, komisionet për pagesat në mjetet monetare cash, arkëtime ose disbursime cash.

#### Instrumentet financiare – termat dhe kushtet kryesore të matjes

*"Vlera e drejtë"* është çmimi i cili do të përcaktohet dhe arkëtohet për të shitur një aktiv ose do të paguhet për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt midis pjesëmarrësve në treg në datën e matjes në principal ose në mungesë të saj, në tregun me më shumë avantazhe në të cilin Banka ka akses në atë datë. Evidenca më e mirë e vlerës së drejtë është çmimi në një treg aktiv. Një treg konsiderohet si treg aktiv nëse transaksionet për aktivet dhe detyrimet ndodhin me një frekuencë dhe në volume të mjaftueshme për të paraqitur informacion dhe të dhëna për çmimin në mënyrë të vazhdueshme. Vlera e drejtë e instrumenteve financiare të tregtuara në një treg aktiv matet si produkt i çmimit të kuotuar për aktivin ose pasivin individual dhe sasinë e mbajtur nga subjekti. Ky është rasti edhe nëse volumi normal i tregtisë ditore të tregut nuk është i mjaftueshëm për të përthithur sasinë e mbajtur dhe dhënia e urdhrave për të shitur pozicionin në një transaksion të vetëm mund të ndikojë në çmimin e kuotuar.

Teknikat e vlerësimit si modelet e zbritjes së fluksit të parasë ose modelet e bazuara në transaksionet e fundit sipas tregut, ose vlerësimi i të dhënave financiare të investitorëve, përdoren për të matur vlerën e drejtë të instrumenteve të caktuar financiarë për të cilat nuk ekzistojnë informacione mbi çmimet. Matjet e vlerës së drejtë analizohen sipas nivelit në hierarkinë e vlerës së drejtë si më poshtë vijon: (i) niveli i parë janë matjet me çmime të kuotuar (të parregulluara) në tregjet aktive për aktivet ose detyrimet identike, (ii) matjet e nivelit të dytë janë teknikat e vlerësimit me të gjitha të dhënat materiale të vëzhgueshme për aktivet ose detyrimet, qoftë në mënyrë direkte (pra çmimet) ose indirekte (që rezultojnë nga çmimet) dhe (iii) matjet e nivelit të tretë janë vlerësime që nuk bazohen vetëm në të dhënat e vëzhgueshme të tregut (domethënë matja kërkon të dhëna të konsiderueshme jo të vëzhgueshme). Transferimet midis niveleve të hierarkisë së vlerës së drejtë vlerësohen të kenë ndodhur në fund të periudhës së raportimit.

Kostot e transaksionit janë kosto shtesë që i atribuohen drejtpërdrejt blerjes, emetimit ose shitjes së një instrumenti financiar. Një kosto shtesë është ajo kosto që nuk do të kishte ndodhur nëse transaksioni nuk do të ishte kryer. Kostot e transaksionit përfshijnë tarifatat dhe komisionet që u paguhen agjentëve (përfshirë punonjësit që veprojnë si agjentë shitës), konsulentët, ndërmjetësit dhe tregtarët, taksat nga agjencitë rregullatore dhe shkëmbimet e letrave me vlerë, si dhe taksat dhe detyrimet për transferim. Kostot e transaksionit nuk përfshijnë primet e borxheve ose zbritjet, kostot e financimit ose shpenzimet e brendshme administrative ose të mbajtjes.

Kostoja e amortizuar ("KA") përbën shumën me të cilën instrumenti financiar matet në fazën e njohjes fillestare, minus kthimin e principalit, plus vlerën e interesit të akumuluar dhe për aktive financiare minus ndonjë fshirje për shpenzimet e kryera për provigjionimin. Interesi i akumuluar përfshin amortizimin e kostove të transaksionit në njohjen fillestare dhe të ndonjë primi ose zbritje të shumës së maturuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Të ardhurat e akumuluar nga interesi dhe shpenzimet e akumuluar për interesat, duke përfshirë si kuponin e akumuluar dhe zbritjen e amortizuar ose primin (përfshirë komisionet e shtyra në momentin e realizimit, nëse ka) nuk paraqiten të ndara më vete dhe përfshihen në vlerat kontabël të zërave përkatës në pasqyrën e pozicionit financiar.

Metoda e interesit efektiv është një metodë e ndarjes së të ardhurave nga interesi ose shpenzimeve për interesat gjatë periudhës përkatëse, në mënyrë që të arrihet një normë konstante e interesit periodik (norma efektive e interesit) në vlerën kontabël. Norma efektive e interesit është norma që zbritet me saktësi pagesat e ardhshme në mjete monetare cash ose faturat (duke përjashtuar

humbjet e ardhshme të kredisë) përgjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar ose një periudhe më të shkurtër, nëse është e përshtatshme, në vlerën kontabël neto të instrumentit financiar.

Norma efektive e interesit është norma e cila bën aktualizimin e flukseve të mjeteve monetare të instrumenteve me interes të ndryshueshëm deri në datën e rivlerësimit të interesit të ardhshëm, përveç primet ose zbritjes, që pasqyrojnë spreadin e kredisë mbi normën e ndryshueshme të specifikuar në instrument ose variabla të tjera që nuk vendosen për normat e tregut. Primet ose zbritjet amortizohen gjatë tërë jetëgjatësisë së pritshme të instrumentit. Llogaritja e vlerës aktuale përfshin të gjitha pagesat e paguara ose të marra midis palëve në kontratë që janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit. Për aktivet që janë blerë ose janë zhvlerësuar ("POCI") në njohjen fillestare, norma efektive e interesit rregullohet për rrezikun e kredisë, pra ajo llogaritet në bazë të flukseve monetare të pritshme në njohjen fillestare në vend të pagesave kontraktuale.

*Instrumentet financiare – njohja fillestare.* Instrumentet financiare me Vlerën e Drejtë nëpërmjet Pasqyrës së Fitim humbjeve fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë. Të gjithë instrumentet e tjerë financiarë fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë të rregulluar sipas kostove të transaksionit. Vlera e drejtë në njohjen fillestare evidentohet më së miri nga çmimi i transaksionit. Një fitim ose humbje në njohjen fillestare regjistrohet vetëm nëse ka një diferencë midis vlerës së drejtë dhe çmimit të transaksionit që mund të evidentohet nga transaksionet e tjera të cilat ndodhin në treg për të njëjtin instrument ose nga një teknikë vlerësimi, të dhënat e të cilave përfshijnë vetëm të dhëna nga tregjet e vëzhgueshme. Pas njohjes fillestare, provizioni për humbje nga kredia njihet për aktivet financiare të cilat maten me kosto të amortizuar dhe investimet në instrumentet e borxhit të cilat maten me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse, duke rezultuar në këtë mënyrë në një humbje të menjëhershme kontabël.

Të gjitha blerjet dhe shitjet e asetëve financiare që kërkojnë dorëzimin brenda afatit kohor të përcaktuar në bazë të rregullores ose konventës së tregut (blerjet dhe shitjet "në mënyrë të rregullt") regjistrohen në datën e tregtimit, e cila është data në të cilën Banka angazhohet për të dhënë një aktiv financiar. Të gjitha blerjet e tjera njihen kur subjekti bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit.

*Aktivt financiare – klasifikimi dhe matja në vijim – kategoritë e matjes.* Banka klasifikon aktivet financiare në kategoritë e mëposhtme të matjes: me vlerë të drejtë nëpërmjet pasqyrës së fitim humbjeve - FVTPL, me vlerën e drejtë nëpërmjet pasqyrës së të ardhurave të tjera përmbledhëse - FVOCI dhe me kosto të amortizuar - KA. Klasifikimi dhe matja në vijim e aktiveve financiare të borxhit varet nga: (i) modeli i biznesit i Bankës për menaxhimin e portofolit përkatës të aktiveve dhe (ii) karakteristikat e fluksit të mjeteve monetare të aktivit

*Aktivt financiare – klasifikimi dhe matja në vijim – modeli i biznesit.* Modeli i biznesit pasqyron dhe reflekton mënyrën se si Banka administron aktivet që të gjenerojë flukse monetare - nëse objektivi i Bankës është: (i) vetëm për të arkëtuar flukse kontraktuale të mjeteve monetare nga aktivet ("mban për të arkëtuar flukse monetare kontraktuale") ose (ii) për të arkëtuar jo vetëm flukset e mjeteve monetare kontraktuale por dhe flukset e mjeteve monetare që rrjedhin nga shitja e aktiveve ("mban për të mbledhur flukse monetare kontraktuale dhe shet"), ose nëse asnjë prej tyre (i) dhe (ii) nuk aplikohet, aktivet financiare klasifikohen si pjesë e modelit tjetër të biznesit dhe matet me vlerën e drejtë nëpërmjet pasqyrës së fitim humbjeve FVTPL.

Modeli i biznesit përcaktohet për një grup aktivesh (në nivel portofoli) në bazë të të gjitha evidencave përkatëse për aktivitetet që Banka ndërmerr për të arritur objektivin e përcaktuar dhe të vendosur për portofolin e vlefshëm në datën e vlerësimit. Faktorët që Banka ka vlerësuar dhe ka marrë në konsideratë për përcaktimin

e modelit të biznesit përfshijnë qëllimin dhe përbërjen e një portofoli, eksperiencën e kaluar në lidhje me mënyrën se si janë arkëtuar flukset e mjeteve monetare për aktivet përkatëse, mënyrën e vlerësimit dhe menaxhimit të rreziqeve, mënyrën e vlerësimit të ecurisë së aktiveve dhe mënyrën e kompensimit të menaxherëve. Referojuni Shënimit 3 për gjykimet kritike që ka aplikuar Banka në përcaktimin e modeleve të biznesit për asetet e saj financiare

**Aktivet financiare – klasifikimi dhe matja në vijim – karakteristikat e fluksit të mjeteve monetare.** Nëse modeli i biznesit do të mbajë aktive për të arkëtuar flukse monetare kontraktuale ose do të mbaj flukse monetare kontraktuale dhe të shesë, Banka vlerëson nëse flukset e mjeteve monetare përfaqësojnë vetëm pagesat e principalit dhe interesit ("SPPI"). Aktivet financiare me derivate të përfshira konsiderohen dhe vlerësohen në tërësinë e tyre kur përcaktojnë nëse flukset e tyre të mjeteve monetare janë në përputhje me tiparin SPPI. Gjatë këtij vlerësimi, Grupi merr në konsideratë dhe vlerëson nëse flukset monetare kontraktuale janë në përputhje me një marrëveshje bazë të huadhënies, pra nëse Interesi përfshin vetëm pagesën për rrezikun e kredisë, vlerën në kohë të parasë, rreziqet e tjera bazë të huadhënies dhe diferencën marzhin e fitimit.

Nëse kushtet kontraktuale paraqesin ekspozim ndaj rrezikut ose paqëndrueshmërisë që nuk është në përputhje me një marrëveshje bazë të huadhënies, aktiviteti financiar klasifikohet dhe matet me vlerën e drejtë nëpërmjet pasqyrës së fitim humbjeve - FVTPL. Vlerësimi SPPI kryhet në momentin e njohjes fillestare të një aktivi dhe nuk rivlerësohet më pas. Referojuni Shënimit 3 për gjykimet kritike që ka zbatuar Banka në kryerjen e testit SPPI për aktivet e saj financiare.

**Aktivet financiare – riklasifikimi.** Instrumentet financiare riklasifikohen vetëm kur modeli i biznesit për menaxhimin e portofolit në tërësi ndryshon. Riklasifikimi ka një efekt propektiv dhe zhvillohet që nga fillimi i periudhës së parë të raportimit që vijon pas ndryshimit të modelit të biznesit. Banka nuk ka ndryshuar modelin e saj të biznesit gjatë periudhës aktuale dhe nuk ka bërë ndonjë riklasifikim.

**Zhvlërësimi i aktiveve financiare – provizionet për humbjet nga kreditë për humbjet e pritshme ECL.** Banka vlerëson, në bazë të parashikimeve për të ardhmen, Humbjet e pritshme të Kredisë - ECL për instrumentet e borxhit të cilat maten me kosto të amortizuar dhe me vlerë të drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse - FVOCI dhe për ekspozimet që rrjedhin nga angazhimet e huasë dhe kontratat e garancisë financiare. Banka mat humbjen e pritshme të kredisë - ECL dhe njeh fondin e provizioneve për humbjen e kredisë në çdo datë raportimi. Matja e humbjeve të pritshme të kredisë - ECL pasqyron: (i) një vlerë të paanshme dhe të ponderuar të probabilitetit që përcaktohet duke vlerësuar një sërë rezultatesh të mundshme, (ii) vlerën në kohë të parasë dhe (iii) të gjithë informacionin e arsyeshëm dhe mbështetës që është në dispozicion pa koston dhe përpjekjet e panevojshme në fund të çdo periudhe raportuese për ngjarjet e kaluara, kushtet aktuale dhe parashikimet e kushteve të ardhshme.

Instrumentet e borxhit të cilat maten me Kosto të Amortizuar paraqiten në pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar pa fondin e provizionit për humbjet e pritshme të kredisë - ECL. Për angazhimet e kredisë dhe garancitë financiare, një fond i veçantë provizionit për humbjet e pritshme të kredisë - ECL njihet si detyrim në pasqyrën e pozicionit financiar. Për instrumentet e borxhit me vlerën e drejtë nëpërmjet pasqyrës së të ardhurave të thera përmbledhëse - FVOCI, ndryshimet në koston e amortizuar, pa provizionet për humbjet nga kredisë - ECL, njihen në pasqyrën e fitim humbjeve dhe ndryshimet e tjera në vlerën kontabël njihen në pasqyrën e të ardhurave të tjera përmbledhëse duke zbritur humbjet nga instrumentet e borxhit të cilat maten me vlerën e drejtë në pasqyrën e të ardhurave të tjera përmbledhëse - FVOCI.

Banka zbaton një model me tre nivele për zhvlërësim, në bazë të ndryshimeve të cilësisë së kredisë që nga momenti i njohjes

fillestare. Një instrument financiar që nuk është zhvlërësuar në momentin e njohjes fillestare klasifikohet në nivelin 1. Për aktivet financiare në Nivelin 1, humbjet e pritshme të kredisë - ECL maten me një shumë të barabartë me pjesën e humbjes së pritshme të kredisë së jetëgjatësisë që rezulton nga rastet shkakësore të mundshme brenda 12 muajve të ardhshëm ose deri në afatin e maturimit kontraktual, nëse është më i shkurtër ("12 Muaj ECL"). Nëse Banka identifikon një rritje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë ("SICR") që nga momenti i njohjes fillestare, aktiviteti transferohet në Nivelin 2 dhe humbja e pritshme e kredisë - ECL e saj matet në bazë të humbjes së pritshme të kredisë sipas jetëgjatësisë, pra deri në afatin e maturimit kontraktual, por duke marrë në konsideratë parapagimet e pritshme, nëse ka ("Humbjet e pritshme të kredisë gjatë jetëgjatësisë"). Referojuni Shënimit 6 për një përshkrim se si Banka përcakton kur ka ndodhur rritja e rrezikut - SICR. Nëse Banka vendos që një aktiv financiar është zhvlërësuar, aktiviteti transferohet në Nivelin 3 dhe humbja e pritshme e kredisë - ECL e saj matet si humbje e pritshme e kredisë ECL gjatë jetëgjatësisë. Përcaktimi i Bankës për aktivet e zhvlërësuar dhe përcaktimi i mospagesës është shpjeguar në Shënimin 6 Për aktivet financiare që janë blerë ose janë zhvlërësuar ("Aktivet POCI"), humbja e pritshme e kredisë - ECL matet gjithmonë si humbje e pritshme e kredisë ECL gjatë jetëgjatësisë. Shënimi 6 paraqet informacionin në lidhje me të dhënat, supozimet dhe teknikat e vlerësimit që përdoren për matjen e humbjes së pritshme të kredisë ECL, duke përfshirë një shpjegim se si Banka përfshin informacionin e parashikuar për të ardhmen në modelet e humbjes së pritshme të kredisë - ECL.

Si përjashtim, për instrumente të caktuara financiare, si kartat e kreditit, që mund të përfshijnë një hua dhe një element të angazhimit të patërhequr, Banka mat humbjet e pritshme të kredisë gjatë periudhës që Banka është e ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë, pra humbjet e kredisë do të zbuten nga veprimet e administrimit të rrezikut të kredisë, edhe nëse kjo periudhë zgjat përtej periudhës maksimale kontraktuale. Kjo për shkak se aftësia kontraktuale për të kërkuar kthimin dhe anulimin e angazhimit të patërhequr nuk kufizon ekspozimin ndaj humbjeve të kredisë për një periudhë njoftimi kontraktuale.

**Aktivet financiare – fshirja.** Aktivet financiare fshihen tërësisht ose pjesërisht sipas mospagimit dhe mbulimit me kolateral sikundër rregullohet në bazë të rregullores vendase. Fshirja përfaqëson një ngjarje mosnjohjeje. Banka mund të fshijë aktivet financiare që ende janë subjekt i aktivitetit të ekzekutimit nëse Banka kërkon të rimarrë shumat që duhet të paguhet në bazë të kontratës, megjithatë, nuk ka shpresa të arsyeshme për rikuperimin e tyre.

**Mosnjohja e aktiveve financiare.** Banka çregjistron aktivet financiare kur (a) asetet janë liruar ose të drejtat për flukset e mjeteve monetare nga aktivet ndryshe kanë skaduar ose (b) Banka ka transferuar të drejtat ndaj flukseve të mjeteve monetare nga aktivet financiare ose kanë dakordësuar një transferim kualifikues ndërkohë që (i) gjithashtu transferon plotësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aseteve ose (ii) nuk transferon dhe as nuk mban plotësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë, por nuk ruan kontrollin. Kontrolli ruhet në qoftë se pala tjetër nuk ka aftësinë praktike për të shitur asetin në tërësi ndaj një palë të tretë që nuk është e lidhur pa pasur nevojë të vendosë kufizime për shitjen.

**Aktivet financiare - modifikimi.** Banka ndonjëherë rinegocion ose ndryshe modifikon kushtet kontraktuale të aktiveve financiare. Banka vlerëson nëse modifikimi i flukseve monetare kontraktuale është i konsiderueshëm duke marrë parasysh, ndër të tjera, faktorët e mëposhtëm: çdo kusht të ri kontraktual që ndikon në mënyrë të konsiderueshme në profilin e rrezikut të aktivitetit, ndryshim të rëndësishëm në normën e interesit, kolateralin e ri ose rritjen e kredisë që ndikon ndjeshëm në rrezikun e kredisë që lidhet me aktivin ose zgjatjen e konsiderueshme të afatit të një kredie nëse kredimarrësi nuk është në vëntirësi financiare.



Nëse kushtet e modifikuara janë plotësisht të ndryshme, të drejtat ndaj flukseve të mjeteve monetare nga aktivi fillestar skadojnë dhe Banka nuk njihet aktivin financiar fillestar dhe një aktiv të ri me vlerën e tij të drejtë. Data e rinegociimit konsiderohet si data e njohjes fillestare për qëllimet e llogaritjes së zhvlerësimit në vijim, duke përfshirë përcaktimin e faktit nëse ka ndodhur rritja e nivelit të riskut – pra një SICR. Banka gjithashtu vlerëson nëse kredia e re ose instrumenti i borxhit plotëson kriterin SPPI. Çdo diferencë midis vlerës kontabël neto të aktivit fillestar që nuk është njohur dhe vlerës së drejtë të aktivit të ri të modifikuar materialisht njihet në pasqyrën e fitim humbjeve, përveç rastit kur thelbi i diferencës i atribuohet një transaksioni kapital me pronarët.

Në një situatë kur rinegociimi ishte nxitur nga vështirësitë financiare të palës tjetër dhe pamundësia për të bërë pagesat e dakordësuara në fillim, Banka krahason flukset monetare të prishme në fillim dhe të rishikuara për aktivet nëse rreziqet dhe përfitimet e aktivit janë plotësisht të ndryshme si rezultat i modifikimi kontraktual. Nëse rreziqet dhe përfitimet nuk ndryshojnë, aktivi i modifikuar nuk është plotësisht i ndryshëm nga pasuria fillestare dhe modifikimi nuk sjell mos-njohjen. Banka rillogarit vlerën kontabël bruto duke zbritur flukset monetare kontraktuale të modifikuara me normën fillestare të interesit efektiv (ose normën efektive të interesit të rregulluar për aktivet financiare të POCI) dhe një fitim ose humbje nga modifikimi në pasqyrën e fitim humbjeve.

**Detyrimet financiare - kategoritë e matjes.** Detyrimet financiare klasifikohen të matura në vijim me kosto të amortizuara, përveç: (i) detyrimeve financiare që maten me vlerë të drejtë nëpërmjet pasqyrës së fitim humbjeve - FVTPL: ky klasifikim zbatohet për derivativët, detyrimet financiare të mbajtura për tregtim (p.sh. pozicionet afat-shkurtra të letrave me vlerë), pagesa e kushtëzuar e njohur nga një blerës në një kombinim biznesi dhe detyrime të tjera financiare të përcaktuara si të tilla në momentin e njohjes fillestare dhe (ii) kontratat e garancisë financiare dhe angazhimet e huasë.

**Detyrimet financiare - mosnjohja.** Detyrimet financiare nuk njihen kur ato shuhen (pra kur detyrimi i specifikuar në kontratë shkarkohet, anulohet ose skadon).

Një shkëmbim ndërmjet Bankës dhe kreditorëve të saj të fillestarë të instrumenteve të borxhit me terma dhe kushte shumë të ndryshme, si dhe modifikime thelbësore të afateve dhe kushteve të detyrimeve financiare ekzistuese, konsiderohen si fshirje e detyrimit financiar fillestar dhe njohje të një detyrimi të ri financiar. Kushtet janë thelbësisht të ndryshme në qoftë se vlera aktuale e flukseve të mjeteve monetare sipas kushteve të reja, duke përfshirë çdo komision të paguar pa komisionet e arkëtuara dhe të skontuara duke përdorur normën fillestare të interesit efektiv, është të paktën 10% ndryshe nga vlera aktuale e skontuar e flukseve monetare të mbetura të detyrimit financiar fillestar. Nëse një shkëmbim i instrumenteve të borxhit ose modifikimi i afateve konsiderohet si fshirje, çdo shpenzim ose tarifë e paguar njihet si pjesë e fitim humbjes në momentin e fshirjes. Nëse shkëmbimi ose modifikimi nuk konsiderohet si fshirje, çdo shpenzim ose komision që është paguar rregullon vlerën kontabël të detyrimit dhe amortizohet përgjatë afatit të mbetur të detyrimit të modifikuar.

Ndryshimet e detyrimeve që nuk rezultojnë si fshirje konsiderohen si një ndryshim në vlerësim dhe çmuarje duke përdorur një metodë kumulative ndjekëse, me çfarëdo fitimi ose humbjeje të njohur në fitim humbje, përveçse nëse thelbi ekonomik i diferencës në vlerat bartëse i atribuohet transaksioneve kapitale me pronarët.

**Mjete monetare dhe të ngjashme.** Mjete monetare dhe të ngjashme janë zëra që janë lehtësisht të konvertueshëm në shuma të njohura cash dhe të cilat janë subjekt i një rreziku të parëndësishëm të ndryshimeve të vlerës. Mjete monetare dhe të ngjashme përfshijnë të gjitha mjetet monetare, vendosjet ndërbankare dhe depozitat e detyrueshme të rezervave me Bankën e Shqipërisë (BSH), me maturitet fillestare më pak se tre muaj. Fondet e kufizuara për një periudhë më të gjatë se tre muaj në fillim përjashtohen nga Mjetet monetare dhe të ngjashme. Mjete

monetare dhe të ngjashme mbarten me kosto të amortizuara sepse: (i) mbahen për arkëtimin e flukseve monetare kontraktuale dhe ato flukse monetare përfaqësojnë SPPI dhe (ii) nuk janë të përcaktuara me vlerën e drejtë nëpërmjet pasqyrës së fitim humbjeve - FVTPL. Karakteristikat e parashikuara në bazë të legjislacionit, nuk kanë ndikim në testin SPPI, përveçse nëse ato janë të përfshira në terma kontraktuale në mënyrë që elementi të zbatohet edhe nëse legjislacioni ndryshohet në vijim.

Pagesat ose faturat e paraqitura në pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare përfaqësojnë transfertat e Mjeteve monetare dhe të ngjashme nga Banka, duke përfshirë shumat e paguara ose të kredituara në llogaritë rrjedhëse të kundërpalëve të Bankës që mbahen në Bankë, siç janë të ardhurat nga interesi i kredisë ose principali i cili arkëtohet duke debituar llogarinë rrjedhëse të klientit ose pagesat e interesit apo disbursimi i kredive të kredituara në llogarinë rrjedhëse të klientit, që paraqet Mjete monetare dhe të ngjashme nga perspektiva e klientit.

**Llogari të detyrueshme me Bankën Qendrore.** Llogari të detyrueshme me Bankën Qendrore mbahen me kosto të amortizuara dhe përfaqësojnë depozita të rezervave të detyrueshme që nuk gjenerojnë interes të cilat nuk janë të vlefshme për të financuar veprimtarinë e përditshme të Bankës dhe rrjedhimisht nuk konsiderohen pjesë e mjeteve monetare dhe të ngjashme për qëllimet e pasqyrës së flukseve të mjeteve monetare.

**Detyrime nga banka të tjera.** Shumat të cilat duhet të paguhen nga banka të tjera regjistruar kur Banka u jep para bankave të tjera, pa qëllime tregtimi të të ardhurave të arkëtueshme jo-derivative që duhet të paguhen në datat fikse ose të përcaktueshme. Shumat që paguhen nga bankat e tjera mbahen me kosto të amortizuara nëse: (i) ato mbahen për qëllime të arkëtimit të flukseve të mjeteve monetare kontraktuale dhe nëse këto flukse monetare përfaqësojnë SPPI dhe (ii) ato nuk janë të përcaktuara që të maten me vlerë të drejtë nëpërmjet pasqyrës së fitim humbjeve - FVTPL.

**Investimet në letrat me vlerë të borxhit.** Bazuar në modelin e biznesit dhe karakteristikat e fluksit të mjeteve monetare, Banka klasifikon investimet në letrat me vlerë të borxhit të matura me kosto të amortizuara, vlerën e drejtë nëpërmjet pasqyrës së të ardhurave të tjera përmbledhëse - FVOCI ose me vlerë të drejtë nëpërmjet pasqyrës së fitim humbjeve - FVTPL në varësi të rezultateve të vlerësimit BM dhe provës SPPI. Letrat me vlerë të borxhit maten me kosto të amortizuara nëse ato mbahen për arkëtimin e flukseve të mjeteve monetare kontraktuale dhe nëse këto flukse të mjeteve monetare përfaqësojnë SPPI dhe nëse ato nuk janë të përcaktuara vullnetarisht me vlerën e drejtë nëpërmjet pasqyrës së fitim humbjeve - FVTPL, në mënyrë që të reduktohet ndjeshëm mospërputhja kontabël.

Letrat me vlerë të borxhit maten me vlerën e drejtë nëpërmjet pasqyrës së të ardhurave të tjera përmbledhëse - FVOCI nëse ato mbahen për arkëtimin e flukseve monetare kontraktuale dhe për shitje, ku këto flukse monetare përfaqësojnë SPPI dhe nëse ato nuk janë të përcaktuara me vlerën e drejtë nëpërmjet pasqyrës së fitim humbjeve - FVTPL. Të ardhurat nga këto aktive janë llogaritur duke përdorur metodën e interesit efektiv dhe njihen në pasqyrën e fitim humbjeve.

Fondi i provizioneve për zhvlerësim që është vlerësuar duke përdorur modelin e humbjes së prishme të kredisë njihet në fitimin ose humbjen e periudhës. Të gjitha ndryshimet e tjera në vlerën kontabël njihen në pasqyrën e të ardhurave të tjera përmbledhëse - OCI. Nëse sigurimi i borxhit nuk njihet, fitimi ose humbja kumulative e njohur më parë në klasifikohet nga pasqyra e të ardhurave të tjera përmbledhëse - OCI në pasqyrën e fitim humbjeve.

Investimet në letrat me vlerë të borxhit maten me vlerën e drejtë nëpërmjet pasqyrës së fitim humbjeve - FVTPL nëse ato nuk i plotësojnë kriteret për kosto të amortizuara ose me vlerë të drejtë nëpërmjet pasqyrës së të ardhurave të tjera përmbledhëse - FVOCI. Banka gjithashtu mund të përcaktojë në mënyrë të pakthyeshme investimet në letrat me vlerë të borxhit me vlerën e drejtë nëpërmjet

pasqyrës së fitim humbjeve - FVTPL për njohjen fillestare nëse zbatimi i këtij opsioni zvogëlon ndjeshëm një mospërputhje kontabël mes aktiveve dhe pasiveve financiare që njihen ose maten në baza të ndryshme kontabël.

**Hua dhe paradhënie klientëve.** Hua dhe paradhënie klientëve regjistrohen kur Banka jep paradhënie për të blerë ose disburson një kredi që duhet të paguajë klienti. Bazuar në modelin e biznesit dhe karakteristikat e fluksit të mjeteve monetare, Banka klasifikon huatë dhe paradhëniet e klientëve në një nga kategoritë e mëposhtme të matjes: (i) me kosto të amortizuar - Kreditë që mbahen për arëtimin e fluksive monetare kontraktuale dhe ato fluksive monetare përfaqësojnë SPPI dhe huatë që nuk janë të përcaktuara vullnetarisht me vlerë të drejtë nëpërmjet pasqyrës së fitim humbjeve - FVTPL dhe (ii) me vlerë të drejtë nëpërmjet pasqyrës së fitim humbjeve - FVTPL: kreditë që nuk përbushin testin SPPI ose kritere të tjera për tu matur me kosto të amortizuar ose me vlerë të drejtë nëpërmjet pasqyrës së të ardhurave të tjera përmbledhëse -FVOCI maten me vlerë të drejtë nëpërmjet pasqyrës së fitim humbjeve.

Provizionet për zhvlerësim përcaktohen në bazë të modeleve të parashikimit të humbjes së pritshme të kredisë - ECL. Shënimi 6 paraqet informacion në lidhje me të dhënat, supozimet dhe teknikat e vlerësimit që përdoren për matjen e humbjes së pritshme të kredisë - ECL, duke përfshirë një shpjegim se si Banka përfshin informacionin e parashikuar në modelet ECL.

**Kolateral i rimarrë në zotërim.** Kolaterali i rimarrë në zotërim përfaqëson aktivet financiare dhe jofinanciare të përvetësuara nga Banka për likuidimin e kredive të papaguara. Aktivet fillimisht njihen me vlerën e drejtë në momentin e përvetësimit dhe përfshihen tek mjediset dhe pajisjet, aktivet e tjera financiare, investime në prona ose në inventarë brenda aktiveve të tjera pavarësisht nga natyra e tyre dhe qëllimi i Bankës në lidhje me rikuperimin e këtyre aktiveve dhe më pas rimaten dhe llogariten në përputhje me politikat kontabël për këto kategori të aktiveve.

Kolaterali i rimarrë në zotërim i Bankës në datën e raportimit kryesisht përfshihet në inventarët brenda aktiveve të tjera dhe më pas matet në nivelin më të ulët midis kostos, zakonisht të përcaktuar në bazë të procedurave të ekzekutimit dhe vlera neto e realizueshme, duke qenë vlera e drejtë e kolateralit të përcaktuar nga vlerësuesit e pavarur të jashtëm që kanë kualifikim profesional dhe licencë të njohur dhe relevante me përvojë në vlerësimin e vendndodhjes dhe kategorive të ngjashme, më pak shpenzime për realizimin e shitjes. Kolaterali i rimarrë në zotërim që mbahet për qëllime qiraje ose vlerësimi të kapitalit është përfshirë në aktivet afatgjata materiale të investuara. Kolaterali i luajtshëm dhe kolaterali i paluajtshëm me çështjet që lidhen me titujt ligjorë nuk njihen si aktiv në momentin e marrjes në zotërim. Çdo humbje që rrjedh nga rivlerësimi i mësipërm regjistrohet në fitim ose humbje. Fitimet ose humbjet nga shitja e këtyre aktiveve njihen në pasqyrën e fitim humbjeve.

**Angazhimet e kredisë.** Grupi merr angazhime për të siguruar dhe dhënë kredi. Këto angazhime janë të përvokueshme ose të revokueshme vetëm në përgjigje të një ndryshimi të pafavorshëm material. Këto angazhime fillimisht njihen me vlerën e tyre të drejtë, e cila normalisht evidentohet nga shuma e tarifave të arkëtuara. Kjo shumë amortizohet në mënyrë lineare gjatë jetëgjatësisë së angazhimit, me përjashtim të angazhimeve për të dhënë kredi, nëse është e mundur që Banka të hyjë në një marrëveshje specifike kredie dhe nuk parashikon të shesë kredinë që rezulton menjëherë pas dhënies së saj; pagesat e angazhimit të kredisë shtyhen dhe përfshihen në vlerën kontabël të huasë në momentin e njohjes fillestare. Në fund të çdo periudhe raportimi, angazhimet maten me (i) gjendjen e mbetur të paamortizuar të shumës në momentin e njohjes fillestare, plus (ii) shumën e provizionit për humbjen të përcaktuar në bazë të modelit të humbjes së pritshme të kredisë, përveçse nëse angazhimi është për të siguruar një hua me një normë interesi më poshtë se normat e tregut, rast në të cilin matja është më e lartë se këto dy shuma. Vlera kontabël e angazhimeve të

huasë përfaqëson një detyrim. Për kontratat që përfshijnë një hua dhe një angazhim të patërhequr dhe kur Banka nuk mund të dallojë ndaras humbjen e pritshme të kredisë – ECL për komponentin e kredisë së patërhequr nga komponenti i kredisë, humbja e pritshme e kredisë - ECL për angazhimin e patërhequr njihet së bashku me provizionin për humbjen e huasë. Deri në masën që humbjet e kombinuara të pritshme të kredisë tejkalojnë vlerën kontabël bruto të kredisë, ato njihen si detyrim.

**Garancitë financiare.** Garancitë financiare kërkojnë që Banka të bëjë pagesa të caktuara për të rimbursuar titullarin e garancisë për një humbje që lind sepse një debitor i caktuar nuk arrin të bëjë pagesën në kohën e duhur në përputhje me kushtet fillestare ose të modifikuara të një instrumenti borxhi. Garancitë financiare fillimisht njihen me vlerën e tyre të drejtë, e cila normalisht evidentohet nga shuma e tarifave të arkëtuara. Kjo shumë amortizohet në mënyrë lineare gjatë jetëgjatësisë së garancisë. Në fund të secilës periudhë raportimi, garancitë maten në nivelin më të lartë (i) të shumës së provizionit për humbjen për ekspozimin e garantuar të përcaktuar bazuar në modelin e humbjes së pritshme dhe (ii) gjendjen e mbetur të paamortizuar të shumës në momentin e njohjes fillestare. Përveç kësaj, provizioni për humbjen e pritshme të kredisë - ECL njihet për tarifën e arkëtueshme që njihen në pasqyrën e pozicionit financiar si një aktiv.

**Garancitë e kontratës.** Garancitë e kontratës janë kontrata që ofrojnë kompensim nëse një palë tjetër nuk arrin të përmbushë një detyrim kontraktual. Këto Kontrata transferojnë rrezikun jofinanciar të kontratës përveç rrezikut të kredisë. Garancitë e kontratës fillimisht njihen me vlerën e tyre të drejtë, e cila normalisht evidentohet nga shuma e tarifave të arkëtuara. Kjo shumë amortizohet në mënyrë lineare për gjatë jetëgjatësisë së kontratës. Në fund të secilës periudhë raportimi, kontratat e garancisë maten në nivelin më të lartë të (i) gjendjes të paamortizuar të shumës në momentin e njohjes fillestare dhe (ii) vlerësimit dhe çmuarjes më të mirë të shpenzimeve të nevojshme për të zgjidhur kontratën në fund të çdo periudhe raportimi, duke zbritur në vlerën aktuale. Kur Banka ka të drejtën kontraktuale për t'iu kthyer klientit të saj për rikuperimin e shumave të paguara për të shlyer kontratat e garancisë, këto shuma do të njihen si hua dhe të arkëtueshme pas transferimit të kompensimit të humbjes tek përfituesi i garancisë. Këto tarifa njihen tek të ardhurat nga komisionet në pasqyrën e fitim humbjeve.

**Kompensimi.** Aktivet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe vlera neto paraqitet në pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar kur dhe vetëm kur Banka gëzon të drejtën ligjore për të bërë kompensimin e shumave dhe vlerave, dhe ka si qëllim likuidimin mbi bazën neto ose likuidimin e aktivitetit dhe shlyerjen e detyrimit njëkohësisht. Kjo e drejtë kompensimi (a) nuk duhet të jetë e kushtëzuar nga një ngjarje e ardhshme dhe (b) duhet të jetë ligjërisht e zbatueshme në të gjitha rrethanat e mëposhtme: (i) në rrjedhën normale të biznesit, (ii) në rast shkakësor/mospagimi (iii) rastet e paaftësisë paguese ose falimentimit.

#### Aktive materiale të investuara

Investimet në prona mbahen nga Banka për të fituar të ardhura nga qiraja ose për vlerësimin e kapitalit, ose për të dyja qëllimet. Investimet në prona përfshijnë aktivet për përdorime në të ardhmen për qëllime investimi. Investimet në prona paraqiten me koston e tyre historike neto pasi iu është zbritur zhvlerësimi i akumuluar dhe ndonjë humbje nga zhvlerësimi. Nëse ekziston ndonjë tregues që investimi në prona mund të zhvlerësohet, Banka vlerëson shumën e rikuperueshme si vlera më e lartë në përdorim dhe vlerën e drejtë minus koston e shitjes. Vlera kontabël neto e një investimi në pronë fshihet deri në shumën e rikuperueshme nëpërmjet një pagese në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve për periudhën. Humbja nga zhvlerësimi e njohur në vitet e mëparshme kthehet nëse ka pasur një ndryshim të mëvonshëm në vlerësimet dhe çmuarjet e përdorura për të përcaktuar shumën e rikuperueshme të aktivitetit. Shpenzimet e mëtejshme janë përfshirë në vlerën e mbartur të aktivitetit, ose njihen si një aktiv më vete, sipas rastit, në rast se



ekzistojnë mundësi të rrisin të mirat dhe përfitimet e ardhshme ekonomike të këtij mjetei specifik në Bankë dhe shpenzimet e aktivitetit mund të maten në mënyrë të besueshme. Të gjitha riparimet e tjera dhe mirëmbajtja klasifikohen tek shpenzimet operative gjatë periudhës financiare gjatë cilës janë kryer këto shpenzime. Nëse investimi në pronë zotërohet nga pronari, ajo klasifikohet tek ndërtesat dhe pajisjet. Të ardhurat e fituara nga qiraja regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin në kategorinë e të ardhurave të tjera operative. Fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga ndryshimet në vlerën e drejtë të investimit në pronë regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin dhe paraqiten më vete.

#### Ndërtesat dhe pajisjet

Ndërtesat dhe pajisjet dhe investimet në prona paraqiten me koston e tyre historike neto pasi iu është zbritur zhvlerësimi i akumuluar dhe ndonjë humbje nga zhvlerësimi. Kostot historike përfshijnë të gjitha shpenzimet të cilat mund t'i atribuohen në mënyrë të drejtpërdrejtë blerjes së aktivitetit dhe mjeteve.

Shpenzimet e mëtejshme janë përfshirë në vlerën e mbartur të aktivitetit, ose njihen si një aktiv më vete, sipas rastit, në rast se ekzistojnë mundësi të rrisin të mirat e ardhshme ekonomike të këtij

mjeti specifik në Bankë dhe shpenzimet e aktivitetit mund të maten në mënyrë të besueshme. Të gjitha riparimet e tjera dhe mirëmbajtja klasifikohen tek shpenzimet operative gjatë periudhës financiare gjatë cilës janë kryer këto shpenzime.

Në fund të çdo periudhe raportimi, drejtimi i bankës vlerëson nëse ka ndonjë tregues të zhvlerësimit të mjediseve dhe pajisjeve. Nëse ndonjë tregues i tillë ekziston, drejtimi i bankës vlerëson shumën e rikuperueshme, e cila përcaktohet si vlera më e lartë e një aktiviteti me vlerën e drejtë minus koston për shitjen dhe vlerën e saj në përdorim. Vlera kontabël është zvogëluar në shumën e rikuperueshme dhe humbja nga zhvlerësimi njihet në pasqyrën e fitimit humbjeve për vitin. Një humbje nga zhvlerësimi i njohur për një aktivitet në vitet e mëparshme anulohet nëse ka pasur një ndryshim në vlerësimet dhe çmuarjet që janë përdorur për të përcaktuar vlerën e aktivitetit në përdorim ose vlerën e drejtë minus koston për shitje.

Trojet dhe aktivitetet në ndërtim nuk zhvlerësohen. Zhvlerësimi i aktiveve realizohet duke përdorur metodën lineare sipas normave të përcaktuara për koston dhe shpenzimet për pronën dhe pajisjet gjatë kohëzgjatjes së përdorimit të tyre. Normat vjetore të zhvlerësimit përcaktohen në bazë të jetëgjatësisë së parashikuar të aktiveve të caktuara sipas tabelës që paraqitet më poshtë:

Përshkrimi	Jetëgjatësia
Kompjuter dhe pajisje elektronike	5 vjet
Automjete	5 vjet
Mobilje dhe pajisje	10 vjet
Ndërtesa	40 vjet

#### Aktive afat-gjata jomateriale

Aktive afat-gjata jomateriale përfshijnë kryesisht licencat e programeve kompjuterike të cilat kapitalizohen në bazë të kostove për blerjen e tyre dhe përdorimin e një softuerit të caktuar. Aktive afat-gjata jomateriale njihen në rast se ekzistojnë mundësi të rrisin të mirat e ardhshme ekonomike të këtij mjetei specifik në Bankë dhe shpenzimet e aktivitetit mund të maten në mënyrë të besueshme. Aktive afat-gjata jomateriale maten dhe vlerësohen fillimisht me koston. Vlera kontabël e aktiveve afat-gjata jomateriale rishikohen për zhvlerësim nëse ngjarjet ose ndryshimet e rrethanave evidentojnë se vlera e mbartur nuk mund të rikuperohet. Aktive afat-gjata jomateriale përfshijnë programet kompjuterike të cilat amortizohen duke përdorur metodën lineare të amortizimit për të gjithë jetëgjatësinë e dobishme prej dhjetë vjet.

#### Qira operative

Nëse Banka është qiramarrëse në një kontratë qiraje, e cila nuk transferon në mënyrë të konsiderueshme të gjitha rreziqet dhe përfitimet që lidhen me pronësinë nga qiradhënësi në Grup, pagesat e përgjithshme të qirasë paraqiten në pasqyrën e fitimit humbjeve për vitin (shpenzimet e qirasë) në mënyrë lineare përgjatë periudhës së qirasë. Kur asetet janë dhënë me qira sipas një qiraje operacionale, pagesat e arkëtimeve të qirasë njihen si të ardhura nga qiraja në mënyrë lineare përgjatë afatit të qirasë.

#### Detyrime ndaj bankave të tjera.

Shumat që janë detyrime ndaj bankave të tjera regjistrohen në momentin që banka i akordon mjetet monetare ose aktivitetet e tjera bankave të tjera. Detyrimi jo-derivativ mbartet me koston e amortizuar. Nëse Banka blen borxhin e vet, detyrimi hiqet nga pasqyra e pozicionit financiar dhe diferenca midis vlerës kontabël të pasivitetit dhe shumës së paguar është përfshirë në fitimet ose humbjet që rrjedhin nga likuidimi i borxhit.

#### Llogaritë e klientit.

Llogaritë e klientëve janë detyrime jo-derivative ndaj individëve, klientëve institucionale ose korporatave dhe mbahen me koston të amortizuar.

#### Fonde të tjera të marrë hua.

Fondet e tjera të marrë hua përfshijnë kreditë e marra nga institucionet financiare ndërkombëtare. Fondet e marrë hua kontabilizohen me koston të amortizuar.

#### Borxhi i varur.

Borxhi i varur mund të paguhet vetëm në rast të likuidimit pasi të jenë plotësuar kërkesat e kreditorëve të tjerë me prioritet më të lartë. Borxhi i varur kontabilizohet me koston të amortizuar.

#### Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin është paraqitur në pasqyrat financiare në përputhje me legjislacionin e miratuar në fuqi ose që do të jetë në fuqi në vijim deri në fund të periudhës së raportimit. Shpenzimet për tatimin mbi fitimin përfshijnë të drejtat tatimore afatshkurtra dhe të drejtat tatimore të shtyra dhe njihen në pasqyrën e fitimit humbjes për vitin, përveçse kur njihen në pasqyrën e të ardhurave të tjera përmbledhëse ose drejtpërdrejt në kapital sepse lidhet me transaksionet që njihen gjithashtu, në të njëjtën periudhë ose në një periudhë tjetër, në të ardhura të tjera përmbledhëse ose direkt në kapital.

Tatimi afatshkurtër është shuma që pritet të paguhet ose të rimburohet nga autoritetet tatimore në lidhje me fitimet ose humbjet e tatueshme për periudhën aktuale dhe ato të mëparshme. Fitimet ose humbjet e tatueshme bazohen në vlerësimet dhe çmuarjet nëse pasqyrat financiare janë autorizuara përpara dorëzimit të deklaratave përkatëse tatimore. Tatimet përveç të ardhurave regjistrohen tek shpenzimet administrative dhe shpenzime të tjera operative.

Tatimi i shtyrë paraqitet duke përdorur metodën e pasivitetit të bilancit për humbjen nga tatimet të cilat mbarten dhe diferencat e përkohshme që lindin midis bazës tatimore të aktiveve dhe pasiveve dhe vlerave të tyre kontabël për qëllime të raportimit financiar. Tatimi i shtyrë matet me normat e tatimit të miratuara ose në fuqi në fund të periudhës raportuese, të cilat pritet të zbatohen në periudhën kur diferencat e përkohshme do të rimerren ose humbja tatimore e mbartur do të përdoret. Të drejtat tatimore të

shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme dhe humbjet tatimore që barten regjistrohen vetëm deri në masën që është e mundur që fitimi i tatuashëm i ardhshëm të jetë i disponueshëm përkundrejt të cilit mund të përdoren zbritjet.

#### **Pozicione tatimore të pasigurta**

Pozitat tatimore të pasigurta të Bankës rishqyrtohen nga drejtimi i bankës në fund të çdo periudhe raportimi. Detyrimet regjistrohen për pozicionet e tatimit mbi fitimin të cilat përcaktohen nga drejtimi i bankës, pasi ka më shumë gjasa që të mos rezultojë në vendosjen e taksave shtesë nëse pozicionet do të kundërshtoheshin nga autoritetet tatimore.

Vlerësimi bazohet në interpretimin e ligjeve tatimore që janë miratuar ose në fuqi deri në fund të periudhës së raportimit, dhe çdo vendim gjykatë të njohur ose vendime të tjera për çështje të tilla. Detyrimet për penalitetet, interesat dhe tatimet përveç të ardhurave njihen bazuar në vlerësimin më të mirë të drejtimit të bankës të shpenzimeve të nevojshme që duhen për të shlyer detyrimet në fund të periudhës së raportimit.

#### **Përfitimet e punonjësve**

Banka operon vetëm me pagimin e kontribute të detyrueshme të sigurimeve shoqërore të cilat gjenerojnë përfitime pensioni për punonjësit. Autoritetet lokale janë përgjegjës për përcaktimin pragun minimal ligjor për pensionet në Shqipëri sipas një plani të përcaktuar të kontributeve për pension. Kontributet e Bankës në planin e pensionit paraqiten në pasqyrën e të ardhurave në momentin e pagesës.

#### **Provizione për detyrime dhe shpenzime**

Provizionet për detyrimet dhe shpenzime janë detyrime jofinanciare gjatë një kohe të pasigurt dhe në një shumë të pacaktuar. Ato përlllogariten nëse Banka ka një detyrim aktual ligjor ose konstruktiv si rezultat i ngjarjeve të kaluara, dhe ka mundësi që të duhet një fluks mjeteve monetare që përfshijnë përfitime ekonomike për të shlyer detyrimin dhe mund të bëhet një vlerësim i besueshëm i shumës së detyrimit.

Taksat dhe detyrimet, të tilla si tatimet përveç tatimit mbi fitimin ose tarifave rregullatore të bazuara në informacionet që lidhen me një periudhë para lindjes së detyrimit për të paguar, njihen si detyrime në momentin e ndodhjes së ngjarjes kur lind detyrimi për pagesën e taksës, siç përcaktohet nga legjislacioni që parashikon detyrimin për të paguar taksën. Nëse një taksë paguhet përpara ndodhjes së ngjarjes detyruese, ajo njihet si parapagim.

#### **Detyrimet tregtare dhe të tjera që duhet të paguhen**

Detyrimet tregtare përlllogariten në momentin kur kundërpala ka përmbushur detyrimet e saj në bazë të kontratës dhe kontabilizohen me kosto të amortizuar.

#### **Kapitali aksioner**

Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapital. Kostot rritëse që i atribuohen drejtpërdrejt emetimit të aksioneve të reja janë paraqitur në kapital si një zbritje, pa tatimin, nga të ardhurat. Çdo tejkallim i vlerës së drejtë të pagesës së marrë mbi vlerën nominale të aksioneve të emetuara regjistrohet si prim aksioni në kapital.

Gjatë administrimit të pozicionit të këmbimit valutor, Banka gjithashtu merr parasysh faktin se kapitali neto është në euro.

Dividendët për aksionet e zakonshme njihen në kapitalin në periudhën kur miratohen nga aksionerët e Bankës. Dividendët për vitin që janë deklaruar pas datës së raportimit paraqiten si ngjarje pas përfundimit të periudhës së raportimit. Raportet statutorë të kontabilitetit të Bankës përbëjnë bazën për shpërndarjen e fitimit dhe përvetësimeve të tjera.

#### **Transaksionet e këmbimeve valutore**

Transaksionet e këmbimeve valutore janë kthyer në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të vlefshëm në datën e transaksioneve. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit janë këmbyer në monedhën funksionale me kursin e këmbimit zyrtar të Bankës së Shqipërisë "BSH" në datën e raportimit.

Fitimi ose humbja nga këmbimet valutore që rezultojnë nga kryerja e transaksioneve dhe nga konvertimi i mjeteve monetare dhe detyrimeve në monedhën funksionale të subjektit me kursin e këmbimit zyrtar të Bankës së Shqipërisë njihen në pasqyrën e të fitim humbjeve për periudhën (si fitime nga këmbimi valutor pa humbjet). Konvertimi me normat në fund të vitit nuk aplikohet për zërat jo-monetarë të cilët maten me koston historike.

Zërat jo-monetarë të cilat maten me vlerën e drejtë në monedhë të huaj, përfshirë investimet e kapitalit, konvertohen me kursin e këmbimit në datën e përcaktimit të vlerës së drejtë.

Efektet e ndryshimeve të kursit të këmbimit në zërat jo-monetarë që maten me vlerën e drejtë në një monedhë të huaj regjistrohen si pjesë e fitimit ose humbjes me vlerën e drejtë.

#### **Paraqitja në Euro**

Krahas paraqitjes së pasqyrave financiare në monedhën funksionale të bankës, informacioni plotësues në Euro është përgatitur për qëllime informimi të përdoruesve të pasqyrave financiare, duke konvertuar shifrat nga LEK'000 në EUR'000.

Pasqyra e pozicionit financiar për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017 është konvertuar me kursin e këmbimit zyrtar të Bankës së Shqipërisë në datën 31 Dhjetor 2018 prej 123.42 LEK për 1 Euro (2016: 132.95). Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe e të ardhurave përmbledhëse dhe pasqyra e fluksit të mjeteve monetare janë konvertuar me kursin e këmbimit mesatar për vitin prej 127.58 LEK për 1 Euro (2017: 134.13 LEK për 1 Euro).

Informacioni plotësues në EUR nuk është pjesë e pasqyrave financiare.

### 3. Çmuarje dhe gjykime kontabël kritike për zbatimin e politikave kontabël

Banka bën vlerësime dhe supozime që ndikojnë në shumat e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar. Çmuarjet dhe gjykimet vlerësohen vazhdimisht dhe bazohen në përvojën e drejtimit të bankës dhe në faktorë të tjerë, duke përfshirë pritshmëritë e ngjarjeve të ardhshme që besohet të jenë të arsyeshme sipas rrethanave. Drejtimi i Bankës gjithashtu bën gjykime të caktuara, përveç atyre që përfshijnë çmuarje, në procesin e zbatimit të politikave kontabël. Vendimet që kanë efektin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare dhe çmuarjet që mund të mundësojnë një rregullim domethënës të vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar përfshijnë:

**Matja e humbjes së pritshme të kredisë -ECL.** Matja e humbjes së pritshme të kredisë -ECL është një çmuarje dhe vlerësim i rëndësishëm që përfshin përcaktimin e metodologjisë, modeleve dhe regjistrimin e të dhënave. Detajet e metodologjisë së matjes së humbjes së pritshme të kredisë - ECL paraqiten në Shënimin 6. Komponentët e mëposhtëm kanë një ndikim të madh në fondin e provizioneve për humbjen e kredisë: përcaktimi i mospagesës, rritja e rrezikut - SICR, probabiliteti i vonësës ("PD"), ekspozimi i papaguar ("EAD") dhe humbja standard e caktuar ("LGD"), si dhe modelët e skenarëve makroekonomikë. Grupi rregullisht shqyrton dhe miraton modelët dhe të dhënat e modeleve për të zvogëluar çdo dallim midis vlerësimeve të humbjeve të pritshme të kredisë dhe eksperiencës aktuale të humbjes së kredisë.

Banka ka përdorur informacion mbështetës të parashikuar për matjen e humbjes së pritshme të kredisë - ECL, kryesisht një rezultat i modelit të saj të parashikimit makroekonomik. Disa sasi makroekonomike janë investiguar në lidhje me potencialin e tyre si pjesë e modelit të PD. Afatet kohore të faktorëve makroekonomikë janë marrë nga Baza e të Dhënave të Botës Ekonomike të FMN-së, veçanërisht për Shqipërinë. Në veçanti, konsiderohen të paktën sasitë e mëposhtme për specifikimin e modeleve të PD-së: Rritja e produktit të brendshëm bruto, Ndryshimi në përqindje të inflacionit, Shkalla e papunësisë.

Këto sasi reflektojnë drejtpërdrejt zhvillimin e ciklit të biznesit dhe për këtë arsye janë të dhëna të vlefshme potenciale për një model kuptimplotë të PD-së. Për vlerësimin e LGD-ve në një kohë të caktuar, përfshihen disa faktorë shtesë, sepse këtu nuk duhet të modelohet vetëm rreziku i mospagesës, por edhe faktorët makroekonomikë influencues.

**Ekspozimi i kredisë për linjat e kredive të rinovueshme (p.sh. kartat e kreditit, paradhënit bankare).** Për linja të caktuara kredie të kredisë, ekspozimi i Bankës ndaj humbjeve të kredisë mund të zgjasë përtej periudhës maksimale kontraktuale të kredisë. Ky përjashtim zbatohet për disa produkte kredie të rinovueshme, të cilat përfshijnë një kredi dhe një komponent angazhimi të patërhequr dhe ku aftësia kontraktuale e Bankës për të kërkuar shlyerjen dhe anulimin e komponentit të patërhequr në praktikë nuk e kufizon ekspozimin ndaj humbjeve të kredisë.

Për këto kredi, Banka mat humbjet e pritshme të kredisë - ECL përgjatë periudhës kur Banka është e ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë dhe humbjet e pritshme të kredisë ECL nuk zbuten nga veprimet e administrimit të rrezikut të kredisë. Zbatimi i këtij përjashtimi kërkon gjykimin. Drejtimi i bankës ka zbatuar gjykimin e tij në identifikimin e produkteve të kredisë, si private ashtu edhe të biznesit, për të cilat zbatohet ky përjashtim. Banka ka aplikuar këtë përjashtim për kreditë me karakteristikat e mëposhtme: (a) nuk ka një afat të caktuar ose strukturë ripagimit; (b) aftësia kontraktuale për të anuluar kontratën nuk zbatohet në praktikë si rezultat i menaxhimit të përditshëm të ekspozimit të kredisë dhe kontrata mund të anulohet vetëm kur Banka informohet mbi rritjen e rrezikut të kredisë në nivel të një linje kredie individuale dhe (c) ekspozimet menaxhohen në mënyrë kolektive. Më tej, Banka ka zbatuar gjykimin për përcaktimin e një periudhe për matjen e humbjes së pritshme të kredisë ECL, duke përfshirë pikën fillestare dhe pikën e mbylljes së ekspozimeve.

Banka ka vlerësuar informacionin dhe përvojën historike në lidhje me: (a) periudhën gjatë së cilës Banka është e ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë për linja të ngjashme kredie, duke përfshirë edhe ndryshimin e fundit të rëndësishëm të kredisë dhe për këtë arsye përcakton pikënisjen për vlerësimin e rritjes së rrezikut SICR (b) kohëzgjatjen e vonësës në pagesë për instrumente financiare të ngjashme pas rritjes së rrezikut SICR dhe (c) veprimet e administrimit të rrezikut të kredisë (p.sh. reduktimi ose heqja e kufijve të patërhequr), normat e parapagimit dhe faktorë të tjerë që nxisin maturitetin e pritshëm. Me zbatimin e këtyre faktorëve, Banka segmenton portofolet e linjave të kredive të rinovueshme në nën-grupe dhe zbaton faktorët që janë më të rëndësishëm në bazë të të dhënave historike dhe përvojës, si dhe informacione dhe të dhëna të parashikueshme.

**Rritje e ndjeshme në rrezikun e kredisë ("SICR").** Për të përcaktuar nëse ka pasur një rritje të ndjeshme të rrezikut të kredisë, Banka krahason rrezikun e një mospagimi që ndodh gjatë jetëgjatësisë së një instrumenti financiar në fund të datës së raportimit me rrezikun e mospagimit në datën e njohjes fillestare. Vlerësimi konsideron rritjen relative të rrezikut të kredisë në vend të arritjes së një niveli specifik të rrezikut të kredisë në fund të periudhës së raportimit. Banka i konsideron të gjitha informacionet e arsyeshme dhe mbështetëse të parashikuara pa kosto dhe përpjekje të panevojshme, të cilat përfshijnë një sërë faktorësh, duke përfshirë aspektet e sjelljes së portofoleve të veçanta të klientëve. Banka identifikon treguesit e sjelljes të rritjes së rrezikut të kredisë para ndodhjes së mospagesës dhe përfshin informacionin e duhur të parashikuar në vlerësimin e rrezikut të kredisë, qoftë në nivelin e një instrumenti individual ose në nivel portofoli. Referojuni Shënimin 6.

**Vlerësimi i modelit të biznesit.** Modeli i biznesit nxit klasifikimin e aktiveve financiare. Drejtimi i bankës ka zbatuar gjykimin për përcaktimin e nivelit të agregimit dhe portofoleve të instrumenteve financiare gjatë kryerjes së vlerësimit të modelit të biznesit. Gjatë vlerësimit të transaksioneve të shitjeve, Banka merr në konsideratë frekuencën, kohën dhe vlerën e tyre historike, arsye për shitjet dhe pritshmëritë për aktivitetin e shitjeve në të ardhme. Transaksionet e shitjeve që kanë për qëllim minimizimin e humbjeve të mundshme për shkak të përkeqësimit të kredisë konsiderohen konsistente me modelin e biznesit "mbaj për arkëtim". Shitjet e tjera para maturimit, jo në lidhje me aktivitetet e administrimit të rrezikut të kredisë, janë gjithashtu në përputhje me modelin e biznesit "mbaj për arkëtim", me kusht që ato të jenë të rralla ose të parëndësishme në vlerë, si individualisht dhe në mënyrë të agreguar. Banka vlerëson rëndësinë e transaksioneve të shitjes duke krahasuar vlerën e shitjeve me vlerën e portofolit që i nënshtrohet vlerësimit të modelit të biznesit mbi jetëgjatësinë mesatare të portofolit. Përveç kësaj, shitja e aktivitetit financiar që pritet vetëm në skenarin e rasteve të stresit ose në përgjigje të një ngjarjeje të izoluar që është jashtë kontrollit të Bankës, nuk është sistematike dhe nuk mund të parashikohet nga Banka, konsiderohet si e rastësishme në objektivin e modelit të biznesit dhe nuk ndikon në klasifikimin e aktiveve financiare përkatëse.

Modeli i biznesit "mbaj për arkëtim dhe shitje" nënkupton që asetet mbahen për të arkëtuar flukse të mjeteve monetare, por shitja është gjithashtu integrale për arritjen e objektivit të modelit të biznesit, siç janë menaxhimi i nevojave të likuiditetit, arritja e një yiledi të caktuar ose përputhja e kohëzgjatjes të asetet financiare me kohëzgjatjen e detyrimeve që financojnë ato asetet.

Kategoria e mbetur përfshin ato portofole të aktiveve financiare, të cilat menaxhohen me qëllim për realizimin e flukseve monetare kryesisht nëpërmjet shitjes, si p.sh. nëse ekziston një model tregtimi. Arkëtimi i fluksit të mjeteve monetare kontraktuale shpesh është i rastësishëm për këtë model biznesi.

Me kalimin në SNRF 9, Banka ka identifikuar letrat me vlerë të vendosjes (AFS) si një portofol likuiditeti dhe janë klasifikuar në kategorinë e mbajtjes për arkëtim dhe shitje.

**Vlerësimi nëse flukset e mjeteve monetare janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit ("SPPI").** Përcaktimi nëse flukset e

mjeteve monetare të një aktivi financiar janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit është subjekt gjykimi.

Vlera në kohë e elementit mjete monetare mund të modifikohet, për shembull, nëse një normë interesi kontraktual rivendoset në mënyrë periodike, por frekuenca e kësaj rivendosjeje nuk përputhet me afatin e normës bazë të interesit të instrumentit të borxhit, për shembull një kredi paguan tre muaj normën ndërbankare por norma është rivendosur çdo muaj. Efekti i vlerës në kohë të modifikuar të parasë është vlerësuar duke krahasuar flukset monetare të instrumentit përkatës kundrejt instrumentit të borxhit referues me flukset e mjeteve monetare SPPI, në çdo periudhë dhe në mënyrë kumulative përgjatë jetëgjatësisë së instrumentit. Vlerësimi është bërë për të gjitha skenarët e mundshëm të mundshëm, duke përfshirë situatën e arsyeshme të mundshme të stresit financiar që mund të ndodhë në tregjet financiare.

Banka ka identifikuar dhe konsideruar kushtet kontraktuale që ndryshojnë kohën ose shumën e flukseve monetare kontraktuale. Kriteri SPPI është plotësuar nëse një hua mundëson shlyerjen e hershme dhe shuma e parapagimit përfaqëson në thelb interesin kryesor dhe të përlogaritur plus një kompensim të arsyeshëm shtesë për përfundimin e kontratës para afatit. Principali i aktivitetit është vlera e drejtë në momentin e njohjes fillestare minus ripagimet në vijim të principalit, përkatësisht këstet neto të interesit të përcaktuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Si një përjashtim nga ky parim, standardi gjithashtu lejon instrumente me karakteristika parapagimi që plotësojnë kushtet e mëposhtme për të përmbushur SPPI: (i) aktiviteti është iniciuar me një prim ose zbritje, (ii) shuma e parapagimit përfaqëson shumën kontraktuale dhe interesin e përlogaritur dhe një kompensim të arsyeshëm shtesë për përfundimin e kontratës para afatit, dhe (iii) vlera e drejtë e tiparit të parapagimit është jomateriale në momentin e njohjes fillestare.

Kontratat e kredisë të Bankës lejojnë rregullimin e normave të interesit në përgjigje të disa ndryshimeve makroekonomike ose ndryshimeve rregullatore. Drejtimi i Bankës ka zbatuar gjykimin dhe vlerësoi se konkurrenca në sektorin bankar dhe aftësia praktike e huamarrësve për të rifinancuar kreditë do ta pengonin që të rivendoste normat e interesit në një nivel mbi nivelin e tregut dhe rrjedhimisht flukset monetare u vlerësuan si SPPI.

**Modifikimi i aktiveve financiare.** Nëse aktiviteti financiar janë modifikuar në mënyrë kontraktuale (p.sh., rinegociuar), Banka vlerëson nëse modifikimi është i konsiderueshëm dhe duhet të rezultojë në mosnjohjen e aktivitetit fillestar dhe njohjen e një aktivi të ri me vlerë të drejtë. Ky vlerësim bazohet kryesisht në faktorët cilësorë, të përshkruara në politikën përkatëse të kontabilitetit dhe kërkon gjykime të rëndësishme. Në veçanti, Banka zbaton gjykime për të vendosur nëse kreditë e rinegociuara të zhvlerësuar duhet të mos-njihen dhe nëse kreditë e reja të njohura duhet të konsiderohen si kredi të zhvlerësuar në momentin e njohjes fillestare. Vlerësimi i mosnjohjes varet nga fakti nëse rreziqet dhe përfitimet, domethënë ndryshueshmëria e flukseve monetare të pritshme (në vend të atyre kontraktuale), ndryshojnë si pasojë e këtyre ndryshimeve. Drejtimi i Bankës vendosi që rreziqet dhe përfitimet nuk ndryshojnë si rezultat i modifikimit të këtyre kredive dhe prandaj në thelb për të gjitha modifikimet, kreditë nuk ishin subjekt mosnjohjeje dhe as nuk u riklasifikuan nga pozicioni i nivelit të zhvlerësuar.

**Kolateral i rimarrë në zotërim.** Për të përcaktuar vlerën neto të realizueshme për kolateralin e rimarrë në zotërim që përfshihet në inventarët brenda aktiveve të tjera, Banka përcakton matjen e vlerës së drejtë bazuar në raportet e vlerësuesve të jashtëm të pavarur të pronës, me kualifikime profesionale të njohura profesionale. Drejtimi i bankës ka rishikuar supozimet e vlerësuesve që bazohen në modelet e skontuara të flukseve të mjeteve monetare që përdoren për qëllime vlerësimi dhe konfirmon faktorët si pronat e ngjashme dhe / ose transaksionet e ngjashme, norma e skontimit të aplikuar janë përcaktuar në mënyrë të përshtatshme në bazë të të dhënave dhe supozimeve që janë përdorur dhe duke vlerësuar kushtet e tregut në fund të periudhës së raportimit. Pavarësisht nga sa më sipër, drejtimi i bankës konsideron se vlerësimi i kolateralit të saj të rimarrë në zotërim aktualisht është subjekt i një shkalle më të lartë gjykimi dhe rritja e gjasave që të ardhurat reale nga një shitjeje mund të ndryshojnë nga vlera kontabël edhe pse rezultatet e fundit kanë treguar variacione të parëndësishme midis të ardhurave reale dhe vlerave kontabël.

**Njohja e të drejtave tatimore të shtyrë mbi fitimin.** Të drejtat tatimore të shtyra nuk janë njohur nga Banka pas një numër vitesh negative në aspektin e humbjeve të tatueshme dhe devijimeve të rezultateve aktuale krahasuar me pritshmëritë e drejtimit. Të drejtat tatimore të shtyra njihen dhe regjistrohen vetëm në masën që realizimi i përfitimit tatimor përkatës është i mundshëm. Për shkak të paqartësive të regjistruara në vitet e fundit, drejtimi i bankës nuk ka njohur të drejtat tatimore të shtyra deri në një situatë më të qëndrueshme me të ardhurat e tatueshme.

#### 4. Miratimi i standardeve të reja ose të rishikuara dhe interpretimet

Standardet e mëposhtme të ndryshuara hynë në fuqi për Bankën që nga 1 janari 2018:

**Miratimi i SNRF 9 "Instrumentet Financiare" (i ndryshuar në korrik 2014 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 Janar 2018).**

Banka miratoi dhe adoptoi SNRF 9, Instrumentet Financiare, nga 1 janari 2018. Banka zgjodhi që të mos riparaqiste shifrat krahasuese dhe njihte çdo ndryshim në vlerën kontabël të aktiveve dhe pasiveve financiare në fitimet e pashpërndara nga data e zbatimit fillestar të standardit, 1 janar 2018. Rrjedhimisht, kërkesat e rishikuara të SNRF 7, Instrumentet Financiare: Shënimet shoqëruese janë zbatuar vetëm për periudhën aktuale. Shënimet shoqëruese për periudhën krahasuese përsërit shpjegimet dhe shënimet e paraqitura në vitin e kaluar.

Politikat e reja të rëndësishme kontabël të zbatuara në periudhën aktuale përshkruhen në Shënimin 2. Politikat kontabël që janë zbatuar para datës 1 janar 2018 dhe të zbatueshme për informacionin krahasues paraqiten në Shënimin 32.

Tabela në vijim rakordon vlerat kontabël të secilës klasë të aktiveve financiare siç është matur më parë në përputhje me SNK 39 dhe shumat e reja të përcaktuara pas adoptimit të SNRF 9 më 1 janar 2018.

Kosto e amortizuar	SNK 39 vlera kontabël 31 dhjetor 2017	Riklasifikimet	Rimatja ECL	SNRF 9 vlera kontabël 1 janar 2018
<b>Mjete monetare, gjendje me bankat qendrore, dhe depozita të tjera pa afat me bankat</b>	3,270,840		(6,641)	3,264,199
<b>Hua dhe paradhënie bankave</b>	119,326		(451)	118,875
<b>Hua dhe paradhënie klientëve</b>	22,779,031		(715,606)	22,063,425
<b>Mjete të tjera</b>	1,395,321		(7,829)	1,387,492
<b>Angazhime dhe garanci</b>	(5,299)		(17,937)	(23,236)
<b>Letra me vlerë të vendosjes</b>	1,831,138		(4,913)	1,826,226
<b>Totali</b>	<b>29,390,357</b>		<b>(753,376)</b>	<b>28,636,981</b>

#### 4. Miratimi i standardeve të reja ose të rishikuara dhe interpretimet (vazhdim)

##### (a) Mjete monetare dhe të ngjashme dhe llogari me Bankën Qendrore

Të gjitha kategoritë e mjeteve monetare dhe të ngjashme dhe llogaritë me Bankën Qendrore siç paraqitet në Shënimin 11 janë riklasifikuar nga kategoria e matjeve të kredive dhe arkëtimeve ("L&R") sipas SNK 39 në kategorinë e matjes me kosto të amortizuar sipas SNRF 9 në datën e adoptimit të standardit. Humbjet e pritshme të kredisë për gjendjen e mjeteve monetare dhe të ngjashme nuk ishin të rëndësishme.

##### (b) Detyrime nga banka të tjera

Të gjitha klasat e detyrimeve nga gjendjet e bankave të tjera janë riklasifikuar nga kategoria e matjes L&R sipas SNK 39 në kategorinë e matjes me kosto të amortizuar sipas SNRF 9.

##### (c) Investime në letra me vlerë të borxhit

Instrumentet e mëposhtme të borxhit janë riklasifikuar në kategori të reja sipas SNRF 9, sepse kategoritë e tyre të mëparshme sipas SNK 39 nuk aplikohen, pa ndryshime në bazën e tyre të matjes: ato të klasifikuara më parë si letra me vlerë të vendosjes AFS tani klasifikohen të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet pasqyrës së të ardhurave të tjera përmbledhëse - FVOCI.

##### (d) Hua dhe paradhënie klientëve

Të gjitha huatë dhe paradhënie klientëve maten me kosto të amortizuar sipas SNRF9. Nuk kishte ndryshime në matje.

Prandaj, Banka nuk ka mundësi të rishikojë normën efektive të interesit për jetëgjatësinë e mbetur të kredisë në mënyrë që të shmangë një ndikim në pasqyrën e fitim humbjeve pas modifikimit të kredisë. Ndikimi i këtij sqarimi në vlerën kontabël të detyrimeve financiare të Bankës të cilat kontabilizohen me kosto të amortizuar nuk ishte material.

SNRF 15 "Të ardhura nga Kontratat me Klientët" (nxjerrë në 28 maj 2014 dhe efektive për periudhat që fillojnë më ose pas datës 1 janar

2018) dhe Ndryshimet në SNRF 15 "Të ardhurat nga Kontratat me Klientët" (nxjerrë më 12 prill 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2018). Standardi ka paraqitur parimin kryesor që të ardhurat duhet të njihen në momentin kur mallrat ose shërbimet i transferohen klientit, me çmimin e transaksionit.

Çdo mall ose shërbim në grup që është i dallueshëm duhet të njihet veçmas, dhe çdo zbritje ose ulje në çmimin e kontratës në përgjithësi duhet të ndahet për elementët e veçantë. Nëse shuma ndryshon për çfarëdo arsye, shuma minimale duhet të njihet nëse ato nuk janë në rrezik të madh për rimarrje.

Kostot që kryhen për të siguruar kontrata me klientët duhet të kapitalizohen dhe amortizohen gjatë periudhës kur merren përfitimet nga kontrata. Standardi nuk pati ndikim material në Bankë.

Standardet e ndryshuara në vijim kanë hyrë në fuqi për Bankën që nga 1 janari 2018, por nuk kanë pasur ndonjë ndikim material në Bankë:

- Ndryshimet në SNRF 2 "Pagesa me aksione" (nxjerrë më 20 qershor 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2018).
- Ndryshimet në SNRF 4 - "Zbatimi i SNRF 9 Instrumentet Financiare me SNRF 4 Kontratat e Sigurimeve" (nxjerrë më 12 shtator 2016 dhe efektive, pavarësisht nga qasja, për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2018 për subjektet që zgjedhin të aplikojnë opsionin e përjashtimit të përkohshëm, ose kur subjekti së pari aplikon SNRF 9 për subjektet që zgjedhin të zbatojnë metodën e mbivendosjes).
- Përmirësimet vjetore të ciklit të SNRF 2014-2016 - Ndryshimet në SNRF 1 të SNK 28 (publikuar në 8 dhjetor 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2018).
- IFRIC 22 "Transaksionet në monedhë të huaj dhe pagesat paraprake" (nxjerrë më 8 dhjetor 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2018).



- Ndryshimet në SNK 40 - "Transferimet e aktiveve të investuara" (publikuar në 8 dhjetor 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2018).

## 5. Deklarime të reja kontabël

Janë nxjerrë disa standarde dhe interpretime të reja që janë të detyrueshme për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2019 ose më vonë, dhe të cilat Banka nuk i zbatuar më herët.

**Ndryshimet në SNRF 9 - "Karakteristikat e parapagimit me kompensim negativ" (lëshuar më 12 tetor 2017 dhe efektive jo më së vonë se për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2019).** Ndryshimet mundësojnë matjen me kosto të amortizuar të kredive të caktuara dhe letrave me vlerë të borxhit që mund të parapagohen në një shumë nën koston e amortizuar, për shembull me vlerën e drejtë ose në një shumë që përfshin një kompensim të arsyeshëm i cili i paguhet huamarrësit dhe të barabartë me vlerën aktuale të një efekti të rritjes së normës së interesit në treg gjatë jetëgjatësisë së mbetur të instrumentit. Përveç kësaj, teksti që është shtuar bazës së standardit për konkluzion rikonfirmon udhëzimet ekzistuese në SNRF 9 se modifikimet ose shkëmbimet e disa detyrimeve financiare të cilat mate me kosto të amortizuar që nuk sjellin mos-njohjen do të rezultojnë në një fitim ose humbje e cila paraqitet në pasqyrën e fitim humbjeve. Prandaj Banka nuk është në gjendje të rishikojë normën efektive të interesit për jetëgjatësinë e mbetur të kredisë me qëllim që të shmangë një ndikim në fitim ose humbje pas modifikimit të kredisë. Banka ende është duke vlerësuar ndikimin e ndryshimit në pasqyrat financiare.

**SNRF 16, Qiratë (publikuar më 13 janar 2016 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2019).** Standardi i ri përcakton parimet për njohjen, matjen, prezantimin dhe zbulimin e qirasë. Të gjitha qiratë financiare rezultojnë që qiramarrësi të ketë të drejtën e përdorimit të një aktivi në fillim të qirasë dhe nëse pagesat e qirasë bëhen me kalimin e kohës, gjithashtu marrin financim. Prandaj, SNRF 16 eliminon klasifikimin e qirasë si qira operative ose qira financiare siç kërkohet në bazë të SNK 17 dhe, në vend të saj, prezanton një model të vetëm të kontabilitetit të qiramarrësit. Qiramarrësit duhet të njohin: (a) aktivet dhe detyrimet për të gjitha qiratë me një afat më të gjatë se 12 muaj, përveç rastit kur aktivi në fjalë ka një vlerë të vogël; dhe (b) zhvlerësimin e aktiveve të qirasë të ndarë më vete nga interesi për detyrimet e qirasë në pasqyrën e të ardhurave.

SNRF 16 në thelb parashikon më tej kërkesat e kontabilizimit për qiradhënësit në SNK 17. Si rrjedhojë, një qiradhënës vazhdon të klasifikojë qiratë e tij si qira operative ose qira financiare dhe të kontabilizojë ndryshe këto dy lloje të qirasë. Banka ka vendosur që do të zbatojë standardin duke përdorur metodën retrospektive të modifikuar, duke mos riparuar pasqyrat financiare. Banka ka kryer një vlerësim fillestar paraprak të ndikimit të standardit të ri në pasqyrat e saj financiare më 1 janar 2019. Vlerësimi përfundimtar i ndikimit mund të ndryshojë pasi procesi nuk ka përfunduar ende.

**KIRFN 23 "Pasiguria mbi Trajtimin e Tatimit mbi Fitimin" (publikuar në 7 qershor 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2019).** SNK 12 specifikon mënyrën e kontabilizimit të tatimit aktual dhe të drejtave tatimore të shtyra, por jo si të reflektojë dhe pasqyrojë efektet e pasigurisë. Interpretimi sqaron mënyrën e zbatimit të kërkesave njohjes dhe të matjes në SNK 12 nëse ka pasiguri në lidhje me trajtimin e tatimit mbi fitim. Një subjekt duhet të përcaktojë nëse duhet të shqyrtojë çdo trajtim tatimor të pasigurt të ndarë më vete ose së bashku me një ose më shumë trajtime të tjera të pasigurta tatimore bazuar në metodën më të mirë që parashikon zgjidhjen e pasigurisë. Subjekti duhet të supozojë se autoriteti tatimor do të shqyrtojë shumat që ka të drejtë të ekzaminojë dhe të ketë njohuri të plotë për të gjitha informacionet e lidhura me to gjatë kryerjes së këtyre ekzaminimeve. Nëse subjekti arrin në përfundimin se nuk është e mundur që autoriteti tatimor të pranojë një trajtim tatimor të pasigurt, efekti i pasigurisë do të pasqyrohet në përcaktimin e

fitimit ose humbjes së tatueshme, bazave tatimore, humbjeve tatimore të papërdorura, kredive të papërdorura tatimore ose normave tatimore, duke përdorur ose shumë më të mundshme ose vlerën e pritur, në varësi të metodës që subjekti pret të parashikojë më mirë zgjidhjen e pasigurisë. Subjekti do të pasqyrojë efektin e një ndryshimi në fakte dhe rrethana ose në informacione të reja që ndikojnë në gjykimet ose vlerësimet e parashikuara nga interpretimi si një ndryshim në çmuarjet kontabël. Shembujt e ndryshimeve në fakte dhe rrethana ose informacione të reja që mund të rezultojnë në rivlerësimin e një gjykimi apo vlerësimi përfshijnë, por nuk kufizohen në, ekzaminimet ose veprimet e një autoriteti tatimor, ndryshimet në rregullat e vendosura nga një autoritet tatimor ose përfundimi i një të drejte të autoritetit tatimor për të shqyrtuar ose kontrolluar trajtimin tatimor dhe fiskal. Mungesa e një marrëveshjeje ose mosdakordësia me autoritetin tatimor në lidhje me një trajtim tatimor dhe fiskal, në mënyrë të izoluar, nuk ka të ngjarë të ndryshojë fakte dhe rrethana apo të sjellë informacione të reja që ndikojnë në gjykimet dhe çmuarjet e parashikuara në bazë të interpretimit. Standardi i ri nuk parashikohet të ketë një ndikim material në pasqyrat financiare të Bankës. Banka po vlerëson ndikimin e interpretimit të ri në pasqyrat financiare të saj.

**Përmirësimet vjetore të SNRF 2015-2017 - ndryshimet në SNRF 3, SNRF 11, SNK 12 dhe SNK 23 (publikuar më 12 Dhjetor 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2019).** Objektivi i ngushtë i amendimeve ndikojnë dhe prekin katër standarde. SNRF 3 u sqarua se një blerës duhet të rimat interesin e tij që i është mbajtur më parë në një operacion të përbashkët kur të marrë kontrollin e biznesit. Në anën tjetër, SNRF 11 tani shpjegon në mënyrë eksplicite dhe të qartë se investitori nuk duhet të rimat vlerën e interesit të mbajtur më parë kur merr kontrollin e përbashkët të një operacioni të përbashkët, në mënyrë të ngjashme me kërkesat ekzistuese kur një ortakëri bëhet një sipërmarrje e përbashkët dhe anasjelltas. SNK 12 i ndryshuar shpjegon se një subjekt njeh të gjitha pasojat e tatimit mbi të ardhurat e dividendëve në rastet kur ka njohur transaksionet ose ngjarjet që gjenerojnë fitimet e shpërndara, p.sh. në pasqyrën e fitim humbjeve ose në pasqyrën e të ardhurave të tjera përmbledhëse. Tani është e qartë se kjo kërkesë zbatohet në të gjitha rrethanat për sa kohë pagesat për instrumentet financiare që klasifikohen si kapital janë shpërndarjet e fitimeve dhe jo vetëm në rastet kur pasojat tatimore janë rezultat i normave të ndryshme tatimore për fitimet e shpërndara dhe të pashpërndara. SNK 23 i rishikuar tani përfshin udhëzime të qarta se huatë e marra në mënyrë specifike për financimin e një aktivi të caktuar përjashtohen nga grupi i kostove për huatë e përgjithshme të cilat janë të pranueshme për kapitalizim vetëm derisa aktivi specifik të jetë në thelb i plotë. Banka po vlerëson aktualisht ndikimin e përmirësimeve në pasqyrat e saj financiare.

Deklarimet e mëposhtme / të reja nuk priten të kenë ndonjë ndikim material në Bankë në momentin e adoptimit të tyre:

**SNRF 17 "Kontratat e Sigurimeve" (publikuar në 18 maj 2017 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2021).** SNRF 17 zëvendëson SNRF 4, i cili i parashikon për kompanitë lëshime që të kryejnë kontabilizimin e kontratave të sigurimit duke përdorur praktikat ekzistuese. Rrjedhimisht, ishte e vështirë për investitorët të krahasojnë dhe dallojnë ndryshimin e performancës financiare të kompanive të ngjashme të sigurimit. SNRF 17 është një standard i bazuar në një parim të vetëm për kontabilizimin e të gjitha llojeve të kontratave të sigurimit, duke përfshirë kontratat e risigurimit të siguresit. Standardi parashikon njohjen dhe matjen e grupeve të kontratave të sigurimit me: (i) një vlerë aktuale të rregulluar sipas rrezikut të flukseve të mjeteve monetare të ardhshme (realizimi i flukseve monetare) që përfshijnë të gjithë informacionin në dispozicion për realizimin e flukseve të mjeteve në një mënyrë që është në përputhje me informacionin e vëzhgueshëm të tregut; plus (nëse kjo vlerë është një detyrim) ose minus (nëse kjo vlerë është një aktiv) (ii) një shumë që përfaqëson fitimin e munguar në grupin e kontratave (marzhi i shërbimit kontraktual).

Siguruesit do të njohin fitimin nga një grup i kontratave të sigurimit gjatë periudhës që ata ofrojnë mbulim sigurimi dhe pasi ato lirohen nga rreziku. Nëse një grup i kontratave është ose bëhet faktor për generim humbjeje, subjekti do ta njohë menjëherë humbjen.

*Ndryshimet në SNK 28 "Interesat afatgjata në ortakëri dhe sipërmarrje të përbashkëta" (publikuar në 12 tetor 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2019).* Ndryshimet sqarojnë që subjektet raportuese duhet të zbatojnë SNRF 9 për huatë afatgjata, aksione preferenciale dhe instrumente të ngjashme që janë pjesë e një investimi neto në një metodë investimi të kapitalit përpara se ato të zvogëlojnë vlerën kontabël me një pjesë humbjeje të investimit që tejkalon shumën e interesit të investitorit në aksione të zakonshme.

*Ndryshimet në SNK 19 "Ndryshimi i Planit, Reduktimi ose Zgjidhja" (publikuar në 7 shkurt 2018 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2019).* Ndryshimet specifikojnë mënyrën se si duhet të përcaktohen shpenzimet e pensioneve kur ndodhin ndryshimet në planin e përfitimeve të përcaktuara të pensionit. Kur ndodh një ndryshim në plan – amendim, reduktim ose zgjidhje - SNK 19 parashikon që të rimat detyrimin ose aktivin neto të përfitimit të përcaktuara. Ndryshimet parashikojnë përdorimin e supozimeve të përditësuara nga kjo rimatje për të përcaktuar koston aktuale të shërbimit dhe interesin neto për pjesën e mbetur të periudhës së raportimit pas ndryshimit të planit. Para ndryshimeve, SNK 19 nuk ka specifikuar mënyrën e përcaktimit të këtyre shpenzimeve për periudhën pas ndryshimit të planit. Duke parashikuar përdorimin e supozimeve të përditësuara, ndryshimet priten të japin informacion të dobishëm për përdoruesit e pasqyrave financiare.

*Ndryshimet në Kuadrin Konceptual për Raportimin Financiar (publikuar në 29 Mars 2018 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 Janar 2020).* Kuadri konceptual i rishikuar përfshin një kapitull të ri mbi matjen; udhëzime për raportimin e performancës dhe ecurisë financiare; përkufizime dhe udhëzime të përmirësuara - në veçanti përkufizimi i një detyrimi; dhe sqarime për fusha të rëndësishme, si rolet e kujdestarisë, kujdesit dhe pasigurisë së matjes në raportimin financiar.

Përveç kur parashikohet ndryshe, standardet dhe interpretimet e reja nuk priten të ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme në pasqyrat financiare të Bankës.

Tabela e mëposhtme paraqet ekspozimin maksimal ndaj rrezikut të kredisë:

	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Mjetet monetare dhe llogari me Bankën Qendrore	4,927,618	5,736,909
Hua dhe paradhënie bankave dhe institucioneve të tjera financiare	19,020	119,326
<i>Hua dhe paradhënie klientëve:</i>		
Tregti – biznesi	9,684,357	9,610,584
Bujqësi – biznesi	732,505	1,719,490
Prodhim – biznesi	6,120,739	5,133,984
Transporti – biznesi	592,676	629,136
Të tjera – biznesi	3,386,591	3,589,533
Strehim – privat	1,701,059	1,908,480
Investime – private	66,875	85,153
Të tjera – private	42,760	102,671
	<b>22,327,562</b>	<b>22,779,031</b>

## 6. Administrimi i riskut financiar

Në aktivitetin normal të biznesit të saj, Banka është e ekspozuar ndaj një numri rreziqesh dhe këto aktivitete përfshijnë analizën, vlerësimin, pranimin dhe menaxhimin e disa niveleve të riskut ose kombinimin e rreziqeve. Ndërmarrja e riskut është thelbësore për aktivitetin e biznesit financiar dhe rreziqet operacionale janë një pasojë e paevitueshme e zhvillimit të biznesit. Qëllimi i bankës është të arrijë një ekuilibër dhe balancë të përshtatshme midis riskut dhe përfitueshmërisë si dhe të minimizojë efektet e mundshme të pafavorshme në ecurinë financiare të bankës.

Politikat e bankës për administrimin e riskut janë hartuar në funksion të identifikimit dhe analizës së këtyre rreziqeve, përcaktimit të limiteve dhe kontrolleve të përshtatshme të riskut, për të monitoruar rreziqet dhe respektimin e limiteve nëpërmjet sistemeve informatike të besueshme dhe të përditësuara. Banka rishikon në mënyrë sistematike politikat dhe sistemet për administrimin e riskut për të pasqyruar ndryshimet në tregje, produkte dhe zhvillimin e praktikës më të mirë.

### (a) Risku i kredisë

Banka ekspozohet ndaj riskut të kredisë, i cili është risku që si pasojë e mospërbushjes së detyrimeve të kundërpalës bën që Banka të pësojë humbje financiare. Risku i kredisë është risku më i rëndësishëm për aktivitetin e biznesit të bankës, për rrjedhojë drejtimi i bankës administron me kujdes ekspozimin ndaj riskut të kredisë. Ekspozimet e kredisë linden kryesisht në aktivitetin e kredi-dhënies të cilat përfshijnë hua dhe paradhënie, dhe aktivitete investimi të cilat sjellin depozita dhe letra me vlerë të borxhit në portofolin e aktiveve të bankës.

Risku i kredisë ekziston gjithashtu në instrumentet financiare jashtë bilancit si letër kredi, garanci dhe angazhime kredie. Administrimi dhe kontrolli i riskut të kredisë për hua dhe paradhënie janë përqendruar në Departamentin e Administrimit të Riskut, ndërsa risku ndërbankar për depozitat dhe letrat me vlerë të borxhit janë përqendruar në Departamentin e Thesarit dhe Departamentin e Administrimit të Riskut.

Të gjitha departamentet që janë përgjegjëse për administrimin dhe kontrollin e riskut të kredisë, raportojnë rregullisht në Këshillin Administrativ dhe në Këshillin Drejtues.

## 6. Administrimi i riskut financiar (vazhdim)

	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Instrumente financiare letra me vlerë të vendosjes	-	1,831,349
Letra me vlerë të drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse	1,632,790	-
Aktive të tjera financiare	155,776	172,818
<i>Ekspozimet e riskut të kredisë për aktivet jashtë bilancit paraqiten si më poshtë vijon:</i>		
Angazhimet e huas dhe detyrime të tjera të lidhura të kredisë	1,387,411	2,426,117
Garanci financiare	1,028,128	910,067
<b>Totali</b>	<b>32,287,596</b>	<b>33,975,617</b>

<i>Jashtë bilancit</i>	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Angazhime huaje	1,387,411	2,426,117
Garanci financiare	872,557	745,117
Letër kredi	155,571	164,950
Provizione të njohura si detyrime	(29,292)	(5,299)
<b>Total</b>	<b>2,386,248</b>	<b>3,330,885</b>

*Rreziku standard i kredisë nga ekspozimet e kredisë të klientëve*

Diferencimi midis ekspozimeve individuale të rëndësishme dhe të parëndësishme të kredisë të orienton drejt proceseve të dallueshme kreditimi për lloje të ndryshme të ekspozimeve të kredisë - procese që kanë demonstruar në të kaluarën se sigurojnë një menaxhim efektiv të rrezikut të kredisë. Proceset dallohen kryesisht në drejtim të ndarjes së detyrave, të cilat zbatohen plotësisht për ekspozimet individuale të rëndësishme të kredisë. Pika fillestare e analizës është informacioni i mbledhur nga klienti, duke filluar nga pasqyrat financiare të audituara deri tek vetëdeklarimet. Kriteret kryesore për vendimet e ekspozimit ndaj kredisë bazohen në gjendjen financiare të klientit; në veçanti për ekspozimet individuale të parëndësishme të kredisë, të plotësuara me një rishikim të fondeve likuide dhe vlerësimin e besueshmërisë së klientit. Së fundi, kërkesat e kolateralit janë përgjithësisht më të larta për ekspozimet individuale të kredive. Si rregull i përgjithshëm, sa më ulët të jetë ekspozimi i kredisë, aq më mbështetës është dokumentacioni i ofruar nga klienti, aq më i shkurtër është afati i ekspozimit të kredisë, sa më i gjatë historiku i klientit me bankën dhe sa më i lartë të jetë qarkullimi i klientit me Grupin, më të ulëta do të jenë kërkesat e kolateralit.

Procesi i vendimmarrjes siguron që të gjitha vendimet e kredisë për ekspozimet individualisht të rëndësishme merren nga komiteti i kredisë. Si parim i përgjithshëm, ne e konsiderojmë atë shumë të rëndësishme për të siguruar që biznesi ynë i huadhënies realizohet në bazë të udhëzimeve organizative që parashikojnë rregulla të përshtatshme që rregullojnë strukturat organizative dhe procedurat operative; përshkrimet e punës që përcaktojnë detyrat përkatëse; një ndarje të qartë të autoritetit vendimmarrës; dhe një përcaktim të qartë të përgjegjësisë.

Ekspozimet e kredive në vonesë përkufizohen si ekspozime kredie për të cilat pagesat e interesit kontraktual dhe / ose pagesat e principalit janë me vonesë. Cilësia relativisht e lartë e portofolit të kredisë pasqyron zbatimin e parimeve të mësipërme të kredidhënies, rezultatet e ndjekjes së treguesve të paralajmërimit të hershëm dhe monitorimit të duhur, në veçanti të ekspozimeve individuale të kredisë. Ky është një element thelbësor i strategjisë sonë për menaxhimin e borxheve në mjedisin aktual të vështirë ekonomik që po prek klientët tanë.

Banka ndjek me rigorozitet mos-pagimet e ekspozimeve tona të kredisë, e cila zakonisht lejon identifikimin e shpejtë të çdo potenciali në rritje për mos-pagimin e ekspozimit të kredisë. Banka aplikon dhe zbaton rregulla strikte në lidhje me ekspozimet e kredive për të cilat, sipas mendimit tonë, nuk ka asnjë perspektivë reale që ekspozimi ndaj kredisë të shlyhet dhe ku zakonisht realizimi i kolateralit është përfunduar ose rezultati i procesit të realizimit është i pasigurt. Përpjekjet e bankës për rikuperimin dhe arkëtimin ndiqen nga punonjës të specializuar, zakonisht me eksperiencë në kredidhënie ose me njohuri në fushën ligjore. Efektiviteti i këtij administrimi të rreptë të rrezikut

të kredisë është pasqyruar në normën krahasimisht të ulët të vonesave që pasqyron portofoli ynë i kredisë.

Cilësia e portofolit të kredisë monitorohet në mënyrë të vazhdueshme. Banka përdor tregues të brendshëm të paralajmërimit të hershëm për të identifikuar çdo rritje potenciale të rrezikut të kredisë. Një rritje e ndjeshme e rrezikut të kredisë evidentohet zakonisht gjatë analizës / monitorimit financiar të klientit ose gjatë evidentimit të ndonjë ngjarje të posaçme që tregon rritje të rrezikut. Të dyja mundësojnë një përditësim të Klasifikimit të Rrezikut të klientit. Nga ana tjetër, informacionet dhe të dhënat për vonesa në likuidim merren në konsideratë duke qenë se fazat përfshijnë të gjitha ekspozimet që tejkalojnë 30 ditë vonesë.

Kjo qasje nënkupton analizën gjithëpërfshirëse të burimeve të ndryshme të informacionit përfshirë analizën gjithëpërfshirëse të qëndrimit financiar të huamarrësve, informacionin për vonesa në pagesa, të dhënat mbi ngjarjet e ristrukturimit dhe perspektivat e ardhshme makroekonomike.

Rreziku i kredisë rritet në mënyrë të konsiderueshme nëse evidentohet të paktën një nga ngjarjet e mëposhtme:

- Klienti është në vonesë për më shumë se 30 ditë (duke përfshirë PAR 30 gjatë muajit) por më pak se 90 ditë;
- Përkeqësim i konsiderueshëm i situatës financiare të klientit që ka sjellë përkeqësimin e klasifikimit të rrezikut në 6 ose 7;
- Ngjarje të ristrukturimit standard ose në ndjekje;
- Shumë ristrukturime.

Në bazë të këtyre treguesve, ekspozimet klasifikohen në faza.

**Matja e humbjes së pritshme të kredisë (ECL).** Humbja e pritshme e kredisë - ECL është një vlerësim i ponderuar me probabilitetin e vlerës aktuale të humbjeve monetare në të ardhme (pra Mesatarja e ponderuar e humbjeve të kredisë, me rreziqe përkatëse të mospagimit që ndodhin gjatë një periudhë kohe të caktuar të cilat përdoren si pesha). Matja e humbjeve të pritshme të kredisë ECL është e paanshme dhe përcaktohet duke vlerësuar një gamë rezultatesh të mundshme. Matja e humbjeve të pritshme të kredisë ECL bazohet në katër komponentë që përdorur Grupi: Probabiliteti i Mospagesës ("PD"), Ekspozimi i papaguar ("EAD"), Humbja e Parashikuar ("LGD") dhe Norma e Zbritjes.

Modeli parashikon njohjen e humbjeve të pritshme të kredisë në kohën e duhur për të siguruar që shuma e humbjeve të pritshme të kredisë të njohura në çdo datë raportimi pasqyron ndryshimet në rrezikun e kredisë të instrumenteve financiarë. Si i tillë, modeli është parashikues dhe zëvendëson modelin e humbjeve që kanë ndodhur për njohjen e humbjeve të kredive, duke njohur humbjet e kredisë që nuk janë shkaktuar domosdoshmërisht nga një ngjarje e mundshme humbjeje. Në mënyrë të veçantë, modeli trajton kërkesat e SNRF 9 për matjen e humbjeve të pritshme të



kredisë bazuar në informacione të arsyeshme dhe mbështetëse që janë në dispozicion pa kosto ose përpjekje të panevojshme, duke përfshirë informacionin historik, aktual dhe informacionin e parashikuar.

Ekspozimi i papaguar EAD është një vlerësim i ekspozimit në një datë të ardhshme kur ndodh mospagesa, duke marrë në konsideratë ndryshimet e pritshme në ekspozimin pas periudhës së raportimit, duke përfshirë pagesat e principalit dhe interesit dhe tërheqjet e parashikuara nga kreditë e miratuara. Ekspozimi i papaguar - EAD për angazhimet e kredisë vlerësohet duke përdorur Faktorin e konvertimit të kredisë ("CCF"). CCF është një koeficient që tregon probabilitetin e konvertimit të shumave subjekt të angazhimit për një ekspozim në një ekspozim në bilanc brenda një periudhe të përcaktuar. Drejtimi i kompanisë vlerëson se CCF-të 12-mujore dhe jetëgjatësia janë materialisht të njëjta. Probabiliteti i mospagesës - PD është një vlerësim i mundësisë që mospagesa të ndodhë gjatë një periudhe kohe të caktuar. Humbja e parashikuar - LGD është një vlerësim i humbjes që rezulton nga mospagesa. Ajo bazohet në diferencën ndërmjet flukseve të mjeteve monetare kontraktuale që duhet të paguhen dhe atyre që kreditori do të priste të arkëtoonte, duke përfshirë edhe nga çdo kolateral. Zakonisht shprehet si përqindje e ekspozimit të papaguar - EAD. Humbjet e pritshme zbriten në vlerën aktuale në fund të periudhës së raportimit. Norma e zbritjes paraqet normën efektive të interesit ("NEI") për instrumentin financiar ose një vlerë të përafërt me të.

Humbjet e pritshme të kredisë ECL janë modeluar gjatë periudhës së jetëgjatësisë së instrumentit. Periudha e jetëgjatësisë është e barabartë me periudhën e mbetur kontraktuale deri në maturim të instrumenteve të borxhit, të cilat janë rregulluar për parapagimet e pritshme, nëse ka. Për angazhimet e huasë dhe kontratat e garancisë financiare, është periudha kontraktuale në bazë të të cilës subjekti ka një detyrim kontraktual aktual për të dhënë kredi.

Modelet e menaxhimit dhe administrimit të humbjeve të kredisë - ECL gjatë gjithë jetëgjatësisë, pra humbjet që rezultojnë nga të gjitha ngjarjet e mundshme të mospagesës gjatë periudhës së mbetur të instrumentit financiar. Humbje e pritshme e kredisë 12-muj - ECL përfaqëson një pjesë të humbjeve të pritshme të kredisë - ECL gjatë jetëgjatësisë që rezultojnë nga ngjarjet e mospagesës të një instrumenti financiar që janë të mundshme brenda periudhës 12 mujore pas periudhës së raportimit ose periudhës së mbetur të jetëgjatësisë së instrumentit financiar nëse është më pak se një vit.

Humbjet e pritshme të kredisë - ECL që vlerësohen nga drejtimi i bankës për qëllimet e këtyre pasqyrave financiare janë vlerësime dhe çmuarje për një pikë-në-kohë, dhe jo vlerësime apo çmuarje përmes ciklit që zakonisht përdoren për qëllime rregullatore. Vlerësimet dhe çmuarjet konsiderojnë informacionin e parashikuar për të ardhmen, pra humbja e pritshme e kredisë reflekton zhvillimin e ponderuar të probabilitetit të variablave kryesorë makroekonomikë që kanë një ndikim në rrezikun e kredisë.

Vlerësimi nëse ka pasur ose jo një rritje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë ("SICR") nga momenti i njohjes fillestare kryhet në baza individuale. Kriteret që përdorura për të identifikuar rritjen e rrezikut SICR monitorohen dhe rishikohen në mënyrë periodike për përshtatshmërinë nga Departamenti i Riskut të Kredisë të Grupit. Supozimi, duke qenë se ka pasur rritje të ndjeshme të rrezikut të kredisë që nga momenti i njohjes fillestare kur aktivet financiare janë me vonesë për më shumë se 30 ditë, nuk është hedhur poshtë.

Banka e gjykon dhe vlerëson se rreziku i një instrumenti financiar është rritur -SICR në rast se plotësohet një ose më shumë nga kriteret e mëposhtme sasiore, cilësore ose ndaluese.

Rreziku i kredisë rritet në mënyrë të konsiderueshme nëse evidentohet të paktën një nga ngjarjet e mëposhtme:

- Klienti është në vonesë për më shumë se 30 ditë (duke përfshirë PAR 30 gjatë muajit) por më pak se 90 ditë;
- Përkeqësimi i konsiderueshëm i situatës financiare të klientit që ka sjellë përkeqësimin e klasifikimit të rrezikut në 6 ose 7;
- Ngjarje të ristrukturimit standard ose në ndjekje;
- Shumë ristrukturime.

Pas identifikimit të rritjes së rrezikut të kredisë, mund të përcaktohet humbja e pritshme e kredisë.

**Sistemi i Klasifikimit të Rrezikut** Sistemi i klasifikimit të rrezikut bazohet në eksperiencën shumë vjeçare në punën me klientët e vegjël dhe të mesëm dhe në njohuritë e gjera për arsyet e mospagesës. Sistemi i klasifikimit të rrezikut përbëhet nga karakteristikat cilësore dhe sasiore të çdo klienti, të cilat janë të ponderuara sipas rëndësisë dhe ndikimit të tyre në veprimtarinë e biznesit, dhe rrjedhimisht në ecurinë e ekspozimit të kredisë. Si rezultat, llogaritet një pikë përfundimtare për çdo klient që varion nga 1 në 8, ku 6 dhe 7 konsiderohen si ngjarje të rritjes së rrezikut - SICR dhe 8 nënkupton shkallën më të lartë të rrezikut.

Banka përcakton rrezikun e kredisë nga mospagesa nga ekspozimet e kredive të klientëve si rrezik i humbjeve për shkak të mospërbushjes së mundshme të detyrimeve kontraktuale të pagesave që lidhen me ekspozimin e kredisë së klientit. Administrimi i riskut të kredisë nga mospagesa nga ekspozimet e kredive të klientëve bazohet në zbatimin e plotë të parimeve të kreditimit të bankës:

- analiza intensive e kapacitetit të borxhit të klientëve të Bankës
- dokumentim i kujdeshëm i vlerësimeve të rrezikut të kredisë, duke siguruar që analizat e kryera mund të kuptohen nga palë të treta që kanë njohuritë e duhura
- shmangie rigoroze e borxheve të klientëve tanë
- ndërtimi i një marrëdhënie personale dhe afatgjatë me klientin dhe mbajtja e kontaktit të rregullt
- monitorimi i ngushtë i pagesave të kredisë dhe treguesve të paralajmërimit të hershëm
- realizimi i menaxhimit strikt të vonesave
- realizimi strikt i arkëtimit të vlerës së kolateralit në rast mospagimi
- investimi në staf të trajnuar mirë dhe shumë të motivuar
- zbatimi i proceseve të dizajnuara me kujdes dhe të dokumentuara mire
- zbatimi rigorozi i "parimit të kontrollit të dyfishtë".

Banka ka përafëruar plotësisht përkufizimin e mospagimit me përkufizimin e aktiveve të zhvlerësuar. Përkufizimi i mospagesës që parashikohet më sipër zbatohet për të gjitha llojet e aktiveve financiare të Bankës.

Një instrument konsiderohet të mos jetë më në vonesë (pra është rregulluar) nëse nuk plotëson asnjë nga kriteret e paracaktuara për një periudhë të njëpasnjëshme prej të paktën tre muaj. Përveç plotësimi të këtyre kriterëve, banka kryen një monitorim të plotë financiar të ekspozimeve që kanë qenë në vonesë më parë, përpara se të rriklassifikojë ato si të papaguara. Niveli I humbjeve të pritshme të kredisë - ECL që njihet në këto pasqyra financiare varet nëse rreziku i kredisë i huamarrësit është rritur ndjeshëm që nga momenti i njohjes fillestare. Ky është një model me tre nivele për matjen humbjes së pritshme të kredisë - ECL. Një instrument financiar që nuk është zhvlerësuar në momentin e njohjes fillestare dhe rreziku i tij i kredisë nuk është rritur ndjeshëm që nga momenti i njohjes fillestare ka një provizion për humbjen e kredisë në bazë të humbjes së pritshme të kredisë për një periudhë 12 mujore (Niveli 1).

Nëse është identifikuar një rritje e rrezikut - SICR që nga momenti i njohjes fillestare, instrumenti financiar kalon në Nivelin 2, por ende nuk konsiderohet i zhvlerësuar dhe provizioni bazohet në

jetëgjatësinë e humbjes së pritshme të kredisë. Nëse një instrument financiar zhvlerësohet, instrumenti financiar klasifikohet në Nivelin 3 dhe provizioni bazohet në jetëgjatësinë e humbjes së pritshme të kredisë. Pasoja e klasifikimit të një aktivi në Nivelin 3 është që subjekti nuk njihet të ardhurat nga interesi në bazë të vlerës kontabël bruto dhe zbaton normën efektive të interesit të aktivitetit për vlerën kontabël, pa humbjet e pritshme të kredisë - ECL, për llogaritjen e të ardhurave nga interesi.

Nëse ka prova dhe evidencë që kriteret e rritjes së rrezikut - SICR nuk plotësohen më vonë, instrumenti riklasifikohet në nivelin 1. Nëse një ekspozim është transferuar në Nivelin 2 bazuar në një tregues cilësor, banka monitoron nëse ky tregues vazhdon të ekzistojë ose ka ndryshuar. Banka diskuton çdo muaj, nëpërmjet komitetit të treguesve të cilësorisë së aktivitetit, të gjitha rastet që janë identifikuar dhe tregojnë një rritje të rrezikut - SICR dhe në bazë të reagimit të monitorimit dhe ekzistencës së treguesve vendos për klasifikimin e duhur të ekspozimeve.

Humbjet e pritshme të kredisë - ECL për asetet financiare POCL gjithmonë maten në bazë të jetëgjatësisë. Prandaj, Banka njihet vetëm ndryshimet kumulative në humbjet e pritshme të kreditit përgjatë jetëgjatësisë.

Në përgjithësi, humbja e pritshme e kredisë - ECL është shuma e shumëzimit të parametrave të mëposhtëm të rrezikut të kredisë: EAD, PD dhe LGD, të cilat janë përcaktuar sikundër është shpjeguar më sipër dhe janë zbritur me vlerën aktuale duke përdorur normën efektive të interesit të instrumentit. Humbja e pritshme e kredisë - ECL përcaktohet duke parashikuar parametrat e rrezikut të kredisë (EAD, PD dhe LGD) për çdo vit të ardhshëm gjatë periudhës së jetëgjatësisë për çdo ekspozim individual ose segment kolektiv. Këto tre komponent shumëzohen së bashku dhe përshtaten për gjasat e mbijetesës (pra ekspozimi është shlyer ose nuk është bërë në muajin e mëparshëm). Kjo në mënyrë efektive llogarit humbjen e pritshme të kredisë - ECL për secilën periudhë të ardhshme, e cila pastaj zbritet në datën e raportimit dhe mblidhet. Norma e skontimit që përdoret për llogaritjen e humbjes së pritshme të kredisë - ECL është norma fillestare efektive e interesit ose një vlerë e përafërt me të.

**Parimet kryesore të llogaritjes së parametrave të rrezikut të kredisë.** Ekspozimi i papaguar - EAD përcaktohet në bazë të profilit të pritshëm të pagesave, që ndryshon sipas llojit të produktit. Ekspozimi i papaguar -EAD bazohet në ripagimet kontraktuale që duhet të paguaj kredimarrësi gjatë një periudhe 12-mujore ose jetëgjatësisë për amortizimin e produkteve dhe huatë me ripagim të menjëhershëm në një kësht. Kjo gjithashtu do të rregullohet për çdo pagesë të pritshme më të madhe që kryhet nga një kredimarrës. Supozimet e ripagimit para afatit ose të rirfinancimit përfshihen gjithashtu në llogaritje. Për produktet e rinovueshme, ekspozimi i papaguar - EAD parashikohet duke vlerësuar gjendjen aktuale të tërhequr dhe duke i shtuar "faktorin e konvertimit të kredisë" që vlerëson tërheqjen e pritshme të limitit të mbetur deri në kohën e vonesës. Këto supozime ndryshojnë sipas llojit të produktit, përdorimit të limitit aktual dhe karakteristikave të tjera të sjelljes specifike të kredimarrësit.

Dy lloje të probabilitetit të mospagesës - PD përdoren për llogaritjen e humbjes së pritshme të kredisë ECL: Probabiliteti i mospagesës - PD 12-mujore dhe përgjatë jetëgjatësisë. Vlerësimi i probabilitetit të mospagesës - PD 12-mujore bazohet në të dhënat më të fundit të disponueshme historike të vlefshme dhe përshtatet për informacione mbështetëse për të ardhmen nëse është e përshtatshme. Probabiliteti i mospagesës - PD përgjatë jetëgjatësisë paraqet probabilitetin e mospagesës që ndodh gjatë jetëgjatësisë së mbetur të instrumentit financiar dhe është një shumë e: Probabiliteti i mospagesës - PD 12 mujore përgjatë jetëgjatësisë së instrumentit.

Humbja e parashikuar - LGD përfaqëson pritshmërinë e Bankës për shkallën e humbjes nga një ekspozim i papaguar. Humbja e parashikuar - LGD varion nga lloji i kundërpalës, lloji dhe koha e

paraqitjes së kërkesës, si dhe disponueshmëria e kolateralit ose garancia tjetër e kredisë.

LGD llogaritet në mënyrë kolektive bazuar në statistikat më të fundit të rikuperimit që janë të disponueshme për pjesën e mbetur të portofolit të kredisë.

Ashtu si me çdo parashikim ekonomik, projeksionet dhe gjasat e ndodhjes janë subjekt i një shkalle të lartë pasigurie, prandaj rezultatet aktuale mund të jenë dukshëm të ndryshme nga rezultatet e parashikuara. Banka i konsideron këto parashikime që të përfaqësojë vlerësimin e saj më të mirë të rezultateve të mundshme dhe ka analizuar mënyrat jo-lineare dhe asimetritë brenda portofoleve të ndryshme të Bankës për të përcaktuar që skenarët e zgjedhur janë përfaqësuesit e duhur të gamës së skenarëve të mundshëm.

Banka rishikon rregullisht metodologjinë dhe supozimet e saj për të zvogëluar çdo diferencë midis çmuarjeve dhe humbjes aktuale të kredisë. Ky testim mbështetës kryhet të paktën një herë në vit.

Rezultatet e testimit mbështetës të metodologjisë së matjes së humbjes së pritshme të kredisë - ECL i komunikohen Drejtitimit të Bankës dhe hapat e mëtejshëm për modifikimin e modeleve dhe supozimeve përcaktohen pas diskutimeve midis personave të autorizuar.

### Rreziku i tregut

Risku i tregut është risku që ndryshimet në çmimet e tregut, si norma e interesit, çmimet e kapitalit, kurset e këmbimit të monedhave të huaja dhe spread-et e kredisë (jo të lidhura me ndryshime të gjendjes së debitorit/kreditorit) do të ndikojnë fitimet e Bankës ose vlerën e mbajtjes së instrumenteve financiare. Objektivi i menaxhimit të riskut të tregut është të menaxhojë dhe kontrollojë ekspozimet ndaj riskut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, duke maksimizuar kthimin mbi riskun.

### Risku i këmbimit valutor

'Risku i kursit të këmbimit specifikon rrezikun e efekteve negative në rezultatet financiare të një institucioni të shkaktuar nga ndryshimi i normave të kursit të këmbimit, të cilat janë: 1. Rreziku i monedhës i pasqyrës së të ardhurave të Bankës; 2. Rreziku i monedhës së mjaftueshmërisë së kapitalit; 3. Rreziku i investimeve në monedhë të huaj (jo i aplikueshëm për Bankën).

Në parim, Banka nuk angazhohet në tregtimin e pronave dhe nuk hyn në ndonjë pozicion spekulativ në tregjet valutore me qëllim të gjenerimit të të ardhurave shtesë potenciale. Prandaj, është rreptësisht një institucion kredie jo-tregtare. Banka synon të mbyllë pozicionet valutore dhe të sigurojë që pozicioni i hapur i monedhës të mbetet në kufijtë konservator në çdo kohë.

Politika për Administrimin e Rrezikut të Këmbimit Valutor dhe Rregullorja e Bankës Qendrore për Administrimin e Rrezikut të Pozicionit të Hapur Valutor, kufizojnë rrezikun e këmbimit valutor duke përcaktuar kufijtë dhe faktorët e raportimit për pozicionet e hapura valutore në lidhje me kapitalin rregullator. Ndryshimet në kufijtë dhe faktorët e raportimit në politikë mund të bëhen vetëm nga Komiteti i Aktiveve dhe Pasiveve të Grupit dhe Komiteti i Administrimit të Riskut të Grupit.

Meqenëse kapitali i bankës është i shprehur në euro, ndërsa ushtron aktivitetin në një vend ku Euro nuk është monedha në përdorim, ai ka një pozicion të miratuar në valutë të huaj për të kontabilizuar kapitalin. Respektimi i limiteve të aprovuara të OCP-

së rishikohet dhe monitorohet rregullisht nga Departamenti i Administrimit të Riskut. Normat zyrtare të këmbimit valutor për monedhat kryesore që përdoren në konvertimin e zërave të bilancit në valutë të huaj janë si më poshtë (në lekë):

	2018	2017
USD	107.82	111.10
EUR	123.42	132.95
GBP	137.42	149.95
CHF	109.60	113.94
CNY	15.68	-

Tabela e mëposhtme paraqet në mënyrë të përmblëdhur aktivet dhe detyrimet e Bankës në monedhë të huaj më 31 Dhjetor 2018 dhe 2017 të këmbëra në LEK '000.

	LEK	EUR	USD	Të tjera	Totali
<b>31 dhjetor 2018</b>					
<b>Aktive</b>					
Mjete monetare dhe llogari me Bankën Qendrore	1,686,542	3,841,309	420,188	3,869	5,951,907
Hua dhe paradhënie bankave	-	-	19,020	-	19,020
Instrumente financiare letra me vlerë të vendosjes	1,632,594	196	-	-	1,632,790
Hua dhe paradhënie klientëve	9,862,954	11,842,495	622,113	-	22,327,562
Aktive të tjera financiare	(29,792)	144,880	34,484	6,202	155,775
<b>Totali i aktiveve financiare</b>	<b>13,152,298</b>	<b>15,828,879</b>	<b>1,095,804</b>	<b>10,071</b>	<b>30,087,053</b>
<b>Detyrimet</b>					
Detyrime ndaj bankave	39,020	3,782,356	-	-	3,821,376
Detyrime ndaj klientëve	11,421,399	8,137,548	1,107,688	4,578	20,671,213
Fonde të tjera të marra hua	490,065	2,984,049	-	-	3,474,113
Detyrime të tjera financiare	87,732	64,478	1,778	4,740	158,728
Borxhi i varur	-	636,738	-	-	636,738
<b>Totali i detyrimeve financiare</b>	<b>12,038,216</b>	<b>15,605,169</b>	<b>1,109,466</b>	<b>9,318</b>	<b>28,762,168</b>
<b>Pozicioni valutor në bilanc, neto</b>	<b>1,114,082</b>	<b>223,710</b>	<b>(13,662)</b>	<b>753</b>	<b>1,324,885</b>
<b>Angazhimet dhe garancitë jashtë bilancit</b>	<b>1,204,901</b>	<b>1,057,632</b>	<b>153,007</b>	<b>-</b>	<b>2,415,540</b>
<b>Angazhimet e kredisë</b>	<b>751,779</b>	<b>618,167</b>	<b>17,465</b>	<b>-</b>	<b>1,387,411</b>
Jashtë bilancit – letër kreditë	-	84,721	70,850	-	155,571
Jashtë bilancit – garancitë bankare	453,122	354,743	64,692	-	872,557
<b>Totali i angazhimeve të kredisë</b>	<b>1,204,901</b>	<b>1,057,632</b>	<b>153,007</b>	<b>-</b>	<b>2,415,540</b>

31 dhjetor 2017	ALL	EUR	USD	Të tjera	Totali
<b>Aktive</b>					
Mjete monetare dhe llogari me Bankën Qendrore	1,867,024	3,941,796	898,732	3,320	6,710,872
Hua dhe paradhënie bankave	100,011	-	19,315	-	119,326
Instrumente financiare letra me vlerë të vendosjes	1,697,638	133,711	-	-	1,831,349
Hua dhe paradhënie klientëve	10,415,929	11,727,920	635,182	-	22,779,031
Aktive të tjera financiare	86,653	85,443	722	-	172,818
<b>Totali i aktiveve financiare</b>	<b>14,167,255</b>	<b>15,888,870</b>	<b>1,553,951</b>	<b>3,320</b>	<b>31,613,396</b>
<b>Detyrimet</b>					
Detyrime ndaj bankave	538,375	2,341,031	-	-	2,879,406
Detyrime ndaj klientëve	13,697,700	8,729,438	1,616,500	2,608	24,046,245
Fonde të tjera të marra hua	530,070	1,330,416	-	-	1,860,486
Detyrime të tjera financiare	167,491	143,885	35,065	32	346,474
Borxhi i varur	-	685,905	-	-	685,905
<b>Totali i detyrimeve financiare</b>	<b>14,933,636</b>	<b>13,230,675</b>	<b>1,651,565</b>	<b>2,640</b>	<b>29,818,516</b>
<b>Pozicioni valutor në bilanc, neto</b>	<b>(766,381)</b>	<b>2,658,195</b>	<b>(97,614)</b>	<b>680</b>	<b>1,794,880</b>
<b>Angazhimet dhe garancitë jashtë bilancit</b>					
Angazhimet e kredisë	932,069	1,398,142	95,906	-	2,426,117
Jashtë bilancit – letër kreditë	17,254	147,696	-	-	164,950
Jashtë bilancit – garancitë bankare	307,801	368,989	68,327	-	745,117
<b>Totali i angazhimeve të kredisë</b>	<b>1,257,124</b>	<b>1,914,827</b>	<b>164,233</b>	<b>-</b>	<b>3,336,184</b>

Analiza e ndjeshmërisë së bankës merr në konsideratë lëvizjet historike të kursit të këmbimit për një periudhë 8 vjeçare në LEK kundrejt monedhave të huaja, Euro dhe USD. Në vijim të goditjeve të llogaritura historike dhe ndikimit përkatës financiar në bazë të pozicioneve të hapura valutore së Bankës, ndjeshmëria ndaj riskut të kursit të këmbimit matet dhe raportohet tek drejtuesit kryesor. Kjo analizë bazohet në metodat statistikore dhe paraqet vlerësimin e drejtimit të bankës për ndryshimin e arsyeshëm të mundshëm të kursit të këmbimit.

Llogaritja e kapitalit ekonomik të nevojshëm për të mbuluar rrezikun e këmbimit valutor tregon ndikimin që një goditje historike ekstreme e kursit të këmbimit do të kishte në bankë duke pasur parasysh ekspozimin e rrezikut aktual të këmbimit valutor. Llogaritja e ndikimit të tillë në bazë të të dhënave më 31 dhjetor 2018 dhe 31 dhjetor 2017 (sipas skenarit standard) paraqitet si më poshtë

Monedha	Goditjet historike 2018	Goditjet historike 2017	Efekti në fitim ose humbje	
			31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
EUR	-7.23%	-3.45%	(50,146)	(116,513)
USD	-4.66%	-1.93%	735	344
<b>Total</b>			<b>(49,411)</b>	<b>(116,169)</b>

Goditja e kursit të këmbimit përcaktohet si më poshtë vijon:

- Për një periudhë prej shtatë vjetësh, listohen kurset ditore të këmbimit për secilën çift palë të monedhave. Çiftet e monedhave janë monedha funksionale e bankës kundrejt secilës prej monedhave të huaja të OCP të bankës. Ndryshimi vjetor (pra periudha e mbajtjes = një vit) identifikohet si lëvizje, e shprehur në përqindje, të kursit të këmbimit të secilës prej monedhave të huaja.
- Ndikimi i fitimit ose humbjes për çdo OCP të bankës llogaritet për çdo ndryshim të njëkohshëm nga viti në vit (duke shumëzuar për çdo monedhë OCP me çdo ndryshim të kursit të këmbimit çdo vit).
- Janë marrë lëvizjet e njëkohshme të kursit të këmbimit valutor të të gjitha monedhave që çojnë në ndikimin më të madh të humbjeve të agregatit 1 në përqindje.

Kapitali ekonomik i nevojshëm për të mbuluar rrezikun e monedhës merret duke shumëzuar secilin OCP me goditjen e kursit përkatës të kursit të këmbimit dhe këto rezultate janë agreguar, pra ndikimet pozitive dhe negative janë netuar.

#### **Rreziku i normës së interesit**

Rreziku i normës së interesit specifikon rrezikun që lëvizjet në normat e interesit të tregut do të ndikojnë negativisht në vlerën ekonomike të Bankës dhe në të ardhurat e saj nga interesi dhe eventualisht në kapital.

Banka nuk synon të gjenerojë fitime nëpërmjet spekulimeve në tregun e normave të interesit. Përkundrazi, ajo synon të sigurojë që struktura e normës së interesit të jetë e balancuar në mënyrë të mjaftueshme për të gjitha afatet e maturimit duke qëndruar brenda kufijve të përcaktuar në Politikën për Administrimin e Riskut të Interesit dhe në Udhëzimin e Bankës Qendrore për Administrimin e Riskut të Normës së Interesit. Banka e arrin këtë duke përshtatur profilet e ri-çmimit midis aktiveve dhe detyrimeve. Për të monitoruar ndryshimet në normën e interesit, Banka përdor analizën gap të çmimeve dhe identifikon impaktin mbi vlerën ekonomike (perspektiva afatgjatë) dhe ndikimin në të ardhurat (perspektivë afatshkurtër) që rrjedhin nga një goditje një herë (ndryshimi paralel i kurbës së yield-it) mjaft e lartë për të mbuluar skenarë të ndryshëm të luhatjeve të kurbës së yield-eve; kjo bëhet për të gjitha monedhat

përkatëse të rrezikut të normës së interesit. Duke vlerësuar të dy treguesit njëkohësisht, mundësohet përcaktimi i plotë i objektivit të ekspozimit ndaj rrezikut të normës së interesit.

Duke marrë parasysh strukturat e aktiveve dhe detyrimeve të përcaktuara në Euro dhe USD më 31 Dhjetor 2018 dhe 2017 dhe duke supozuar një zhvendosje paralele të normave të interesit në aktivet dhe detyrimet e ndjeshme ndaj normës së interesit, profili i rrezikut të normës së interesit të Bankës paraqitet si më poshtë:

GAP-i i ndjeshmërisë së interesit në LEK Më 31 dhjetor 2018		Deri në 1 muaj	1-6 muaj	6-12 muaj	1-2 vjet	2-5 vjet	Më shumë se 5 vjet	Totali i ndjeshëm ndaj interesit	Jo i ndjeshëm ndaj interesit
<b>Aktive</b>									
Arka		-	-	-	-	-	-	-	522,526
Llogari me bankën qendrore		907,069	-	-	-	-	-	907,069	258,986
Llogari rrjedhëse me bankat		-	-	-	-	-	-	-	-
Bono thesari dhe tituj të treg.	Fiks.	100,000	1,049,660	485,980	-	-	-	1,635,640	(3,046)
	Ndry.	-	-	-	-	-	-	-	-
Depozita me afat të bankave		-	-	-	-	-	-	-	-
Hua dhe paradhëniet klientëve	Fiks.	628,289	2,123,143	1,714,742	1,215,263	1,915,780	1,127,884	8,725,100	
	Ndry.	134,829	925,631	838,836	-	-	-	1,899,296	
Aktive të tjera financiare		-	-	-	-	-	-	-	777,829
<b>Aktive gjithsej</b>		<b>1,770,187</b>	<b>4,098,433</b>	<b>3,039,558</b>	<b>1,215,263</b>	<b>1,915,780</b>	<b>1,127,884</b>	<b>13,167,105</b>	<b>1,556,295</b>
<b>Detyrime</b>									
Llogari rrjedhëse nga banka		-	-	-	-	-	-	-	39,020
Llogari rrjedhëse nga klientët		1,132,993	-	-	-	-	-	1,132,993	3,188,925
Depozita nga klientët		5,118	1,962,119	2,959,694	1,658,449	412,488	31,000	7,028,868	
Hua dhe borxhi i varur	Fiks.	490,000	-	-	-	-	-	490,000	
	Ndry.	-	-	-	-	-	-	-	
Detyrime të tjera financiare		-	-	-	-	-	-	-	1,296,736
<b>Detyrime gjithsej</b>		<b>1,628,111</b>	<b>1,962,119</b>	<b>2,959,694</b>	<b>1,658,449</b>	<b>412,488</b>	<b>31,000</b>	<b>8,651,861</b>	<b>4,524,681</b>
Pozicioni i hapur i gap-it të ndjeshmërisë së NI		142,076	2,136,315	79,864	(443,186)	1,503,292	1,096,884	4,515,245	(2,968,386)

GAP-i i ndjeshmërisë së interesit në EURO Më 31dhjetor 2018	Deri në 1 muaj	1-6 muaj	6-12 muaj	1-2 vjet	2-5 vjet	Më shumë se 5 vjet	Totali i ndjeshëm ndaj interesit	Jo i ndjeshëm ndaj interesit
<b>Aktive</b>								
Arka	-	-	-	-	-	-	-	457,906
Llogari me bankën qendrore	782,589	-	-	-	-	-	782,589	-
Llogari rrjedhëse me bankat	2,577,926	-	-	-	-	-	2,577,926	28,983
Bono thesari dhe tituj të treg.	Fiks. -	-	-	-	-	-	-	-
	Ndry. -	-	-	-	-	-	-	-
Depozita me afat të bankave	-	-	-	-	-	-	-	-
Hua dhe paradhëniesve klientëve	Fiks. 974,141	2,281,290	2,196,574	1,645,955	2,469,475	1,643,171	11,210,606	-
	Ndry. 339,279	602,079	479,638	-	-	-	1,420,996	-
Aktive të tjera financiare	-	-	-	-	-	-	-	(163,208)
<b>Aktive gjithsej</b>	<b>4,673,936</b>	<b>2,883,369</b>	<b>2,676,211</b>	<b>1,645,955</b>	<b>2,469,475</b>	<b>1,643,171</b>	<b>15,992,117</b>	<b>323,681</b>

**Detyrime**

Llogari rrjedhëse nga banka	-	-	-	-	-	-	-	11,788
Llogari rrjedhëse nga klientët	1,868,974	-	-	-	-	-	1,868,974	3,911,824
Depozita nga klientët	401	589,663	1,411,345	119,298	127,074	111,078	2,358,859	-
Hua dhe borxhi i varur	Fiks. 555,390	2,221,560	370,260	-	2,344,980	-	6,726,390	-
	Ndry. 617,100	-	-	1,234,200	-	-	617,100	-
Detyrime të tjera financiare	-	-	-	-	-	-	-	2,355,991
<b>Detyrime gjithsej</b>	<b>3,041,864</b>	<b>2,811,223</b>	<b>1,781,605</b>	<b>1,353,498</b>	<b>2,472,054</b>	<b>111,078</b>	<b>11,571,322</b>	<b>6,279,602</b>
Pozicioni i hapur i gap-it të ndjeshmërisë së NI	1,632,071	72,146	894,607	292,457	(2,579)	1,532,093	4,420,794	(5,955,921)

GAP-i i ndjeshmërisë së interesit në USD Më 31dhjetor 2018	Deri në 1 muaj	1-6 muaj	6-12 muaj	1-2 vjet	2-5 vjet	Më shumë se 5 vjet	Totali i ndjeshëm ndaj interesit	Jo i ndjeshëm ndaj interesit
<b>Aktive</b>								
Arka	-	-	-	-	-	-	-	43,857
Llogari me bankën qendrore	114,962	-	-	-	-	-	114,962	2,618
Llogari rrjedhëse me bankat	258,957	-	-	-	-	-	258,957	19,020
Bono thesari dhe tituj të treg.	Fiks. -	-	-	-	-	-	-	-
	Ndry. -	-	-	-	-	-	-	-
Depozita me afat të bankave	-	-	-	-	-	-	-	-
Hua dhe paradhëniesve klientëve	Fiks. 37,464	460,927	45,155	41,005	46,978	4,369	635,898	-
	Ndry. -	14,902	21,894	-	-	-	36,795	-
Aktive të tjera financiare	-	-	-	-	-	-	-	(11,707)
<b>Aktive gjithsej</b>	<b>411,383</b>	<b>475,829</b>	<b>67,049</b>	<b>41,005</b>	<b>46,978</b>	<b>4,369</b>	<b>1,046,612</b>	<b>53,789</b>

**Detyrime**

Llogari rrjedhëse nga banka	-	-	-	-	-	-	-	-
Llogari rrjedhëse nga klientët	172,041	-	-	-	-	-	172,041	350,413
Depozita nga klientët	98	249,874	289,602	26,489	16,672	-	582,734	-
Hua dhe borxhi i varur	Fiks. -	-	-	-	-	-	-	-
	Ndry. -	-	-	-	-	-	-	-
Detyrime të tjera financiare	-	-	-	-	-	-	-	6,944
<b>Detyrime gjithsej</b>	<b>172,139</b>	<b>249,874</b>	<b>289,602</b>	<b>26,489</b>	<b>16,672</b>	<b>-</b>	<b>754,776</b>	<b>357,357</b>
Pozicioni i hapur i gap-it të ndjeshmërisë së NI	239,244	225,955	(222,553)	14,516	30,305	4,369	291,837	(303,568)

GAP-i i ndjeshmërisë së interesit në LEK Më 31dhjetor 2017	Deri në 1 muaj	1-6 muaj	6-12 muaj	1-2 vjet	2-5 vjet	Më shumë se 5 vjet	Totali i ndjeshëm ndaj interesit	Jo i ndjeshëm ndaj interesit
<b>Aktive</b>								
Arka	-	-	-	-	-	-	-	576,421
Llogari me bankën qendrore	1,251,908	-	-	-	-	-	1,251,908	38,695
Llogari rrjedhëse me bankat	-	-	-	-	-	-	-	-
Bono thesari dhe tituj të treg.	Fiks. 435,720	871,300	400,000	-	-	-	1,707,020	(9,382)
	Ndry. -	-	-	-	-	-	-	-
Depozita me afat të bankave	100,000	-	-	-	-	-	100,000	11
Hua dhe paradhëniet klientëve	Fiks. 1,019,325	2,018,472	1,710,174	876,139	1,280,916	812,917	7,717,942	(526,139)
	Ndry. 173,896	1,497,209	1,785,935	-	-	-	3,457,040	(232,928)
Aktive të tjera financiare	-	-	-	-	-	-	-	86,653
<b>Aktive gjithsej</b>	<b>2,980,849</b>	<b>4,386,980</b>	<b>3,896,108</b>	<b>876,139</b>	<b>1,280,916</b>	<b>812,917</b>	<b>14,233,910</b>	<b>(66,669)</b>

<b>Detyrime</b>								
Llogari rrjedhëse nga banka	-	-	-	-	-	-	-	8,001
Llogari rrjedhëse nga klientët	1,402,693	-	-	-	-	-	1,402,693	3,449,586
Depozita nga klientët	Fiks. 703,439	2,757,251	3,582,836	1,204,928	502,973	-	8,751,428	93,993
Hua dhe borxhi i varur	Ndry. 890,000	170,000	-	-	-	-	1,060,000	443
Detyrime të tjera financiare	-	-	-	-	-	-	-	167,491
<b>Detyrime gjithsej</b>	<b>2,996,132</b>	<b>2,927,251</b>	<b>3,582,836</b>	<b>1,204,928</b>	<b>502,973</b>	<b>-</b>	<b>11,214,121</b>	<b>3,719,514</b>
Pozicioni i hapur i gap-it të ndjeshmërisë së NI	(15,283)	1,459,729	313,273	(328,790)	777,943	812,917	3,019,789	(3,786,183)

GAP-i i ndjeshmërisë së interesit në EURO Më 31dhjetor 2017	Deri në 1 muaj	1-6 muaj	6-12 muaj	1-2 vjet	2-5 vjet	Më shumë se 5 vjet	Totali i ndjeshëm ndaj interesit	Jo i ndjeshëm ndaj interesit
<b>Aktive</b>								
Arka	-	-	-	-	-	-	-	357,897
Llogari me bankën qendrore	854,994	-	-	-	-	-	854,994	4,570
Llogari rrjedhëse me bankat	-	-	-	-	-	-	-	2,724,335
Bono thesari dhe tituj të treg.	Fiks. -	-	-	-	-	-	-	211
	Ndry. 132,950	-	-	-	-	-	132,950	550
Depozita me afat të bankave	-	-	-	-	-	-	-	-
Hua dhe paradhëniet klientëve	Fiks. 1,271,251	2,151,414	2,218,931	1,262,690	2,161,398	1,187,586	10,253,270	(464,813)
	Ndry. 496,607	814,584	683,908	-	-	-	1,995,099	(49,646)
Aktive të tjera financiare	-	-	-	-	-	-	-	85,443
<b>Aktive gjithsej</b>	<b>2,755,802</b>	<b>2,965,998</b>	<b>2,902,839</b>	<b>1,262,690</b>	<b>2,161,398</b>	<b>1,187,586</b>	<b>13,236,314</b>	<b>2,658,547</b>

<b>Detyrime</b>								
Llogari rrjedhëse nga banka	-	-	-	-	-	-	-	11,590
Llogari rrjedhëse nga klientët	1,882,865	-	-	-	-	-	1,882,865	4,553,458
Depozita nga klientët	112,079	697,575	1,265,588	172,491	42,888	-	2,290,621	2,494
Hua dhe borxhi i varur	Fiks. 664,750	1,263,025	398,850	1,329,500	-	-	3,656,125	3,732
	Ndry. 664,750	-	-	-	-	-	664,750	21,155
Detyrime të tjera financiare	-	-	-	-	-	-	-	143,885
<b>Detyrime gjithsej</b>	<b>3,324,444</b>	<b>1,960,600</b>	<b>1,664,438</b>	<b>1,501,991</b>	<b>42,888</b>	<b>-</b>	<b>8,494,361</b>	<b>4,736,313</b>
Pozicioni i hapur i gap-it të ndjeshmërisë së NI	(568,642)	1,005,398	1,238,401	(239,301)	2,118,510	1,187,586	4,741,952	(2,077,766)



GAP-i i ndjeshmërisë së interesit në USD Më 31dhjetor 2017		Deri në 1 muaj	1-6 muaj	6-12 muaj	1-2 vjet	2-5 vjet	Më shumë se 5 vjet	Totali i ndjeshëm ndaj interesit	Jo i ndjeshëm ndaj interesit	
<b>Aktive</b>										
Arka		-	-	-	-	-	-	-	39,645	
Llogari me bankën qendrore		141,729	-	-	-	-	-	141,729	4,981	
Llogari rrjedhëse me bankat		-	-	-	-	-	-	-	712,377	
Bono thesari dhe tituj të treg.		Fiks.	-	-	-	-	-	-	-	
		Ndry.	-	-	-	-	-	-	-	
Depozita me afat të bankave		-	-	-	-	-	-	-	19,315	
Hua dhe paradhëniet klientëve		Fiks.	33,828	325,018	144,019	29,835	38,137	7,870	578,708	(39,638)
		Ndry.	-	-	91,092	-	-	-	91,092	(956)
Aktive të tjera financiare		-	-	-	-	-	-	-	722	
<b>Aktive gjithsej</b>		<b>175,557</b>	<b>325,018</b>	<b>235,110</b>	<b>29,835</b>	<b>38,137</b>	<b>7,870</b>	<b>811,528</b>	<b>736,447</b>	
<b>Detyrime</b>										
Llogari rrjedhëse nga banka		-	-	-	-	-	-	-	-	
Llogari rrjedhëse nga klientët		228,067	-	-	-	-	-	228,067	698,015	
Depozita nga klientët		74,010	217,493	374,556	12,769	9,223	-	688,050	2,367	
Hua dhe borxhi i varur		Fiks.	-	-	-	-	-	-	-	
		Ndry.	-	-	-	-	-	-	-	
Detyrime të tjera financiare		-	-	-	-	-	-	-	35,065	
<b>Detyrime gjithsej</b>		<b>302,078</b>	<b>217,493</b>	<b>374,556</b>	<b>12,769</b>	<b>9,223</b>	<b>-</b>	<b>916,118</b>	<b>735,447</b>	
<b>Pozicioni i hapur i gap-it të ndjeshmërisë së NI</b>		<b>(126,521)</b>	<b>107,526</b>	<b>(139,446)</b>	<b>17,066</b>	<b>28,915</b>	<b>7,870</b>	<b>(104,589)</b>	<b>999</b>	

Analiza dhe llogaritjet kryhen për të përcaktuar efektin e lëvizjeve të normës së interesit në vlerën ekonomike të kapitalit dhe kapacitetin për të fituar interes gjatë një periudhe të caktuar kohe, dhe për rrjedhojë të zvogëlojë rreziqet të cilat ndikojnë këto dy parametra. Duke marrë në konsideratë strukturat e aktivitetit dhe detyrimeve në Euro dhe USD më 31 Dhjetor 2018 dhe 2017, dhe duke

supozuar një ndryshim paralel të normës së interesit për +/-200bp dhe 100bp në aktivitet dhe detyrimet që janë të ndjeshme ndaj normës, profili i riskut të normës së interesit të bankës paraqitet si më poshtë ku shifrat negative paraqesin fitimin dhe humbjen dhe rënien e kapitalit neto:

Efekti i parashikuar i të ardhurave	2018		2017	
	200 bp	100 bp	200 bp	100 bp
Ndryshimi: normat e tregut në LEK	36,387	18,193	35,979	19,545
Ndryshimi: normat e tregut në EUR	51,962	25,981	96,924	40,602
Ndryshimi: normat e tregut në USD	6,964	3,482	14,973	7,054
<b>Efekti gjithsej (me taksa)</b>	<b>95,313</b>	<b>47,656</b>	<b>147,876</b>	<b>67,201</b>
Si % e kapitalit	2.52%	1.26%	3.03%	1.38%

#### Rreziku i likuiditetit

Risku i likuiditetit është përcaktuar si paafësia e mundshme e bankës për të përmbushur plotësisht ose në kohë detyrimet aktuale dhe të ardhshme të saj. Prandaj banka duhet të ruajë në çdo kohë fonde të mjaftueshme likuide për të plotësuar detyrimet e saj, edhe në rrethana potenciale të jashtëzakonshme. Risku i likuiditetit është gjithashtu risku që financimi shtesë nuk mund të merret, ose mund të rimerret me norma interesi tregu më të larta. Ai mund të shkaktohet nga çrregullimi i tregut ose përkeqësimi i huas e cila mund të bëjë që disa fonde financimi mos të jenë të disponueshme. Për të zbutur dhe zvogëluar riskun e likuiditetit,

Banka diversifikon burimet e financimit dhe administron aktivitetet me kujdes likuiditeti, duke ruajtur një gjendje mjete monetare dhe të ngjashme të mjaftueshme për të plotësuar kërkesat e menjëhershme për përmbushje detyrimi.

Banka synon të ruajë pozitiv *gap*-in e maturimit kumulativ të pritshëm. Nëse *gap*-i i maturimit kumulativ i pritshëm nuk do të jetë pozitiv, banka e konsideron likuiditetin si një "pozicion likuiditeti në mbikëqyrje".

Tabela e mëposhtme paraqet aktivitetet dhe detyrimet financiare sipas maturimit kontraktor në datën e raportimit, ose sipas maturimit të pritshëm.



31 dhjetor 2018	Kërkesa dhe më pak se 1 muaj	Nga 1 deri në 6 muaj	Nga 6 deri në 12 muaj	Nga 12 muaj deri në 5 Vjet	Mbi 5 vjet	Totali
<b>Aktive</b>						
Mjete monetare dhe të ngjashme	5,951,907	-	-	-	-	5,951,907
Letra me vlerë të tregtueshme	99,915	693,555	481,086	-	-	1,274,556
Detyrime nga banka të tjera	-	-	-	-	19,020	19,020
Hua dhe paradhënie klientëve	2,108,756	2,768,381	3,643,850	5,297,825	8,508,750	22,327,562
Letra me vlerë të vendosjes	-	-	-	358,038	-	358,038
Aktive të tjera financiare	155,776	-	-	-	-	155,776
<b>Totali</b>	<b>8,316,354</b>	<b>3,461,936</b>	<b>4,124,936</b>	<b>5,655,863</b>	<b>8,527,770</b>	<b>30,086,860</b>
<b>Detyrimet</b>						
Detyrime ndaj bankave të tjera	612,456	493,680	1,727,880	370,060	617,100	3,821,376
Llogari të klientëve – Biznes	4,577,824	70,612	225,953	48,188	-	4,922,578
Llogari të klientëve – Privat	6,721,625	2,146,096	4,629,826	2,251,089	-	15,784,636
Fonde të tjera hua	490,064	-	-	-	2,948,049	3,474,113
Borxhi i varur	-	-	-	-	636,738	636,738
Angazhimet e kredisë bruto	1,387,411	-	-	-	-	1,387,411
Garancitë financiare	1,028,128	-	-	-	-	1,028,128
Detyrime të tjera financiare	160,085	-	-	-	-	160,085
<b>Totali i pagesave potenciale në të ardhmen për detyrimet financiare</b>	<b>14,977,594</b>	<b>2,710,388</b>	<b>6,583,659</b>	<b>2,669,537</b>	<b>4,237,887</b>	<b>31,179,065</b>
<b>Gap-i i likuiditetit nga instrumentet financiare</b>	<b>(6,661,240)</b>	<b>751,548</b>	<b>(2,425,783)</b>	<b>2,988,326</b>	<b>4,289,884</b>	<b>(1,092,205)</b>

31 dhjetor 2018	Kërkesa dhe më pak se 1 muaj	Nga 1 deri në 6 muaj	Nga 6 deri në 12 muaj	Nga 12 muaj deri në 5 Vjet	Mbi 5 vjet	Totali
<b>Aktive</b>						
Mjete monetare dhe të ngjashme	6,710,872	-	-	-	-	6,710,872
Letra me vlerë të tregtueshme	434,937	596,415	393,155	-	-	1,424,507
Detyrime nga banka të tjera	100,011	-	-	-	19,315	119,326
Hua dhe paradhënie klientëve	1,141,495	1,453,003	8,074,808	8,669,584	3,440,141	22,779,031
Letra me vlerë të vendosjes	-	273,131	133,500	211	-	406,842
Aktive të tjera financiare	172,818	-	-	-	-	172,818
<b>Totali</b>	<b>8,560,133</b>	<b>2,322,549</b>	<b>8,601,463</b>	<b>8,669,795</b>	<b>3,459,456</b>	<b>31,613,396</b>
<b>Detyrimet</b>						
Detyrime ndaj bankave të tjera	1,046,094	1,434,371	398,940	-	-	2,879,406
Llogari të klientëve – Biznes	4,250,937	64,129	296,986	30,365	-	4,642,417
Llogari të klientëve – Privat	8,848,315	3,554,622	4,822,279	2,038,056	140,556	19,403,829
Fonde të tjera hua	530,070	-	-	1,330,416	-	1,860,486
Borxhi i varur	21,155	-	-	664,750	-	685,905
Angazhimet e kredisë bruto	2,426,117	-	-	-	-	2,426,117
Garancitë financiare	910,067	-	-	-	-	910,067
Detyrime të tjera financiare	346,474	-	-	-	-	346,474
<b>Totali i pagesave potenciale në të ardhmen për detyrimet financiare</b>	<b>18,379,229</b>	<b>5,053,123</b>	<b>5,518,205</b>	<b>4,063,587</b>	<b>140,556</b>	<b>33,154,699</b>
<b>Gap-i i likuiditetit nga instrumentet financiare</b>	<b>(9,819,095)</b>	<b>(2,730,574)</b>	<b>3,083,258</b>	<b>4,606,208</b>	<b>3,318,900</b>	<b>(1,541,303)</b>

Për qëllime likuiditeti, banka klasifikon depozitat pa afat dhe depozitat e kursimit si depozita të cilat do të likuidohen në momentin e paraqitjes së kërkesës dhe në afatin e maturimit brenda një muaji. Për rrjedhojë, është rritur gap-i kontraktor i likuiditetit deri në dymbëdhjetë muaj. Megjithatë, mundësia që këto vlera të mëdha të depozitave të klientëve, që arrijnë në më shumë se 50% të totalit të depozitave, do të largohen nga Banka brenda një periudhe 1 muaj apo edhe 12 muaj, është shumë e vështirë dhe nuk është evidentuar historikisht. Prandaj, Banka nuk e vlerëson se ka një gap

tillë likuiditeti në planin afat të shkurtër. Ai përqendrohet më shumë në gap-in e prishëm të maturimit, i cili paraqet një skenar më të mundshëm, ku normat e daljes 1 muajore ndryshojnë nga 7%, në 9% dhe 12% respektivisht për skenarët e standardeve dhe stresit, duke qenë më të larta se çdo evidencë historike. Përveç kësaj, Banka mban një portofol të aktiveve financiare shumë të tregtueshme (letra me vlerë të vendosjes) që mund të likuidohen lehtë si mbrojtje nga çdo ndërprerje e paparashikuar e flukseve të mjeteve monetare. Nga pikëpamja e menaxhimit të likuiditetit, këto aktive klasifikohen

në shportën e parë të maturimit dhe prandaj sigurojnë një fond rezervë në rast të flukseve në dalje të papritura. Në anën tjetër, Banka ka vendosur marrëdhënie me homologët vendas dhe ndërkombëtarë (si ProCredit Holding dhe ProCredit Bank në Gjermani), në lidhje me çdo nevojë për sigurimin e fondeve në tregun e parasë, bazuar në parashikimet e likuiditetit të kryera çdo muaj. Strategjia e depozitave mbetet fokusi kryesor i Bankës, me qëllim sigurimin e fondeve të reja nga klientët kryesorë të synuar, me qëllim mbulimin e flukseve në dalje të pritshme si dhe për të mbështetur rritjen.

Menaxhimi i Rrezikut të Likuiditetit bazohet dhe mbështetet nga një kuadër i hartuar mirë për administrimin e rrezikut, e përbërë nga Politikat dhe Procedurat për Administrimin e Rrezikut të Likuiditetit, Plani për sigurimin e likuiditetit në rast emergjence, Plani i Rimëkëmbjes, strukturat e specializuara përgjegjëse dhe komitetet drejtuese (Komiteti i Aktivit dhe Pasivit - ALCO dhe Komiteti i Administrimit të Riskut - RMCO).

Drejtimi i Bankës monitoron raportet e likuiditetit të Bankës kundrejt kërkesave të brendshme dhe rregullatorë çdo ditë, çdo javë dhe çdo muaj. Si rrjedhojë Drejtimi beson se Banka nuk ka asnjë gap të likuiditetit afatshkurtër.

Normat e flukseve në dalje që janë përdorur aktualisht tejkalojnë çdo zhvillim historik në lidhje me depozitat e klientëve. Në një rast që këto nuk janë të mjaftueshme, Banka duhet të rregullojë / rrisë këto norma në përputhje me rrethanat dhe sërisht duhet që të jetë në përputhje dhe të respektojë kufijtë përkatës.

## 7. Administrimi i kapitalit

Objektivat e Bankës për administrimin e kapitalit, i cili është koncepti më i gjerë se kapitali aksionar në paraqitjen e bilancit, janë:

- të respektojë kërkesat e kapitalit të përcaktuara nga Banka e Shqipërisë;
- të ruajë dhe të mbrojë aftësinë e bankës për të vazhduar aktivitetin në mënyrë që mund të vazhdojë kështu të gjenerojë të ardhura për aksionerët dhe përfitime për grupet e tjera të interesit; dhe

- të ruajë një bazë të fortë kapitali për të mbështetur zhvillimin e aktivitetit të saj të biznesit.

Mjaftueshmëria e kapitalit dhe përdorimi i kapitalit rregullator monitorohen çdo ditë nga drejtimi i bankës, duke përdorur teknika në bazë të udhëzimeve që janë zhvilluar nga Komiteti i Bazelit dhe Direktivat e Komunitetit Europian, të cilat zbatohen nga Banka e Shqipërisë për qëllime mbikëqyrëse.

Informacioni i kërkuar paraqitet çdo tremujor pranë Bankës së Shqipërisë. Banka e Shqipërisë kërkon që Banka ose Grupi Bankar duhet të (a) ruaj një nivel minimal të kapitalit rregullator prej LEK 1 miliard, si dhe (b) të ruaj një raport të totalit të kapitalit rregullator ndaj aktiveve të ponderuara me risk (Raporti Bazel II) në nivelin ose mbi nivelin minimal të pranuar gjerësisht në arenën ndërkombëtare prej 12% .

Kapitali rregullator është kapitali i Bankës, i llogaritur sipas kërkesave të rregullores së Bankës së Shqipërisë, për të mbuluar rrezikun e kredisë, rrezikun e tregut dhe rrezikun operacional. Kapitali rregullator i Bankës është i ndarë në dy nivele. Banka llogarit kapitalin rregullator si shuma e kapitalit të nivelit T1 bazë dhe kapitalit të nivelit T2 shtesë duke marrë parasysh zbritjet në përputhje me kërkesat e përshkruara në rregulloret e Bankës së Shqipërisë.

Bankat llogarisin ekspozimet e ponderuara me rrezikun si shuma e elementeve në vijim:

- Zërat e ekspozimeve dhe ekspozimet e mundshme të ponderuara për kredinë, ose rrezikun e kundërpalës;
- Kërkesat e kapitalit për rreziqet e tregut;
- Kërkesat e kapitalit për rreziqet operationale.

Tabela e mëposhtme paraqet në mënyrë të përmbledhur përbërjen e kapitalit rregullator dhe raportet e bankës për vitet ushtrimore të mbyllur më 31 Dhjetor 2018 dhe 2017. Gjatë këtyre dy viteve, banka ka respektuar të gjitha kërkesat e jashtme të kapitalit. Duhet të theksohet se shumtë në vijim janë të bazuara në rregulloret e Bankës së Shqipërisë dhe nuk bien dakord domosdoshmërisht për shumtë e paraqitura në këto pasqyra financiare.

Kapitali bazë Tier 1	2018	2017
Kapitali aksionar	3,763,884	3,387,148
Rezerva statutore	708,110	708,110
Ekspozimi ndaj këmbimit valutor	(56,150)	29,498
Fitimi statutor i akumuluar	(1,028,279)	(416,115)
Aktive jo-materiale statutore	(51,874)	(98,262)
<b>Totali i Kapitalit bazë Tier 1 të kualifikuar</b>	<b>3,335,691</b>	<b>3,610,379</b>
<b>Kapitali shtesë Tier 2</b>		
Borxhi i varur	636,738	685,905
Detyrime të tjera	(151,512)	(184,179)
<b>Totali i Kapitalit shtesë Tier 2 të kualifikuar</b>	<b>485,226</b>	<b>501,726</b>
<b>Totali i kapitalit rregullator</b>	<b>3,820,917</b>	<b>4,112,105</b>
<b>Totali i aktiveve të ponderuara me risk</b>	<b>27,792,887</b>	<b>30,630,823</b>

Aktive të ponderuara me risk:		
Në bilanc	24,247,251	26,271,363
Jashtë bilancit	1,054,304	912,516
Aktive të ponderuara me risk për riskun operacional	2,491,331	3,054,130
Aktive të ponderuara me risk për riskun e tregut	-	392,814
<b>Totali i aktiveve të ponderuara me risk</b>	<b>27,792,886</b>	<b>30,630,823</b>
<b>Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit bazë Tier I</b>	<b>12.00%</b>	<b>11.79%</b>
<b>Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit bazë Tier II</b>	<b>13.75%</b>	<b>13.42%</b>

Mjaftueshmëria e kapitalit monitorohet në mënyrë plotësuese duke përdorur një metodë uniforme për llogaritjen e mjaftueshmërisë së kapitalit në të gjithë grupin ProCredit në përputhje me udhëzimet e Komitetit të Bazelit (Bazel II). Administrimi dhe menaxhimi i kapitalit të Bankës rregullohet nga Politika e Bankës për Menaxhimin e Kapitalit dhe Politika e Bankës mbi Kapacitetin e Mbajtjes së Rrezikut. Raporti i kapitalit rregullator dhe raporti i kapitalit sipas Bazel II, raporti i levave Tier 1 dhe kapaciteti i mbajtjes së rrezikut monitorohen çdo muaj nga Komiteti i Bankës për Administrimin e Rrezikut dhe Komiteti i Administrimit të Rrezikut të Grupit.

### Kapaciteti i mbajtjes së riskut

Përveç raporteve të kapitalit rregullator, Banka vlerëson mjaftueshmërinë e saj të kapitalit duke përdorur konceptin e aftësisë mbajtëse të rrezikut për të pasqyruar profilin specifik të rrezikut të Bankës, përkatësisht duke krahasuar humbjet e mundshme që rrjedhin nga operimi i saj me kapacitetin e Bankës për të përballuar humbje të tilla. Konceptet e mëposhtme janë përdorur për të llogaritur humbjet e mundshme në kategoritë e ndryshme të rrezikut:

- Rreziku i kredisë (klientët): Bazuar në një analizë migrimi të përditësuar rregullisht për portofolin e kredisë, llogaritet niveli historik i humbjeve dhe shpërndarja e tyre statistikore. Normat e humbjeve historike në kategoritë të ndryshme vonesash (me një nivel besueshmërie prej 95%) aplikohen për portofolin e kredisë për të llogaritur humbjet e mundshme të kredisë.
- Rreziku i kundërpalës: Llogaritja e humbjeve të mundshme për shkak të rrezikut të kundërpalës bazohet në probabilitetin e mospagimit që buron nga klasifikimi përkatës ndërkombëtar i palës ose vendit përkatës ku ushtohet aktiviteti (pas rregullimit)
- Rreziqet e tregut: Ndërsa luhatjet historike të monedhës analizohen statistikisht dhe variacione më të larta (niveli i besueshmërisë 99%) aplikohen në pozicionet aktuale të monedhës, rreziku i normës së interesit llogaritet duke përcaktuar ndikimin e vlerës ekonomike të një goditje standarde të normës së interesit për EUR / USD (2 pikë përqindje, goditja e normës së interesit të Bazelit) dhe nivelet më të larta (historike) për monedhat e tjera.
- Rreziku operacional: Administrimi i rrezikut operacional është një fushë e veçantë brenda administrimit të përgjithshëm të rrezikut të ProCredit Bank. Proceset e menaxhimit të rrezikut operacional janë të integruara në aktivitetet e përditshme të menaxhimit të riskut dhe zbatohen në të gjitha nivelet. Rreziku operacional përcaktohet si rreziku i humbjes që rezulton nga proceset e brendshme të papërshtatshme ose të dështuara, nga njerëzit dhe sistemet, ose nga ngjarje të jashtme. Ky përkufizim përfshin rrezikun ligjor si dhe rrezikun reputacional.

Objektivat e përgjithshëm të qasjes së Bankës ProCredit në menaxhimin e rreziqeve operationale janë:

- Të kuptojë faktorët nxitës të rreziqeve operationale
- Të jetë në gjendje të identifikojë çështjet kritike sa më shpejt që të jetë e mundur
- Të shmangë humbjet e shkaktuara nga rreziqet operationale

Prandaj banka ka marrë vendime strategjike për sa vijon:

- Banka do të operojë me një shkallë të lartë thjeshtësie, transparence dhe diversifikimi. Në fokus duhet të jetë komunikimi i hapur, vlerat e korporatës dhe besnikëria e stafit të punonjësve
- Ndarja e detyrave dhe parimi i "katër syve" zbatohen aty ku është e nevojshme
- Proceset duhet të përcaktohen qartë dhe dokumentohen

- Auditimi i Brendshëm kryen kontrolle të rregullta
- Fokus i fortë do të vendoset në kulturën e korporatës dhe zhvillimin e stafit të punonjësve
- Banka duhet të zbatojë standarde të larta teknike për harduer, softuer dhe sisteme të ruajtjes back up të teknologjisë së informacionit.

Komiteti i Administrimit të Rrezikut Operacional ndihmon Këshillin Administrativ për menaxhimin dhe administrimin e rrezikut operacional siç përcaktohet në bazë të politikës së brendshme përkatëse si dhe në rregulloren e Bankës Qendrore.

### 8. Vlera e drejtë e instrumenteve financiare

Vlera e drejtë e aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare të cilat tregtohen në tregje aktive bazohen në çmimet e kuotuar të tregut ose në kuotimet e çmimit nga agjentët. Për të gjitha instrumentet e tjera financiare Banka përcakton vlerat e drejta duke përdorur teknika të tjera të vlerësimit.

Për instrumentet financiare të cilat nuk tregtohen shpesh dhe kanë një transparencë të vogël për çmimin, vlera e drejtë është më pak objektive, dhe kërkon nivele të ndryshme gjykimi në varësi të likuiditetit, përqendrimit, pasigurisë së faktorëve të tregut, supozimeve të çmimit dhe rreziqe të tjera të cilat prekin një instrument të caktuar.

#### (a) Modelet e vlerësimit

Banka mat vlerat e drejta duke përdorur hierarkinë e mëposhtme të vlerës së drejtë, e cila pasqyron rëndësinë e informacioneve dhe të dhënave që përdoren për realizimin e matjeve dhe vlerësimeve.

*Niveli 1:* informacione dhe të dhëna që janë çmimet e kuotuar të tregut (të parregulluara) në tregjet aktive për instrumente të ngjashme. Një treg konsiderohet aktiv nëse çmimet e kuotuar janë gati dhe ofrohen rregullisht nga një agjent këmbimi, agjent ndërmjetësi, bankë, shërbim për përcaktimin e çmimit ose nga një agjenci rregullatore, dhe këto çmime përfaqësojnë transaksionet aktuale dhe të rregullta të cilat ndodhin në treg në mënyrë të pavarur.

*Niveli 2:* informacione dhe të dhëna të ndryshme nga çmimet e kuotuar që përfshihen në Nivelin 1 të cilat janë të vëzhgueshme qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose në mënyrë jo të drejtpërdrejtë. Teknikat e vlerësimit që janë aplikuar i referohen vlerës së drejtë aktuale të instrumenteve të ngjashme dhe analizës zbritjes së fluksit të parasë duke përdorur parametrat që vëzhgohen në treg.

*Niveli 3:* informacione dhe të dhëna të cilat nuk janë të vëzhgueshme. Nëse normat e tregut të vëzhgueshme nuk janë të disponueshme, normat e brendshme përdoren si të dhëna për modelin e zbritjes së fluksit të parasë. Normat e brendshme përcaktohen duke marrë në konsideratë koston e fondeve në varësi të monedhës dhe afatit të maturimit plus marzhin e riskut. Normat e brendshme krahasohen rregullisht me normat që aplikohen për transaksione të palëve të treta dhe janë në përputhje me parametrat për një transaksion të rregullt midis pjesëmarrësve në treg sipas kushteve të tregut në datën e matjes.

Teknikat e vlerësimit përfshijnë vlerën aktuale neto dhe modelet e zbritjes së fluksit të parasë, krahasimin me instrumente të ngjashme për të cilat ekzistojnë çmimet e vëzhgueshme të tregut, ose modele të tjera vlerësimi. Supozimet dhe informacioni që përdoret në teknikat e vlerësimit përfshijnë norma interesit pa risk dhe krahasuese, spreadet e kredisë dhe prime të tjera të cilat përdoren për të vlerësuar dhe çmuar normat e zbritjes, çmimet e obligacionit dhe kapitalit, kursin e këmbimit valutor, kapitalin dhe çmimet e indeksit të kapitalit, si dhe luhatshmëria dhe ndërlihdja e pritshme e çmimit.

Objekivi i teknikave të vlerësimit është të arrijmë të matim vlerën e drejtë e cila pasqyron çmimin që do të rezultojë për të shitur aktivin ose për të paguar transferimin e detyrimit në një transaksion të rregullt midis pjesëmarrësve në treg në datën e matjes.

Banka përdor modele vlerësimi të njohura gjerësisht për përcaktimin e vlerës së drejtë të instrumenteve financiare të zakonshme dhe më të thjeshta, si norma e interesit dhe këmbimet valutore swap të cilat përdorin vetëm të dhëna tregu të vëzhgueshme dhe nevojitet gjykime dhe çmuarje të vogla nga drejtimi. Çmimet e vëzhgueshme ose informacioni i modelit janë zakonisht të disponueshme në treg për letrat me vlerë të listuara të borxhit dhe të kapitalit. Disponueshmëria e çmimeve dhe të dhënave të tregut të vëzhgueshme dhe informacioni i modelit zvogëlon nevojën për gjykimin dhe çmuarjen e drejtimit si dhe zvogëlon gjithashtu pasiguritë që shoqërojnë përcaktimin e vlerës së drejtë. Disponueshmëria e çmimeve dhe të dhënave të tregut të

vëzhgueshme dhe informacioni ndryshon në varësi të produkteve dhe tregjeve dhe është subjekt ndryshimi në bazë të ngjarjeve të veçanta ose kushteve të përgjithshme të tregjeve financiare.

**(b) Instrumentet financiare të matura me vlerën e drejtë – hierarkia e vlerës së drejtë**

Tabela e mëposhtme analizon instrumentet financiare të matura me vlerën e drejtë në datën e raportimit sipas nivelit të hierarkisë së vlerës së drejtë në të cilën klasifikohet matja e vlerës së drejtë. Këto vlera të drejta njihen në pasqyrën e pozicionit financiar.

	Vlera e drejtë	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3
<b>Letra me vlerë të borxhit FVOCI</b>				
<i>31 dhjetor 2018</i>				
Bono thesari	1,274,556	-	1,274,556	-
Obligacione	358,038	-	358,038	-
Aksione	196	-	196	-
<b>Totali</b>	<b>1,632,790</b>	<b>-</b>	<b>1,632,790</b>	<b>-</b>
<b>Instrumente financiare të vendosjes (borxh)</b>				
<i>31 dhjetor 2017</i>				
Bono thesari	1,424,507	-	1,424,507	-
Obligacione	406,631	-	406,631	-
Aksione	211	-	211	-
<b>Totali</b>	<b>1,831,349</b>	<b>-</b>	<b>1,831,349</b>	<b>-</b>

**(c) Instrumentet financiare jo të matura me vlerën e drejtë për të cilat paraqitet vlera e drejtë**

Tabela e mëposhtme paraqet vlerat e drejta të instrumenteve financiare të matura jo me vlerën e drejtë dhe i analizon ato sipas nivelit të hierarkisë së vlerës së drejtë në të cilën klasifikohet çdo matje e vlerës së drejtë.

	31 dhjetor 2018				31 dhjetor 2017			
	Vlera kontabël	Vlera e drejtë Niveli 1	Vlera e drejtë Niveli 2	Vlera e drejtë Niveli 3	Vlera kontabël	Vlera e drejtë Niveli 1	Vlera e drejtë Niveli 2	Vlera e drejtë Niveli 3
<b>Mjete financiare</b>								
<b>Hua dhe të arkëtueshme</b>								
Mjete monetare dhe llogari me Bankën Qendrore	5,956,379	5,956,379	-	-	6,710,872	6,710,872	-	-
Hua dhe paradhënie bankave	19,020	19,020	-	-	119,326	119,326	-	-
Hua dhe paradhënie klientëve	22,327,562	-	-	21,752,008	22,779,031	-	-	22,735,553
Hua bujqësore	732,505	-	-	713,623	1,719,490	-	-	1,713,857
Hua biznesi	19,784,364	-	-	19,274,368	18,963,237	-	-	18,927,587
Hua private	109,634	-	-	106,808	187,824	-	-	186,618
Hua strehimi	1,701,059	-	-	1,657,210	1,908,479	-	-	1,907,490
Mjete të tjera financiare	155,776	-	-	155,776	172,818	-	-	172,818
Detyrime ndaj bankave	3,821,376	3,821,376	-	-	2,879,406	2,879,406	-	-
Depozitat e klientëve	20,671,214	10,625,170	-	10,233,222	24,046,245	12,209,273	-	11,943,692
Llogari rrjedhëse	7,451,162	7,451,162	-	-	8,693,871	8,693,871	-	-
Llogari kursimi dhe të tjera	3,174,008	3,174,008	-	-	3,515,403	3,515,403	-	-
Depozita me afat	9,970,461	-	-	10,157,639	11,730,099	-	-	11,836,819
Interesi i përlllogaritur	75,583	-	-	75,583	106,873	-	-	106,873
Huamarrje dhe borxhi i varur	-	-	-	-	-	-	-	-
Huamarrje	3,474,113	3,474,113	-	-	1,860,486	1,860,486	-	-
Borxhi i varur	636,738	-	-	636,738	685,905	-	-	685,905
Detyrime të tjera financiare	152,710	-	-	152,710	346,474	-	-	346,474

Sipas rastit, vlera e drejtë e huave dhe paradhënieve bazohet në transaksionet evidentueshme në treg. Nëse nuk ka transaksione të evidentueshme në treg, vlera e drejtë përcaktohet me anë të teknikave të vlerësimit. Informacionet që përdoren në teknikat e vlerësimit përfshin humbjet e pritshme nga huat, normat e interesit dhe komisionet e parapagimit. Për të përmirësuar saktësinë e përlogaritjes së vlerësimit për huat e individëve dhe huat e vogla tregtare, huat homogjene grupohen në portofole me karakteristika të ngjashme.

Vlera e drejtë e depozitave nga bankat dhe klientët përcaktohet me anë të teknikave të fluksit të parasë, duke aplikuar norma të cilat ofrohen për depozita me maturim dhe afate të ngjashme. Vlera e drejtë e depozitave që paguhen sipas kërkesës është shuma e cilat paguhet në datën e raportimit.

#### 9. Paraqitja e instrumenteve financiare sipas kategorisë së matjes

SNRF 9 përfshin tri kategori kryesore të klasifikimit për aktivet financiare: të cilat maten me kosto të amortizuar, vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse (FVOCI) dhe vlerën e

drejtë nëpërmjet fitimit humbjes (FVTPL). Klasifikimi i SNRF 9 në përgjithësi bazohet në modelin e biznesit në të cilin menaxhohet një aktivi financiar dhe flukset kontraktuale të mjeteve monetare parasë. Standardi eliminon kategoritë e mëparshme të SNK 39 të investimeve të mbajtura deri në maturim, huatë dhe llogaritë e arkëtueshme dhe letrat me vlerë të vendosjes. Sipas SNRF 9, derivatet e përfshirë në kontratat ku hosti është një aktiv financiar në sferën e standardit nuk degëzohen kurrë. Në vend të kësaj, i gjithë instrumenti hibrid vlerësohet për klasifikim.

SNRF 9 kryesisht parashikon kërkesat ekzistuese në SNK 39 për klasifikimin e detyrimeve financiare. Megjithatë, edhe pse sipas SNK 39, të gjitha ndryshimet në vlerën e drejtë të detyrimeve të përcaktuara sipas opsionit të vlerës së drejtë njihen në pasqyrën e fitim humbjeve, sipas SNRF 9 ndryshimet e vlerës së drejtë paraqiten në përgjithësi si më poshtë:

- shuma e ndryshimit të vlerës së drejtë që i atribuohet ndryshimeve në rrezikun e kredisë së detyrimit paraqitet në pasqyrën e të ardhurave të tjera përmbledhëse; dhe
- shuma e mbetur e ndryshimit në vlerën e drejtë paraqitet në pasqyrën e fitim humbjeve.

Më 31 dhjetor 2018	FVOCI	KA	Totali
Mjete monetare dhe llogari rrjedhëse me bankat	-	5,951,907	5,951,907
Hua dhe paradhënie bankave	-	19,020	19,020
Aktive të tjera financiare	-	361,274	361,274
<b>Hua për biznesin</b>	-	<b>20,516,869</b>	<b>20,516,869</b>
Hua klientëve	-	14,963,961	14,963,961
Paradhënie bankare	-	5,552,908	5,552,908
Karta krediti	-	-	-
<b>Hua për klientët privat</b>	-	<b>1,810,693</b>	<b>1,810,693</b>
Hua klientëve	-	1,781,163	1,781,163
Paradhënie bankare	-	23,241	23,241
Karta krediti	-	6,289	6,289
<b>Totali hua dhe paradhënie klientëve</b>	-	<b>22,327,562</b>	<b>22,327,562</b>
Investime ne letra me vlerë të vendosjes	1,632,594	-	1,632,594
Bono thesari të Qeverisë Shqiptare	1,274,556	-	1,274,556
Obligacione të Qeverisë Shqiptare	358,038	-	358,038
<b>Aktive financiare gjithsej</b>	<b>1,632,594</b>	<b>28,659,763</b>	<b>30,292,357</b>

Më 31 dhjetor 2017	Letra me vlerë të vendosjes	KA	Totali
Mjete monetare dhe llogari rrjedhëse me bankat	-	6,710,872	6,710,872
Hua dhe paradhënie bankave	-	119,326	119,326
Aktive të tjera financiare	-	436,706	436,706
<b>Hua për biznesin</b>	-	<b>20,682,727</b>	<b>20,682,727</b>
Hua klientëve	-	13,885,234	13,885,234
Paradhënie bankare	-	6,797,493	6,797,493
Karta krediti	-	-	-
<b>Hua për klientët privat</b>	-	<b>2,096,304</b>	<b>2,096,304</b>
Hua klientëve	-	2,017,171	2,017,171
Paradhënie bankare	-	23,929	23,929
Karta krediti	-	55,204	55,204
<b>Totali hua dhe paradhënie klientëve</b>	-	<b>22,779,031</b>	<b>22,779,031</b>
Investime ne letra me vlerë të vendosjes	1,831,138	-	1,831,138
Bono thesari të Qeverisë Shqiptare	1,424,507	-	1,424,507
Obligacione të Qeverisë Shqiptare	406,631	-	406,631
Ekspozimi ndaj letrave me vlerë të borxhit rregullohet nga Politika dhe Procedurat e Thesarit. Investimet lejohen të kryhen vetëm për letra me vlerë të cilat janë likuide dhe kanë klasifikimin minimal të kredisë (AA-) ose në tituj të qeverisë shqiptare, pas marrjes së miratimit nga Komiteti i Aktivit dhe Pasivit të Grupit (ALCO). Ekspozimi maksimal ndaj riskut të kredisë përfaqësohet nga vlera

kontabël e çdo aktivi financiar në pasqyrën e pozicionit financiar. Investimet në letrat me vlerë të borxhit janë me bankat qendrore, ose me institucionet financiare të klasifikuara paraqiten si më poshtë vijon:

Klasifikimet më 31 dhjetor	2018	2017
	Letra me vlerë të drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmblëdhëse	Letra me vlerë të vendosjes
AAA		133,711
B+	1,632,790	1,697,638
<b>Totali</b>	<b>1,632,790</b>	<b>1,831,349</b>

#### 21. Aktive të tjera

	2018	2017
Arkëtime nga transaksionet në ATM	22,981	38,611
Debitorë të tjerë	132,795	134,207
Aktive të tjera financiare	155,776	172,818
Prona të rimarra në zotërim	615,435	932,517
Shpenzime të parapaguara	84,980	182,168
Humbje nga zhvlerësimi për arkëtimet në llogari	(6,595)	-
<b>Totali</b>	<b>849,596</b>	<b>1,287,503</b>

Ndryshimi i zhvlerësimit për vitet e mbyllura më 31 Dhjetor 2018 dhe 2017, paraqitur nëpërmjet pasqyrës së fitim humbjeve është si më poshtë:

	31-dhjetor-18	31-dhjetor-17
Gjendja në fillim	-	-
Transferimi në efektin SNRF 9	7,829	-
Paraqitur në fitim humbje	(1,234)	-
Gjendja në fund	6,595	-

Debitorë të tjerë kryesisht kanë të bëjnë me parapagimet e bëra në Zyrat e Përmbarrimit që arkëtojnë fonde nga klientët që kanë marrë kredi nga proceset e rimarrjes në pronësi të cilat ende nuk kanë përfunduar, ose për proceset që janë finalizuar por shuma pritët të arkëtohet nga debitorët dhe gjithashtu përfshin dhe shitjet e pronave me kushte.

Pronat e rimarra në pronësi janë kolaterale të fituara nëpërmjet proceseve ligjore dhe përfshijnë tokën, ndërtesat dhe mjedise

biznesi, të cilat nuk përdoren nga Banka për funksionet e saj kryesore. Pronat e rimarra në zotërim për shkak të procesit ligjor duhet të shiten sa më shpejt që të jetë e mundur (shih shënimin 4.a. (iii)). Banka fshin plotësisht nga bilanci pronën e rimarrë në pronësi brenda 7 viteve nga njohja fillestare bazuar në vëzhgimet historike të menaxhimit dhe eksperiencën në rikuperimin e këtyre aktiveve.

Lëvizja e zërave të aktiveve të rimarra në pronësi gjatë periudhës së raportimit paraqitet si më poshtë:

	2018	2017
Gjendja në fillim të periudhës	932,517	1,356,262
Shtesa gjatë periudhës	61,717	84,229
Pakësime gjatë periudhës	(292,062)	(420,738)
Rikthimi i zhvlerësimit	-	5,757
Fshirja nga bilanci	(86,737)	(92,993)
Gjendja në fund të periudhës	615,435	932,517

## 22. Investime në prona

Banka ruan investimet në pronë si rezultat i përvetësimit përmes ekzekutimit të garancisë të huas dhe paradhënie klientëve.

Investime në prona	
<b>Kosto</b>	
Më 1 janar 2017	109,507
Shtesa	38,251
Pakësime	(38,644)
Më 31 dhjetor 2017	109,113
Pakësime	(13,404)
Më 31 dhjetor 2018	95,710
<b>Zhvlerësim i akumuluar</b>	
Më 1 janar 2017	(8,527)
Detyrimi për periudhën	(2,700)
Pakësime	344
Zhvlerësimi	(6,173)
Më 31 dhjetor 2017	(17,056)
Detyrimi për periudhën	(2,539)
Pakësime	1,063
Zhvlerësimi	(42,195)
Më 31 dhjetor 2018	(60,728)
<b>Zhvlerësimi i akumuluar</b>	
Më 31 dhjetor 2017	92,057
Më 31 dhjetor 2018	34,982

## 23. Ndërtesat dhe pajisjet

	Toka dhe Ndërtesa	Pajisje informatike e elektrike	Automjete	Mobilje dhe pajisje	Përmirësime të ambienteve me qira	Aktive në ndërtim	Totali
<b>Kosto</b>							
Më 1 Janar 2017	1,049,118	804,657	60,296	408,213	135,460	12,754	2,470,498
Shtesa	-	3,763	-	935	2,421	26,003	33,122
Pakësime	(13,616)	(53,167)	(15,309)	(35,811)	(68,087)	(2,342)	(188,332)
Transferime	-	18,778	6,298	2,743	-	(29,172)	(1,353)
Më 31 dhjetor 2017	1,035,502	774,031	51,285	376,080	69,794	7,243	2,313,935
Shtesa	11,543	6,417	29,178	3,863	1,599	23,357	75,956
Pakësime	(63,221)	(380,308)	(19,965)	(120,629)	(39,017)	(356)	(623,496)
Transferime	4,334	8,850	-	148	-	(13,333)	-
Më 31 dhjetor 2018	988,158	408,990	60,498	259,462	32,376	16,910	1,766,394
<b>Zhvlërësi i akumuluar</b>							
Më 1 Janar 2017	(159,220)	(622,549)	(43,063)	(305,346)	(80,028)	-	(1,210,206)
Detyrimi për periudhën	(21,669)	(56,381)	(7,471)	(29,296)	(34,582)	-	(149,399)
Pakësime	1,446	50,405	15,309	32,361	68,087	-	167,608
Më 31 dhjetor 2017	(179,443)	(628,525)	(35,225)	(302,281)	(46,522)	-	(1,191,996)
Detyrimi për periudhën	(22,025)	(43,235)	(6,769)	(17,948)	(18,021)	-	(107,998)
Pakësime	12,236	363,974	19,965	104,904	39,017	-	540,096
Më 31 dhjetor 2018	(189,232)	(307,786)	(22,029)	(215,325)	(25,526)	-	(759,898)
<b>Vlera kontabël neto</b>							
Më 31 dhjetor 2017	856,059	145,506	16,060	73,799	23,272	7,243	1,121,939
Më 31 dhjetor 2018	798,926	101,204	38,469	44,137	6,850	16,910	1,006,496

## 24. Aktive afatgjata jo-materiale

	Softueri i blerë
<b>Kosto</b>	
Më 1 Janar 2017	408,508
Shtesa	-
Transferime	(66,966)
Më 31 Dhjetor 2017	1,353
Shtesa	342,895
Pakësime	-
Transferime	(45,096)
Shtesa	-
Më 31 dhjetor 2018	297,799
<b>Amortizimi i akumuluar</b>	
Më 1 Janar 2016	(275,143)
Detyrimi për periudhën	(31,690)
Pakësime	65,539
Më 31 dhjetor 2017	(241,294)
Detyrimi për periudhën	(27,352)
Pakësime	24,915
Më 31 dhjetor 2018	(243,731)
<b>Vlera kontabël neto</b>	
Më 31 dhjetor 2017	101,601
Më 31 dhjetor 2018	54,068

## 25. Detyrime ndaj bankave

	2018	2017
Hua nga bankat rezidente	555,397	530,374
Hua nga bankat jo-rezidente	3,215,172	2,329,441
Llogari rrjedhëse nga bankat rezidente	50,807	19,591
<b>Totali</b>	<b>3,821,376</b>	<b>2,879,406</b>

Huatë nga bankat rezidente kanë maturime më 31 dhjetor 2018 deri në 91 ditë dhe normat e interesit prej 0.00%, dhe 0.50% për gjendjet e shprehura në lekë.

Huatë e bankave jorezidente kanë maturime më 31 dhjetor 2018 deri në 5 vjet (2017: deri në 194 ditë) dhe normat e interesit prej 0.70%, 0.75% dhe 0.78% për gjendjet e shprehura në euro (2017: 0.6% dhe 0.68% në vit për EUR).

## 26. Detyrime ndaj klientëve

	2018	2017
Llogari rrjedhëse		
Monedhë e huaj	4,097,609	4,871,324
Monedhë vendase	2,991,853	3,310,881
Llogari kursimi		
Monedhë e huaj	2,039,821	2,110,240
Monedhë vendase	1,130,644	1,396,418
Depozita me afat		
Monedhë e huaj	2,911,217	2,935,657
Monedhë vendase	7,064,313	8,704,387
Llogari të tjera të klientëve		
Monedhë e huaj	201,166	425,361
Monedhë vendase	234,590	186,402
Interesi i fituar	-	105,575
<b>Totali</b>	<b>20,671,213</b>	<b>24,046,245</b>

Llogaritë e kursimit në LEK (FlexSave) mbartin një interes prej 0.8% në vit (2017: 0.8%), ndërsa llogaritë e kursimit në monedhë të huaj Euro (FlexSave) mbartin një normë mesatare interesi respektivisht prej 0.2 (2017: 0.2%) dhe llogaritë e kursimit në USD (FlexSave) mbartin një interes 0.5% në vit (2017: 0.5).

Llogaritë e tjera të klientëve përfaqësojnë llogari të vendosura si garanci me kolateral cash nga klientët. Ato mbartin norma interesi në nivele të njëjta si depozitat me afat.

Normat e interesit që janë aplikuar për depozitat me afat më 31 Dhjetor 2018 dhe 31 Dhjetor 2017 paraqiten si më poshtë vijon:

(në %)	12 muaj	24-36 muaj	48-60 muaj
LEK	0.00 - 1.40	2.00 - 2.30	2.50 - 3.00
USD	0.00 - 1.00	1.10 - 1.20	1.30 - 1.40
EUR	0.00 - 0.40	0.50 - 0.60	0.70 - 0.80

## 31 dhjetor 2017

(në %)	12 muaj	24-36 muaj	48-60 muaj
LEK	0.00 - 1.00	1.5 - 1.90	2.10 - 2.50
USD	0.00 - 1.00	1.10 - 1.20	1.30 - 1.40
EUR	0.00 - 0.30	0.35 - 0.40	0.45 - 0.50

## 27. Borxhi i varur

	2018	2017
Borxhi i varur		
ProCredit Holding	617,100	664,750
Interesi i fituar	19,638	21,155
<b>Totali</b>	<b>636,738</b>	<b>685,905</b>

Në datën 3 Korrik 2014, the Banka mori nga ProCredit Holding AG & Co. KGaA një borxh të varur prej EURO 5 milion, me një normë

interesi të ndryshueshëm me datë maturimi në 3 Korrik 2024. Interesi paguhet çdo gjashtë muaj dhe principli paguhet në datën e maturimit.

## Detyrime të tjera

	2018	2017
Pagesa në tranzit	27,960	176,320
Kreditorë të ndryshëm	114,228	155,012
Shpenzime të tjera të përlogaritura	16,540	15,264
Të ardhura nga komisioni të shtyra	1,357	1,343
<b>Detyrime të tjera financiare</b>	<b>160,085</b>	<b>347,939</b>
Detyrime tatimore dhe sociale	19,073	16,653
Provizione të tjera	49,315	38,064
<b>Totali</b>	<b>228,473</b>	<b>402,656</b>

Provizionet e tjera lidhen me provizionet për humbjet nga zhvlerësimi për zërat jashtë bilancit dhe provizionet e përcaktuara për çështjet ligjore. Ato përfaqësojnë çmuarjet më

të mira të shumave me të cilat çështjet ligjore do të zgjidhen në periudhat e ardhshme. Lëvizja në dispozitat e tjera për vitet 2018 dhe 2017 është paraqitur më poshtë:

	Zërat jashtë bilancit	Çështjet ligjore	Ndërprerja e marrëdhënive të punës me stafin	Të tjera	Totali
Gjendja më 1 Janar 2017	5,162	14,942	-	-	20,104
Provizionet gjatë periudhës	3,744	3,232	16,205	-	23,181
Provizionet e kthyer gjatë periudhës	(3,606)	(1,615)	-	-	(5,221)
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2017</b>	<b>5,300</b>	<b>16,559</b>	<b>16,205</b>	<b>-</b>	<b>38,064</b>
Rregullimi sipas SNRF 9	17,936	-	-	-	17,936
Provizionet gjatë periudhës	8,734	731	-	-	9,465
Provizionet e kthyer gjatë periudhës	(2,678)	(1,785)	(14,557)	2,870	(16,150)
<b>Gjendja më 31 Dhjetor 2018</b>	<b>29,292</b>	<b>15,505</b>	<b>1,648</b>	<b>2,870</b>	<b>49,315</b>

## 28. Kapitali aksioner dhe rezervat ligjore

Më 31 Dhjetor 2018, kapitali aksionar i Bankës që është autorizuar dhe emetuar përbëhet nga 388,345 aksione ose EURO 28,698,696 (2017 EUR 25,698,725). Në gusht 2018 banka

zmadhoi kapitalin e saj aksionar me 2,999,971 Euro. Kompania mëmë dhe aksioneri i vetëm i Bankës është ProCredit Holding AG & Co. KGaA "Kompania Mëmë", shoqëri aksionere me seli në Frankfurt am Main, Gjermani.

	Numri i aksioneve	Në EUR	%
ProCredit Holding	388,345	28,698,696	100
	<b>388,345</b>	<b>28,698,696</b>	<b>100</b>

Kapitali aksioner	Në 1 Janar 2018	Aksione të reja të emetuara	Në 31 Dhjetor 2018
Numri i aksioneve	347,750	40,595	388,345
Kapitali aksioner	25,968,725	2,729,971	28,698,696

## Rezerva ligjore

Rezervat ligjore janë krijuar në bazë të vendimit nr. 69, datë 18 Dhjetor 2014 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, i cili parashikon se rezervat janë krijuar përmes përvetësimit të 20% të fitimit neto të bankës të periudhës, sikundër raportohet për qëllime rregullatore. Gjithashtu, është krijuar rezerva ligjore prej 5% të fitimit statutor të parashikuar në Ligjin nr. 9901, datë 14 Prill 2008, “Për sipërmarrësit dhe shoqëritë tregtare”.

## Rezerva e vlerës së drejtë

Rezerva e vlerës së drejtë përfshin ndryshimin neto kumulativ në vlerën e drejtë të investimeve në letra me vlerë të vendosjes deri në mos-njohjen ose zhvlerësimin e investimit. Lëvizjet në rezervën e vlerës së drejtë paraqiten në shënimin 19.

## 29. Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara

	2018	2017
<b>Garanci, letër kredi dhe angazhime kredie</b>		
Angazhime kredie (shih detajet më poshtë)	1,387,411	2,426,117
Garanci ndërkombëtare	384,815	386,502
Garanci lokale	487,743	358,615
Letër kredi	155,571	164,950
Minus: Provizionet e njohura si detyrime	(29,292)	(5,299)
<b>Totali</b>	<b>2,386,248</b>	<b>3,330,885</b>
<b>Angazhime kredie</b>		
Karta krediti të papërdorura	23,769	88,708
Limite paradhënie të papërdorura	869,304	1,094,220
Këste kredie të padisbursuara	-	58,607
Pjesa e papërdorur e linjave të kredisë	494,338	1,184,582
<b>Totali</b>	<b>1,387,411</b>	<b>2,426,117</b>

Banka lëshon garanci dhe letër kredi në favor të klientëve të saj. Këto instrumente mbartin një rrezik kreditimi që është i ngjashëm me atë të kredive të disbursuara. Në bazë të çmuarjeve të drejtimit të bankës nuk ekziston asnjë humbje material për garancitë më 31 dhjetor 2018 dhe për këtë arsye në pasqyrat financiare nuk është përfshirë asnjë provizion për humbje.

## Procese ligjore

Gjatë ushtrimit të aktivitetit të zakonshëm bankar, Banka përballet me procedime ligjore; Drejtimi i Bankës beson se mundësia për një rrjedhje të të ardhurave ekonomike në lidhje me pretendimet ligjore më 31 Dhjetor 2018 dhe 2017 është e vogël, përveç provizioneve të regjistruar siç paraqitet në shënimin 27.

## Angazhime qiraje operationale

Banka merr me qira mjedise për të realizuar operacionet dhe aktivitetin e saj.

Në përgjithësi kontratat e qirasë operationale mund të anulohen në bazë të një njoftimi 90 ditë përpara. Prandaj, shuma maksimale e angazhimeve të qirasë operationale të cilat nuk mund të anulohen dhe duhet të paguhet jo më vonë se 1 vit është afërsisht LEK 7,071 mijë (2017: LEK 12,218 mijë). Shpenzime e qirasë që paguhet gjatë vitit 2018 dhe 2017 paraqiten në Shënimin 10.

Angazhimet sipas cilësisë së kredisë në bazë të niveleve të rrezikut të kredisë në 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	Niveli 1 (12-muaj ECL)	Niveli 2 (jetëgjatësia ECL për SICR)	Niveli 3 (jetëgjatësia ECL për kreditë e zhvlerësuar)	Total
Garanci financiare	872,557			872,557
Garanci kontrate				
Letër kredi	155,571			155,571
Garanci të tjera				
<b>Totali i Garancive dhe Letër Kreditë</b>	<b>1,028,128</b>			<b>1,028,128</b>
<b>Angazhime të kredive të padisbursuara ende</b>				
<b>Totali i angazhimeve në lidhje me kreditë</b>	<b>1,355,235</b>	<b>4,530</b>	<b>27,646</b>	<b>1,387,410</b>
Minus: Provizionet për garancitë dhe letër kreditë	(19,656)			(19,656)
Minus: Provizionet për angazhimet e kredisë	(9,585)	(50)	-	(9,635)
<b>Angazhime gjithsej</b>	<b>2,354,122</b>	<b>4,480</b>	<b>27,646</b>	<b>2,386,248</b>

Banka llogarit provizionet për humbjet e pritshme nga kreditë ECL dhe LECL për garancitë dhe letër kreditë duke aplikuar për ekspozimet në fjalë bazuar në klasifikimin sipas niveleve. Në rastet kur zbatohet një vlerësim individual, parashikimi për

provizionin specifik konsiderohet për zhvlerësimin përfundimtar. Referojuni shënimin shpjegues për zhvlerësimin e kredive dhe paradhënieve për klientët për normat e provigjonimit.



### 30. Transaksione me palë të lidhura

Palët e lidhura të bankës përfshijnë kompaninë mëmë dhe palën që ushtron kontroll të plotë ProCredit Holding AG & Co. KGaA AG, filialet, drejtuesit kryesor, familjarë të drejtuesve kryesor dhe subjekte të cilat kontrollohen ose influencohen në mënyrë të konsiderueshme nga drejtuesit kryesor të bankës ose familjarët e afërt të tyre.

Banka ka nënshkruar një kontratë shërbimi për drejtimin e ProCredit Holding AG & Co. KGaA AG, për t'i siguruar Bankës

punonjës dhe personel në nivele të larta drejtuese të Bankës, duke përfshirë një Anëtar të Këshillit Administrativ. Komisionet për drejtimin që janë paguar ProCredit Holding AG & Co. KGaA AG në vitin 2018 rezultuan LEK 55,078 mijë (2017: LEK 55,336 mijë).

Gjithashtu, gjatë zhvillimit të aktivitetit bankar, Banka ka kryer transaksione biznesi me palët e lidhura, gjendjet dhe transaksionet me ProCredit Holding AG & Co. KGaA AG, aksionerin dhe subjektet e lidhura nën kontrollin e përbashkët më 31 Dhjetor 2018 dhe 2017 paraqiten si më poshtë vijon:

2018	ProCredit Holding	PCB Germany	PCB Kosovo	Quipu	ProCredit Academy	Procredit të tjerë	Drejtimi kryesor	Totali
<b>Aktive</b>								
Mjete monetare dhe hua për institucionet financiare	-	2,838,807	14,507	-	-	-	-	2,853,314
Mjete të tjera	758	-	3,888	-	-	-	-	4,646
<b>Detyrime</b>								
Detyrime të tjera	3,618,655	3,215,163	1,949	3,668	-	441	-	6,839,876
<b>Transaksione fitim humbje</b>								
Të ardhura	-	(998)	-	-	-	-	-	(998)
Shpenzime	143,355	31,374	7,487	220,527	29,520	4,661	47,428	484,352

2017	ProCredit Holding	PCB Germany	PCB Kosovo	Quipu	ProCredit Academy	Procredit të tjerë	Drejtimi kryesor	Totali
<b>Aktive</b>								
Mjete monetare dhe hua për institucionet financiare	-	3,428,376	11,656	-	-	-	-	3,440,032
Mjete të tjera	718	-	5,840	19,094	-	-	-	25,652
<b>Detyrime</b>								
Detyrime të tjera	2,015,217	2,329,441	1,482	5,893	-	-	-	4,352,033
<b>Transaksione fitim humbje</b>								
Të ardhura	-	4,332	2,074	-	-	-	-	6,406
Shpenzime	106,998	20,684	11,288	152,041	35,775	1,942	49,767	378,495

### 31. Ngjarjet pas datës së bilancit

Në bazë të vendimit të Këshillit Drejtues, datë 27 shkurt 2019, u miratua dorëheqja e Borislav Konstandinov, anëtar i dhe kryetar i Këshillit Drejtues, dhe Eriola Bidolli zgjidhet anëtare e Këshillit Drejtues.

Nuk ka ndodhur asnjë ngjarje tjetër pas datës së bilancit, të cilat do të kërkonin korrigjime apo edhe shënime shpjeguese shtesë në pasqyrat financiare

### 32. Politikat kontabël të zbatueshme para datës 1 janar 2018

#### *Instrumentet financiare – termat dhe kushtet kryesore të matjes*

Në varësi të klasifikimit të tyre, instrumentet financiare kontabilizohen me vlerën e drejtë ose koston e amortizuar siç përshkruhet më poshtë.

**Matja me vlerë të drejtë** *Vlera e drejtë* është çmimi i cili do të përcaktohet dhe arkëtohet për të shitur një aktiv ose do të paguhet për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt midis pjesëmarrësve në treg në datën e matjes në principal ose në mungesë të saj, në tregun me më shumë avantazhe në të cilin Banka ka akses në atë datë. Evidenca më e mirë e vlerës së drejtë është çmimi në një treg aktiv. Një treg konsiderohet si treg aktiv nëse transaksionet për aktivet dhe detyrimet ndodhin me një frekuencë dhe në volume të mjaftueshme për të paraqitur informacion dhe të dhëna për çmimin në mënyrë të vazhdueshme.

Nëse është e mundur, Banka mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimin e kuotuar në një treg aktiv për atë instrument. Tregu konsiderohet si aktiv nëse transaksionet për aktivin ose pasivin zhvillohen me frekuencë dhe volum të mjaftueshëm për të siguruar informacionin për çmimet në mënyrë të vazhdueshme. Nëse nuk ka çmim të kuotuar në një treg aktiv, atëherë Banka përdor teknikat e vlerësimit që maksimizojnë përdorimin e të dhënave përkatëse të vëzhgueshme dhe minimizojnë përdorimin e të dhënave të pavëzhgueshme. Teknika e përzgjedhur e vlerësimit përfshin të gjithë faktorët që pjesëmarrësit e tregut do të merrnin në konsideratë në përcaktimin e çmimit të një transaksioni.

Vlera e drejtë e instrumenteve financiare të tregtuara në një treg aktiv matet si produkt i çmimit të kuotuar për aktivin ose pasivin individual dhe sasinë e mbajtur nga subjekti. Ky është rasti edhe nëse volumi normal i tregtisë ditore së tregut nuk është i mjaftueshëm për të përthithur sasinë e mbajtur dhe dhënien e urdhrave për të shitur pozicionin në një transaksion të vetëm mund të ndikojë në çmimin e kuotuar.

Evidenca më e mirë e vlerës së drejtë të një instrumenti financiar në momentin e njohjes fillestare është normalisht çmimi i transaksionit - pra Vlera e drejtë e pagesës së dhënë ose të arkëtuar. Nëse Banka përcakton që vlera e drejtë në momentin e njohjes fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit dhe vlera e drejtë nuk evidentohet as nga një çmim i kuotuar në një treg aktiv për një aktiv ose detyrim identik ose të bazuar në një teknikë vlerësimi që përdor vetëm të dhëna nga tregjet e vëzhguara, atëherë instrumenti financiar fillimisht matet me vlerën e drejtë, i cili rregullohet për të dalluar diferencën midis vlerës së drejtë në momentin e njohjes fillestare dhe çmimit të transaksionit.

Më pas, ky ndryshim njihet në pasqyrën e fitim humbjeve në mënyrë të përshtatshme gjatë jetëgjatësisë së instrumentit, por jo më vonë se kur vlerësimi mbështetet tërësisht nga të dhënat e tregut të vëzhgueshme ose kur transaksioni mbyllet. Banka nuk ka instrumente ku vlera e drejtë në momentin e njohjes fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit.

Nëse një aktiv ose një pasiv që matet me vlerën e drejtë ka një çmim oferte dhe një çmim kërkese, atëherë Banka mat aktivet dhe pozicionet afat-gjata me çmimin e ofertës dhe detyrimet dhe pozicionet afat-shkurtra me çmimin e kërkesës.

Vlera e drejtë e depozitës pa afat nuk është më e vogël se shuma e pagueshme në bazë të kërkesës, e zbritur nga data e parë në të cilën shuma mund të kërkohet që të paguhet.

Banka njih transferimet midis niveleve të hierarkisë së vlerës së drejtë deri në fund të periudhës së raportimit gjatë së cilës ka ndodhur ndryshimi.

Kostoja e amortizuar përbën shumën me të cilin instrumenti financiar matet në fazën e njohjes fillestare, minus kthimin e

principalit, plus vlerën e interesit të akumuluar dhe për aktive financiare minus ndonjë fshirje për shpenzimet e kryera për provigjionimin. Interesi i akumuluar përfshin amortizimin e kostove të transaksionit në njohjen fillestare dhe të ndonjë primi ose zbritje të shumës së maturuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Të ardhurat e akumuluar nga interesi dhe shpenzimet e akumuluar për interesat, duke përfshirë si kuponin e akumuluar dhe zbritjen e amortizuar ose primin (përfshirë komisionet e shtyra në momentin e realizimit, nëse ka) nuk paraqiten të ndara më vete dhe përfshihen në vlerat kontabël të zërave përkatës në pasqyrën e pozicionit financiar.

Metoda e interesit efektiv është një metodë e ndarjes së të ardhurave nga interesi ose shpenzimeve për interesat gjatë periudhës përkatëse, në mënyrë që të arrihet një normë konstante e interesit periodik (norma efektive e interesit) në vlerën kontabël. Norma efektive e interesit është norma që zbritet me saktësi pagesat e ardhshme në mjete monetare cash ose faturat (duke përjashtuar humbjet e ardhshme të kredisë) përgjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar ose një periudhe më të shkurtër, nëse është e përshtatshme, në vlerën kontabël neto të instrumentit financiar.

Një portofol i derivateve financiare ose i aktiveve dhe detyrimeve të tjera financiare që nuk tregtohen në një treg aktiv, matet me vlerën e drejtë të një grupi të aktiveve dhe detyrimeve financiare në bazë të çmimit që do të merret për të shitur një pozicion neto afatgjatë (pra një aktiv) për një ekspozim të veçantë të rrezikut ose që paguhet për të transferuar një pozicion neto afat shkurtër (pra një pasiv) për një ekspozim të veçantë të rrezikut në një transaksion të rregullt ndërmjet pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes.

Kjo është e zbatueshme për aktivet e mbajtura me vlerën e drejtë në mënyrë sistematike nëse Banka: (a) menaxhon grupin e aktiveve dhe pasiveve financiare në bazë të ekspozimit neto të subjektit ndaj një rreziku (ose rreziqeve) të veçantë të tregut ose ndaj rrezikut të kredisë të një kundërpale të veçantë në përputhje me strategjinë e menaxhimit të dokumentuar të subjektit ose strategjinë e investimit; (b) jep informacion mbi këtë bazë në lidhje me grupin e aktiveve dhe detyrimeve ndaj drejtuesve kryesor të subjektit; dhe (c) rreziqet e tregut, duke përfshirë kohëzgjatjen e ekspozimit të subjektit ndaj një rreziku (ose rreziqeve) të veçantë të tregut që rezultojnë nga aktivet financiare dhe detyrimet financiare është në thelb e njëjtë

Kostot e transaksionit janë kosto shtesë që i atribuohen drejtpërdrejt blerjes, emetimit ose shitjes së një instrumenti financiar. Një kosto shtesë është ajo kosto që nuk do të kishte ndodhur nëse transaksioni nuk do të ishte kryer. Kostot e transaksionit përfshijnë tarifën dhe komisionet që u paguhen agjentëve (përfshirë punonjësit që veprojnë si agjentë shitës), konsulentët, ndërmjetësit dhe tregtarët, taksat nga agjencitë rregullatore dhe shkëmbimet e letrave me vlerë, si dhe taksat dhe detyrimeve për transferimet. Kostot e transaksionit nuk përfshijnë primet e borxheve ose zbritjet, kostot e financimit ose shpenzimet e brendshme administrative ose të mbajtjes.

**Njohja fillestare e instrumenteve financiare.** Derivatet dhe instrumentet e tjera financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet pasqyrës së fitim humbjeve fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë. Të gjitha instrumentet e tjera financiare fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë plus kostot e transaksionit. Vlera e drejtë në njohjen fillestare evidentohet më së miri nga çmimi i transaksionit. Fitimi ose humbja në momentin e njohjes fillestare regjistrohet vetëm nëse ka një diferencë midis vlerës së drejtë dhe çmimit të transaksionit që mund të evidentohet nga transaksionet e tjera të tregut për të njëjtin instrument ose nga një teknikë vlerësimi, të dhënat e të cilës përfshijnë vetëm të dhëna të vëzhgueshme në treg.

Të gjitha blerjet dhe shitjet e aseteve financiare që parashikojnë dorëzimin brenda afatit kohor të përcaktuar në bazë të

regullores ose konventa e tregut (blerjet dhe shitjet "mënyrë të rregullt") regjistrohen në datën e tregtimit, që është data në të cilën Banka angazhohet për të dorëzuar aktivin financiar. Të gjitha blerjet e tjera njihen kur subjekti bëhet palë për zbatimin e dispozitat kontraktuale të instrumentit.

**Mosnjohja e aktiveve financiare.** Banka çregjistron aktivet financiare kur (a) asetet janë liruar ose të drejtat për flukset e mjeteve monetare nga aktivet ndryshe kanë skaduar ose (b) Banka ka transferuar të drejtat ndaj flukseve të mjeteve monetare nga aktivet financiare ose kanë dakordësuar një transferim kualifikues ndërkohë që (i) gjithashtu transferon plotësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aseteve ose (ii) nuk transferon dhe as nuk mban plotësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë, por nuk ruan kontrollin. Kontrolli ruhet në qoftë se pala tjetër nuk ka aftësinë praktike për të shitur asetin në tërësi ndaj një palë të tretë që nuk është e lidhur pa pasur nevojë të vendosë kufizime për shitjen.

Banka çregjistron një pasiv financiar kur detyrimet e saj kontraktuale shkarkohen ose anulohen ose skadojnë.

**Mjete monetare dhe të ngjashme.** Mjete monetare dhe të ngjashme janë zëra që janë lehtësisht të konvertueshëm në shuma të njohura cash dhe të cilat janë subjekt i një rreziku të parëndësishëm të ndryshimeve të vlerës. Mjete monetare dhe të ngjashme përfshijnë të gjitha vendosjet ndërbankare me maturitet fillestare më pak se tre muaj. Fondet e kufizuara për një periudhë më të gjatë se tre muaj në fillim përjashtohen nga Mjetet monetare dhe të ngjashme. Mjete monetare dhe të ngjashme mbarten me kosto të amortizuara.

Pagesat ose faturat e paraqitura në pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare përfaqësojnë transfertat e Mjeteve monetare dhe të ngjashme nga Banka, duke përfshirë shumat e paguara ose të kredituara në llogaritë rrjedhëse të kundërpalëve të Bankës që mbahen në Bankë, siç janë të ardhurat nga interesi i kredisë ose principalit i cili arkëtohet duke debituar llogarinë rrjedhëse të klientit ose pagesat e interesit apo disbursimi i kredive të kredituara në llogarinë rrjedhëse të klientit, që paraqet Mjete monetare dhe të ngjashme nga perspektiva e klientit.

**Llogari të detyrueshme me Bankën Qendrore.** Llogari të detyrueshme me Bankën Qendrore mbahen me kosto të amortizuara dhe përfaqësojnë depozita të rezervave të detyrueshme që nuk gjenerojnë interes të cilat nuk janë të vlefshme për të financuar veprimtarinë e përditshme të Bankës dhe rrjedhimisht nuk konsiderohen pjesë e mjeteve monetare dhe të ngjashme për qëllimet e pasqyrës së flukseve të mjeteve monetare.

**Investime në letra me vlerë të vendosjes.** Ky klasifikim përfshin letrat me vlerë të investimit të cilat Banka synon të mbajë për një periudhë të pacaktuar kohe dhe të cilat mund të shiten në përgjigje të nevojave për likuiditet ose për shkak të ndryshimit të normave të interesit, kurseve të këmbimit ose çmimeve të kapitalit. Letrat me vlerë të vendosjes kontabilizohen me vlerën e drejtë. Të ardhurat nga interesi nga letrat me vlerë të borxhit të vendosjes llogariten duke përdorur metodën e interesit efektiv dhe njihen në pasqyrën e fitim humbjeve për vitin.

**Detyrime nga banka të tjera.** Shumat të cilat duhet të paguhen nga banka të tjera regjistrohen kur Banka u jep para bankave të tjera, pa qëllime tregtimi të të ardhurave të arkëtueshme jo-derivative që duhet të paguhen në datat fikse ose të përcaktueshme. Shumat që paguhen nga bankat e tjera mbahen me kosto të amortizuara.

**Hua dhe paradhënie klientëve.** Huatë dhe paradhëniet për klientët regjistrohen në momentin kur Banka jep para për të blerë ose origjinuar një arkëtim jo-derivativ të pakuotuar nga një klient i caktuar në data fikse ose të përcaktueshme dhe nuk ka synim të tregtojë të ardhurat e arkëtueshme. Huatë dhe paradhëniet për klientët kontabilizohen me koston e amortizuara.

**Kompensimi.** Aktivet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe vlera neto paraqitet në pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar kur dhe vetëm kur Banka gëzon të drejtën ligjore për të bërë kompensimin e shumave dhe vlerave, dhe ka si qëllim likuidimin mbi bazën neto ose likuidimin e aktivitetit dhe shlyerjen e detyrimit njëkohësisht. Kjo e drejtë kompensimi (a) nuk duhet të jetë e kushtëzuar nga një ngjarje e ardhshme dhe (b) duhet të jetë ligjërish e zbatueshme në të gjitha rrethanat e mëposhtme: (i) në rrjedhën normale të biznesit, (ii) në rast shkakësor/mospagimi (iii) rastet e paafëtisë së paguese ose falimentimit.

**Zhvlërësimi** Banka vlerëson në çdo datë raportimi nëse ka prova objektive që një aktiv financiar ose grup i aktiveve financiare është zhvlërësuar.

Një aktiv financiar ose një grup aktivesh financiare zhvlërësohet vetëm nëse ka prova objektive zhvlërësimi si rezultat i një ose më shumë ngjarjeve që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitetit (një ngjarje humbjeje) dhe se ngjarja e humbjes (ose ngjarjet) ka një ndikim në flukset e mjeteve monetare të ardhshme të vlerësuara të aktivitetit financiar ose grupit të aktiveve financiare që mund të vlerësohen në mënyrë të besueshme.

**Zhvlërësimi i huas dhe paradhënie klientëve** bazohet në një rishikim të disa faktorëve që ndjekin kordinë, përbajnë dobësitë që janë pjesë e një kredie, ose nëse ekziston një mundësi që një pjesë e vlerës së kredisë nuk do të paguhet.

Kriteret kryesore që Banka respekton dhe zbaton për të përcaktuar nëse ekzistojnë prova dhe evidencë objektive të një humbje nga zhvlërësimi përfshijnë:

- Vonesa dhe moskryerje të pagesës së interesit ose të principalit;
- Mospagesë të interesit ose të principalit në institucionet e tjera financiare ("IF"), subjekt i pragjeve të caktuara;
- Vështirësi likuiditeti të kredimarrësit (për shembull, raporti i likuiditetit, raporti i kapitalit, përqindja e të ardhurave neto të shitjeve);
- Shkelja e termave dhe kushteve të kontratës;
- Huamarrësi konsideron falimentimin ose riorganizimin financiar;
- Përkeqësimi i kushteve ekonomike dhe të tregut

Banka fillimisht vlerëson nëse evidenca dhe prova objektive e zhvlërësimit ekziston individualisht për aktivet financiare që janë individualisht të rëndësishme dhe në mënyrë individuale ose kolektive për aktivet financiare që nuk janë individualisht të rëndësishme. Nëse Banka përcakton që nuk ekziston asnjë provë dhe evidencë objektive për zhvlërësimin e një aktiviteti financiar të vlerësuar individualisht, qoftë i rëndësishëm ose jo, ai përfshin aktivin në një grup aktivesh financiare me karakteristikë të ngjashme të rrezikut të kredisë dhe i vlerëson kolektivisht ato për zhvlërësim.

Vlera kontabël e aktivitetit zvogëlohet nëpërmjet përdorimit të një llogarie provizionit dhe shuma e humbjes njihet në pasqyrën e fitim humbjeve për vitin.

Për qëllime të zhvlërësimit kolektiv, aktivet financiare grupohen në bazë të karakteristikave të ngjashme të rrezikut të kredisë. Këto karakteristikë janë relevante për vlerësimin e flukseve të mjeteve monetare të ardhshme për grupet e këtyre aktiveve duke përcaktuar treguesin e aftësisë së debitorit për të paguar të gjitha shumat që janë të detyrueshme sipas kushteve kontraktuale të aktiveve që janë subjekt vlerësimi.

Vlerësimi kolektiv bazohet në një model të rrezikut të kredisë që merr në konsideratë faktorin e probabilitetit të mospagesës ("PD") dhe Faktorin e humbjes së parashikuar ("LGD") të përshtatur sipas rrethanave lokale. Faktori i probabilitetit të mospagesës PD-së është vërejtur përgjatë një periudhe dymbëdhjetë mujore, ndërsa niveli i rikuperimit i cili llogaritet për një periudhë 24 mujore. Të dhënat e regjistruara në model

janë përditësuar çdo vit për tre segmente të veçanta (ekspozimet për individë, biznes dhe kartat e kreditit) dhe normat e provigjoneve përfundimtare për humbjen e kredisë që rezultojnë nga modeli janë përfundimisht subjekt i miratimit të Komitetit të Administrimit të Riskut (RMC) dhe Këshillit Drejtues ("KD").

Për qëllime të zhvlerësimit kolektiv, Banka klasifikon portofolin në kategoritë e mëposhtme:

- Standarde: vonesa 1-30 ditë
- Në ndjekje: vonesa 31-60 ditë
- Nën-standard: vonesa 61-90 ditë
- Të Dyshimta: vonesa 91-180 ditë
- Të humbura: vonesa > 180 ditë

Faktorët PD dhe LGD të cilat përdoren për të përcaktuar nivelet e provizioneve që paraqiten më sipër burojnë nga informacionet historike të Bankës. Banka ka aplikuar një faktor shtesë konservativ prej 10% për provigjionimin kolektiv, duke synuar të llogarisë humbje të tjera që mund të rezultojnë nga ndonjë zhvillim i jashtëm negativ ose ndryshim në normën e mospagesës. Për hua të zhvlerësuar individualisht, banka përdor metodën e mëposhtme.

Huatë me probleme ("NPL") që kanë vonesa për më shumë se 90 ditë dhe për të cilat evidentohet një përkeqësim financiar, janë subjekt i një provizionit të posaçëm.

Për rastet e Huave me Probleme në 30 mijë Euro, ekspozimi i papaguar ("EAD") në datën e raportimit shumëzohet me një normë rikuperimi prej 24 muaj për secilin segment dhe ekspozimi i mbetur provigjionohet 100%.

Për rastet e huave me probleme mbi 30 mijë Euro, banka kryen zhvlerësimin individual duke vlerësuar fluksin e mjeteve monetare në hyrje deri në 10 vjet, e cila skontohej me normën efektive të interesit të secilës linjë kredie. Parashikimi për arkëtimet bazohet në vlerësime të kujdesshme dhe reale të cilat konsiderojnë faktorët e mëposhtëm për përmirësimin e kredisë si: vlera e tregut të kolateralit dhe likuiditeti i tij, historiku i fluksit të mjeteve monetare, kapaciteti i garantorit/bashkëkredimarrësit, kohëzgjatja për likuidimin / rimarrjen në zotërim të aktiveve dhe mjedisi ligjor i vendit si faktor i jashtëm. Banka analizon çdo muaj çmuarjet dhe vlerësimet në lidhje me arkëtimet.

Ekspozimet e ristrukturuara të kredisë të cilat kanë vonesa më të vogla se 90 ditë dhe nëse nuk evidentohet ndonjë përkeqësim financiar për likuidimin e kredisë, klasifikohen si ekspozime pa probleme, në të kundërt ekspozimet klasifikohen si ekspozime me problem të ristrukturuara. Një ekspozim i ristrukturuar i kredisë klasifikohet në kategorinë nën standard ose në një kategori më të ulët deri në kohën e evidentimit të ecurisë së qëndrueshme. Ekspozimet e ristrukturuara monitorohen dhe klasifikimi i tyre përmirësohet vetëm pas katër pagesave të rregullta të njëpasnjëshme. Nëse një hua nuk mund të arkëtohet, ajo fshihet përkundërt provizionit përkatës për zhvlerësimin e kredisë. Sipas procedurave të brendshme të bankës, kredia fshihet në bazë të dy kriterëve: moskryerja e pagesave të kredisë dhe lloji i kolateralit.

Nëse, në një periudhë pasuese, shuma e humbjes nga zhvlerësimi zvogëlohet dhe rënia mund të lidhet objektivisht me një ngjarje që ndodh pas njohjes së zhvlerësimit (siç është përmirësimi i klasifikimit të kredisë së debitorit), humbja nga zhvlerësimi e njohur më parë anulohet duke rregulluar llogarinë e provizionit. Shuma e rimarrë njihet në pasqyrën e fitim humbjeve në zërin e zhvlerësimeve për humbjet e kredisë.

### Zhvlerësimi i letrave me vlerë të vendosjes

Banka përcakton që investimet në letra me vlerë të vendosjes zhvlerësohen nëse ka pasur një rënie të konsiderueshme ose të zgjatur të vlerës së drejtë nën koston e saj. Në mungesë të çmimeve të tregut të brendshëm dhe të *yield*-eve për obligacione AFS, llogaritja e vlerës së drejtë të tregut të letrave me vlerë të vendosjes bëhet çdo ditë bazuar në kurbën gjenerike gjermane të obligacioneve. Regjistrimi i rivlerësimit në librat e bankës bëhet nga departamenti i financës në çdo datë raportimi. Çdo muaj, departamenti i financave siguron *yield*-in në fjalë (*yield*-i i tregut) bazuar në të dhënat e Bloomberg të cilat mundësohen dhe paraqiten nga departamenti i thesarit.

### Instrumentet financiare derivative

Instrumentet financiare derivative që përfshijnë kontratat e këmbimit valutor kontabilizohen me vlerën e tyre të drejtë. Instrumentet derivatve kontabilizohen si aktive nëse vlera e drejtë është pozitive dhe si detyrime nëse vlera e drejtë është negative. Ndryshimet në vlerën e drejtë të instrumenteve derivative përfshihen në pasqyrën e fitim humbjeve për vitin (fitimet minus humbjet nga derivatet). Banka nuk zbaton kontabilitetin mbrojtës.

**Angazhimet e kredisë.** Banka lëshon garanci financiare dhe merr angazhime për të dhënë hua. Garancitë financiare paraqesin siguri të përvokueshme për të bërë pagesa në rast se një klient nuk mund të përmbushë detyrimet e tij ndaj palëve të treta dhe paraqesin të njëjtin rrezik kredie si kreditë. Garancitë financiare dhe angazhimet për të siguruar një hua fillimisht njihen me vlerën e tyre të drejtë, e cila normalisht evidentohet nga shuma e tarifave të arkëtuara. Kjo shumë amortizohet në mënyrë lineare përgjatë jetëgjatësisë së angazhimit, me përjashtim të angazhimeve për të akorduar kredi, nëse ka gjasa që Banka do të hyjë në një marrëveshje specifike kredidhënie dhe nuk parashikon të shesë kredinë që rezulton menjëherë pas dhënies së saj; këto komisione angazhimi të kredisë shtyhen dhe përfshihen në vlerën kontabël të kredisë në momentin e njohjes fillestare. Në fund të secilës periudhë raportimi, angazhimet maten në nivelin më të lartë (i) gjendjes së mbetur të paamortizuar të shumës në momentin e njohjes fillestare dhe (ii) vlerësimit më të mirë të shpenzimeve të nevojshme që duhen për të shlyer angazhimin në fund të çdo periudhe raportimi.

**Garancitë e kontratës.** Garancitë e kontratës janë kontrata që ofrojnë kompensim nëse një palë tjetër nuk arrin të përmbush një detyrim kontraktual. Këto Kontrata transferojnë rrezikun jo-financiar të kontratës përveç rrezikut të kredisë. Garancitë e kontratës fillimisht njihen me vlerën e tyre të drejtë, e cila normalisht evidentohet nga shuma e tarifave të arkëtuara. Kjo shumë amortizohet në mënyrë lineare për gjatë jetëgjatësisë së kontratës. Në fund të secilës periudhë raportimi, kontratat e garancisë maten në nivelin më të lartë të (i) gjendjes të paamortizuar të shumës në momentin e njohjes fillestare dhe (ii) vlerësimit dhe çmuarjes më të mirë të shpenzimeve të nevojshme për të zgjidhur kontratën në fund të çdo periudhe raportimi, duke zbritur në vlerën aktuale. Kur Banka ka të drejtën kontraktuale për t'iu kthyer klientit të saj për rikuperimin e shumave të paguara për të shlyer kontratat e garancisë, këto shuma do të njihen si hua dhe të arkëtueshme pas transferimit të kompensimit të humbjes tek përfituesi i garancisë. Këto tarifa njihen tek të ardhurat nga komisionet në pasqyrën e fitim humbjeve.

## Adresat dhe Kontaktet

### Zyrat Qendrore

#### ProCredit Bank sh.a.

Vendi i Regjistrimit: Tiranë

Nr. i Regjistrimit në Gjykatë: 20797/11.02.1999

KIB: 20911005

Nipt: J 91524011J

Adresa: Rr. "Dritan Hoxha". Nd. 92,  
H. 15, Njësia Bashkiake Nr. 11, Tiranë.

P.O. Box 1026

Tel.: +355 (0) 42 389 300

#### Qendra e Kontaktit:

+355 (0) 42 389 389

+355 (5) 2 293 001

informacion@procredit-group.com

www.procreditbank.com.al

### Degët

#### Dega Tiranë

Rr. "Dritan Hoxha"

Nd. 92, H. 15, Njësia Bashkiake Nr. 11,

Kodi Postar 1026, Tiranë

### Agjenci dhe Zona 24/7

#### Agjencia Zyrat Qendrore, Zona 24/7

Rr. "Dritan Hoxha"

Nd. 92, H. 15, Njësia Bashkiake Nr. 11,

Kodi Postar 1026, Tiranë

#### Agjencia Piazza, Zona 24/7

Rr. "Ded Gjo Luli", pranë Muzeut Kombëtar,  
Tiranë

#### Agjencia Kombinat, Zona 24/7

Rr. "Llazi Miho" Nd.95 H. 7

Njësia Bashkiake Nr. 6 Kodi Postar 1027, Tiranë

#### Agjencia Durrësi Porti, Zona 24/7

Lagjja 3, Rr. "Skënderbej"

Pranë Qendrës Monum (ose pranë Portit)

#### Agjencia Korçë, Zona 24/7

Rruga "Midhi Kostani", Korçë

#### Agjencia Shkodër, Zona 24/7

Bulevardi "Zogu I", Nr. 7, Shkodër

